



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.7

20 shkurt

2012

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr. 1/2012
datë 26.1.2012

Për ratifikimin e konventës rajonale për Rregullat Preferenciale
Pan-Euro-Mediterrane të Originës

Faqe

197

LIGJ
Nr.1/2012

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS RAJONALE PËR RREGULLAT PREFERENCIALE
PAN-EURO-MEDITERIANE TË ORIGJINËS**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa rajonale për Rregullat Preferenciale Pan-Euro-Mediterrane të Origjinës.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.1.2012

**Shpallur me dekretin nr.7266, datë 7.2.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Bamir Topi**

KONVENTË RAJONALE
MBI RREGULLAT PREFERENCIALE PAN-EURO-MEDITERIANE TË ORIGJINËS

Bashkimi Europian, Republika e Islandës, Mbretëria e Norvegjisë, Konfederata Zvicerane, Principata e Lihtenshtainit, këtu quhen “shtetet EFTA”,

Republika Demokratike Popullore e Algjerisë, Republika Arabe e Egjiptit, shteti i Izraelit, Mbretëria Hashetime e Jordanisë, Republika e Libanit, Mbretëria e Marokut, Republika Arabe Siriane, Republika e Tunizisë, PLO-ja në emër të Autoritetit Palestinez të Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës, Republika e Turqisë, këtu quhen “pjesëmarrës në Procesin e Barcelonës”,

Republika e Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republika e Kroacisë, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Republika e Serbisë, si dhe Kosova sipas Rezolutës 1244/99 të KSKB-së, këtu quhen “pjesëmarrës në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit të Bashkimit Europian”,

Mbretëria e Danimarkës në emër të Feroeve, këtu quhen “ishujt Feroe”,

duke pasur parasysh sistemin pan-euro-mediterian të kumulimit të origjinës së bërë për rrjetin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë, që parashikon rregulla identike të origjinës për kumulim diagonal;

duke pasur parasysh zgjerimin e mundshëm në të ardhmen të kuadrit gjeografik të kumulimit diagonal te vendet dhe territoret fqinje;

duke pasur parasysh vështirësitë në menaxhimin e rrjeteve të tashme të protokolleve bilaterale mbi rregullat e origjinës ndërmjet vendeve dhe territoreve të zonës pan-euro-mediteriane, është e dëshirueshme të transpozohen sistemet ekzistuese bilaterale mbi rregullat e origjinës në kuadrin multilateral, pa cenuar parimet e parashikuara në marrëveshjet përkatëse ose në çdo marrëveshje tjetër përkatëse bilaterale;



duke pasur parasysh që çdo ndryshim në një protokoll mbi rregullat e origjinës të zbatueshme ndërmjet dy vendeve partnere të zonës pan-euro-mediteriane tregon ndryshime identike për secilin dhe çdo protokoll që zbatohet brenda në zonë;

duke pasur parasysh që rregullat e origjinës nuk janë të nevojshme të ndryshohen me qëllim që t'i përgjigjen më mirë realitetit ekonomik;

duke pasur parasysh idenë e kumulimit bazë të origjinës në një instrument të vetëm ligjor në formën e një konvente rajonale mbi rregullat preferenciale të origjinës, së cilës i referohen marrëveshjet e veçanta të tregtisë së lirë ndërmjet vendeve të zonës;

duke pasur parasysh që konventa e mëposhtme rajonale nuk çon në përgjithësi në një situatë më pak të favorshme sesa në marrëdhëniet e mëparshme ndërmjet partnerëve të tregtisë së lirë që zbatohen në kumulimin pan-euro ose pan-euro-med.;

duke pasur parasysh që ideja e një konvente rajonale mbi rregullat preferenciale të origjinës për zonën pan-euro-mediteriane ka marrë mbështetjen e ministrave të tregtisë euro-med. gjatë takimit të tyre në Lisbonë më 21 tetor 2007;

duke pasur parasysh që qëllimi kryesor i një konvente të vetme rajonale është lëvizja drejt zbatimit të rregullave identike të origjinës për qëllimin e kumulimit të origjinës së mallrave të tregtuara ndërmjet të gjitha palëve kontraktuese,

kanë vendosur të përfundojnë Konventën e mëposhtme:

PJESA I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Kjo Konventë përmban dispozita mbi origjinën e mallrave të tregtuara sipas marrëveshjeve përkatëse të përfunduara ndërmjet palëve kontraktuese.

2. Koncepti i “produkteve të origjinës” dhe metoda e bashkëpunimit administrativ në lidhje me to janë përcaktuar në shtojcat e kësaj Konvente.

Shtojca I përcakton rregulla të përgjithshme për konceptin e produkteve të origjinës dhe metodat e bashkëpunimit administrativ.

Shtojca II përcakton rregulla të veçanta të zbatueshme ndërmjet palëve të caktuara kontraktuese dhe që devijojnë nga dispozitat e parashikuara në shtojcën I.

3. Palët e mëposhtme janë kontraktuese në këtë Konventë:

- Bashkimi Europian;

- Shtetet e EFTA-s siç renditen në preambul;

- Ishujt Faroe;

- Pjesëmarrësit në Procesin e Barcelonës, siç renditen në preambul;

- Pjesëmarrësit në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit, siç renditen në preambul.

Në lidhje me Bashkimin Europian, kjo Konventë zbatohet në territorin në të cilin është i zbatueshëm Traktati i Bashkimit Europian, sipas përkufizimit në nenin 52 të atij traktati dhe nenin 355 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Europian.

Neni 2

Për qëllimet e kësaj Konvente, termat:

a) “Palë kontraktuese” janë ato të renditura në nenin 1 (3);

b) “Palë e tretë” është çdo vend ose territor fqinj që nuk është palë kontraktuese në këtë Konventë dhe nuk është i renditur në nenin 1 (3);

c) “Marrëveshje përkatëse” është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese që i referohet kësaj Konvente.

PJESA II KOMITETI I PËRBASHKËT

Neni 3

1. Themelohet një komiteti i përbashkët, ku përfaqësohet çdo palë kontraktuese.
2. Komiteti i përbashkët vepron me unanimitet, pa cenuar nenin 5 (4).
3. Komiteti i përbashkët mbledhet kurdoherë të jetë e nevojshme, por të paktën një herë në vit. Çdo palë kontraktuese mund të kërkojë që të zhvillohet një mbledhje.
4. Komiteti i përbashkët miraton rregullat e veta procedurale, që, ndër të tjera, përmbajnë dispozita për thirrjen e mbledhjeve dhe për caktimin e kryetarit dhe mandatit të tij.
5. Komiteti i përbashkët mund të vendosë të ngrejë çdo nënkomitet ose grup pune që mund ta asistojë atë në përmbushjen e detyrave të tij.

Neni 4

1. Është përgjegjësia e komitetit të përbashkët të administrojë këtë Konventë dhe të sigurojë zbatimin e saj të përshtatshëm. Për këtë qëllim, ai informohet rregullisht nga palët kontraktuese në lidhje me eksperiencën që ato kanë në zbatimin e Konventës. Komiteti i përbashkët bën rekomandime dhe në rastet e parashikuara në paragrafin 3, merr vendime.
2. Veçanërisht u rekomandon palëve kontraktuese:
 - a) nota dhe udhëzime shpjeguese për zbatimin e njëtrajtshëm të kësaj Konvente;
 - b) çdo masë tjetër që kërkohet për zbatimin e saj.
3. Komiteti i përbashkët miraton me vendim:
 - a) ndryshimet e kësaj Konvente, duke përfshirë ndryshimet e shtojcave;
 - b) ftesat për palët e treta për të aderuar në këtë Konventë në pajtim me nenin 5;
 - c) masat e përkohshme që kërkohen në rastin e aderimit të një pale të re kontraktuese.Vendimeve të përmendura në këtë paragraf u jepet fuqi nga palët kontraktuese në pajtim me legjislacionin e tyre.
4. Nëse një palë kontraktuese në Komitetin e Përbashkët ka pranuar një vendim me kusht përmbushjen e kërkesave themelore ligjore, vendimi, nëse nuk caktohet asnjë datë për këtë, hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas heqjes së rezervës së njoftuar.
5. Nga data e përmendur në paragrafin 5, pala e tretë përkatëse mund të përfaqësohet në Komitetin e Përbashkët, nënkomitet ose grupet e punës me statusin e vëzhguesit.

PJESA III ADERIMI I PALËVE TË TRETA

Neni 5

1. Një palë e tretë mund të bëhet palë kontraktuese në këtë Konventë, me kusht që vendi ose territori kandidat të ketë në fuqi një marrëveshje të tregtisë së lirë, që parashikon rregulla preferenciale të origjinës, me të paktën një prej palëve kontraktuese.
2. Një palë e tretë paraqet kërkesë me shkrim për aderim te depozituesi.
3. Depozituesi ia paraqet kërkesën Komitetit të Përbashkët për shqyrtim.
4. Vendimet e Komitetit të Përbashkët që ftojnë një palë të tretë të aderojë në këtë Konventë u dërgohen depozituesit, i cili brenda dy muajve ia transmeton atë palës së tretë kërkuese. Një palë e vetme kontraktuese nuk mund ta kundërshtojë atë vendim.
5. Një palë e tretë që ftohet për t'u bërë palë kontraktuese në këtë Konventë e bën këtë duke depozituar një instrument aderimi te depozituesi. Këto instrumente shoqërohen me një përkthim të Konventës në gjuhën(t) zyrtare të vendit ose territorit aderues.
6. Aderimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas depozitimit të instrumentit të aderimit.
7. Depozituesi njofton të gjitha palët kontraktuese për datën në të cilën është depozituar instrumenti i aderimit dhe datën në të cilën hyn në fuqi aderimi.



8. Rekomandimet dhe vendimet e Komitetit të Përbashkët të përmendura në nenin 4 (2) dhe (3) të miratuara ndërmjet datës së paraqitjes së kërkesës së përmendur në paragrafin 2 dhe datës në të cilën hyn në fuqi aderimi u komunikohen edhe palës së tretë aderuese nëpërmjet depozituesit.

Një deklaratë që pranon këto akte përfshihet në instrumentin e aderimit ose në një instrument të veçantë të depozituar te depozituesi brenda gjashtë muajve nga komunikimi. Nëse deklarata nuk depozitohet brenda asaj periudhe, aderimi konsiderohet i pavlefshëm.

PJESA IV DISPOZITA TË NDRYSHME DHE TË FUNDIT

Neni 6

Secila palë kontraktuese merr masat e përshtatshme për të siguruar që dispozitat e kësaj Konvente zbatohen me efektivitet, duke marrë parasysh nevojën e arritjes së zgjidhjeve të pranueshme reciproke për çdo vështirësi që rrjedh nga zbatimi i këtyre dispozitave.

Neni 7

Palët kontraktuese e mbajnë njëra-tjetrën të informuar nëpërmjet depozituesit për masat që ato miratojnë për zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 8

Shtojcat e kësaj Konvente janë pjesë përbërëse e saj.

Neni 9

Çdo palë kontraktuese mund të tërhiqet nga kjo Konventë me kusht që të bëjë një njoftim 12 muaj më parë me shkrim drejtuar depozituesit, i cili njofton të gjitha palët kontraktuese.

Neni 10

1. Kjo Konventë hyn në fuqi më 1.1.2011, në lidhje me ato palë kontraktuese që kanë depozituar atëherë instrumentin e tyre të pranimit me depozituesin, me kusht që të paktën dy palë kontraktuese të kenë depozituar instrumentet e tyre të pranimit te depozituesi më 31.12.2010.

2. Nëse kjo Konventë nuk hyn në fuqi më 1.1.2011, ajo hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas depozitimit të instrumentit të fundit të pranimit nga të paktën dy palë kontraktuese.

3. Në lidhje me një palë tjetër kontraktuese të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas depozitimit të instrumentit të pranimit.

4. Depozituesi njofton palët kontraktuese për datën e depozitimit të instrumentit të pranimit për çdo palë kontraktuese dhe datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente duke publikuar këtë informacion në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian, seria C.

Neni 11

Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Europian vepron si depozitues i kësaj Konvente.

SHTOJCA I
PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT TË “PRODUKTEVE TË ORIGINËS” DHE METODAT E
BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV

TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente:

- a) “Prodhim” është çdo lloj pune ose përpunimi, duke përfshirë montimin ose veprime të caktuara.
- b) “Material” është çdo përbërës, lëndë e parë, komponent ose pjesë etj., që përdoret në prodhimin e produktit.
- c) “Produkt” është produkti që prodhohet edhe nëse synohet për një përdorim të mëvonshëm në një operacion tjetër prodhues.
- d) “Mallra” janë si materialet, ashtu edhe produktet.
- e) “Vlerë doganore” është vlera që përcaktohet në pajtim me marrëveshjen e vitit 1994 për zbatimin e nenit VII të Marrëveshjes së përgjithshme për tarifat dhe tregtinë (marrëveshja e OBT-së për vlerësimin doganor).
- f) “Çmimi *ex-works*” është çmimi që i paguhet për produktin *ex-works* prodhuesit në palën kontraktuese, në ndërmarrjen e të cilit është kryer punimi ose përpunimi i fundi, me kusht që çmimi të përfshijë vlerën e të gjithë materialit të përdorur, minus çdo tatim të brendshëm që është ose mund të shlyhet nëse produkti i përfutur eksportohet.
- g) “Vlera e materialeve” është vlera doganore në momentin e importit të materialeve pa origjinë të përdorura, ose nëse kjo nuk dihet dhe nuk mund të konstatohet, çmimi i parë i konstatueshëm që paguhet për materialet në palën kontraktuese eksportuese.
- h) “Vlera e materialeve të origjinës” është vlera e këtyre materialeve që përkufizohet në (g) dhe zbatohet *mutatis mutandis*.
- i) “Vlerë e shtuar” konsiderohet të jetë çmimi *ex-works* minus vlerën doganore për secilin material të përfshirë që e ka origjinën në palët e tjera kontraktuese, me të cilat është i zbatueshëm kumulimi ose, nëse vlera doganore nuk dihet, ose nuk mund të konstatohet, çmimi i parë i konstatueshëm i paguar për materialet në palën kontraktuese eksportuese.
- j) “Kapituj” dhe “krerë” janë kapitujt dhe krerët (kode me katër shifra) që përdoren në nomenklaturën që përbën sistemin e harmonizuar të përshkrimit dhe kodimit të mallrave, të përmendur në këtë Konventë si “sistem i harmonizuar” ose “SH”.
- k) “Klasifikuar” i referohet klasifikimit të një produkti ose materiali sipas një kreu të caktuar.
- l) “Dërgesë” janë produktet që dërgohen njëkohësisht nga një eksportues te një marrës ose që mbulohet nga një dokument i vetëm transporti që mbulon dërgimin nga eksportuesi te marrësi, ose, në mungesë të një dokumenti të tillë, nga një faturë e vetme.
- m) “Territore” përfshijnë ujërat territoriale.
- n) “Autoritetet doganore të palëve kontraktuese” për Bashkimin Europian është çdo autoritet doganor i shteteve anëtare të Bashkimit Europian.

TITULLI II
PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT TË “PRODUKTEVE TË ORIGINËS”

Neni 2
Kërkesa të përgjithshme

1. Për qëllimet e zbatimit të Marrëveshjes përkatëse, produktet e mëposhtme konsiderohen të kenë origjinën në një palë kontraktuese nëse eksportohen në një palë tjetër kontraktuese:
 - a) produktet e përfutur tërësisht në palën kontraktuese brenda kuptimit të nenit 4;
 - b) produktet e përfutur në palën kontraktuese, duke përfshirë materiale që nuk janë përfutur plotësisht atje, me kusht që këto materiale t’u jenë nënshtruar punës ose përpunimit të mjaftueshëm në atë palë kontraktuese brenda kuptimit të nenit 5;



c) Mallrat me origjinë në zonën ekonomike europiane (EEA) brenda kuptimit të protokollit 4 të marrëveshjes mbi zonën ekonomike europiane; këto mallra konsiderohen sikur kanë origjinën në Bashkimin Europian, Islandë, Lihtenshtain¹ ose Norvegji (shtete të EEA-së) nëse eksportohen përkatësisht nga Bashkimi Europian, Islanda, Lihtenshtaini, ose Norvegjia të një palë kontraktuese të ndryshme nga palët e EEA-së.

2. Dispozitat e paragrafit 1 (c) zbatohen vetëm me kusht që marrëveshjet e tregtisë së lirë të jenë të zbatueshme ndërmjet palëve kontraktuese importuese dhe palëve të EEA-së (Bashkimi Europian, Islanda, Lihtenshtaini dhe Norvegjia).

Neni 3

Kumulimi i origjinës

1. Pa cenuar dispozitat e nenit 2 (1), produktet konsiderohen të kenë origjinën në palën kontraktuese eksportuese, kur eksportohen në një palë tjetër kontraktuese, nëse ato janë përftuar atje, duke përfshirë materiale që kanë origjinën në Zvicër (duke përfshirë Lihtenshtainin)², Islandë, Norvegji, Turqi ose në Bashkimin Europian, me kusht që punimi ose përpunimi i kryer në palën kontraktuese eksportuese shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6. Nuk është e nevojshme që këto materiale t'u nënshtrohen një punimi ose përpunimi të mjaftueshëm.

2. Pa cenuar dispozitat e nenit 2 (1), produktet konsiderohen të kenë origjinën në palën kontraktuese eksportuese nëse eksportohen në një palë tjetër kontraktuese, nëse ato janë përftuar atje, duke përfshirë materiale që kanë origjinën në ishujt Faroe ose në një vend tjetër që është pjesëmarrës në partneritetin euro-mediterian, bazuar në Deklaratën e Barcelonës të miratuar në konferencën euro-mediteriane të mbajtur më 27 dhe 28 nëntor 1995, përveç Turqisë, ose çdo palë kontraktuese tjetër e ndryshme nga ato të përmendura në paragrafin 1 në këtë Konventë, me kusht që punimi ose përpunimi i kryer në palën kontraktuese eksportuese shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6. Nuk është e nevojshme që këto materiale t'u nënshtrohen një punimi ose përpunimi të mjaftueshëm.

3. Nëse punimi ose përpunimi i kryer në palën kontraktuese eksportuese nuk shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6, produkti i përftuar konsiderohet me origjinë në palën kontraktuese eksportuese vetëm nëse vlera e shtuar është më e madhe se vlera e materialeve të përdorura me origjinë në një prej palëve të tjera kontraktuese të përmendura në paragrafët 1 dhe 2. Nëse nuk është kështu, produkti i përftuar konsiderohet me origjinë në palën kontraktuese që mbulon vlerën më të madhe të materialeve të origjinës të përdorura në prodhimin në palën kontraktuese eksportuese.

4. Produktet me origjinë në palët kontraktuese të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 që nuk u nënshtrohen ndonjë punimi apo përpunimi në palën kontraktuese eksportuese, ruajnë origjinën e tyre nëse eksportohen në një prej palëve të tjera kontraktuese.

5. Kumulimi i parashikuar në këtë nen mund të zbatohet vetëm me kusht që:

a) një marrëveshje preferenciale tregtare në pajtim me nenin XXIV të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi tarifën dhe tregtinë (GATT) është e zbatueshme ndërmjet palëve kontraktuese të përfshira në përfundim të statusit të origjinës dhe palës kontraktuese të destinacionit;

b) materialet dhe produktet kanë përftuar statusin e origjinës nëpërmjet zbatimit të rregullave të origjinës identike me ato të dhëna në këtë Konventë; dhe

c) njoftimet që tregojnë përmbushjen e kërkesave të nevojshme për të zbatuar kumulimin janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian (seria C) dhe në palët kontraktuese që janë palë në marrëveshjet përkatëse, sipas procedurave të tyre.

Kumulimi i parashikuar në këtë nen zbatohet nga data e treguar në njoftimin e publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian (seria C).

Palët kontraktuese u japin palëve të tjera kontraktuese që janë palë në marrëveshjet përkatëse, nëpërmjet Komisionit Europian, detaje të marrëveshjes, duke përfshirë datat e tyre të hyrjes në fuqi, që zbatohen me palët e tjera kontraktuese të përmendura në paragrafët 1 dhe 2.

¹ Për shkak të bashkimit doganor ndërmjet Lihtenshtainit dhe Zvicrës, produktet me origjinë në Lihtenshtain konsiderohen me origjinë në Zvicër.

² Principata e Lihtenshtainit ka bashkim doganor me Zvicrën dhe është palë kontraktuese në marrëveshjen për zonën ekonomike europiane.

Neni 4

Produkte të përfutuara plotësisht

1. Sa më poshtë, konsiderohen të përfutuara plotësisht në një palë kontraktuese nëse eksportohet në një palë tjetër kontraktuese:

- a) produktet minerale të nxjerra nga toka dhe nga shtrati detar i saj;
- b) produktet e perimeve të vjela atje;
- c) kafshët e gjalla të lindura dhe mbarështuara atje;
- d) produktet nga kafshët e gjalla e mbarështuara atje;
- e) produktet e përfutuara gjatë gjahut dhe peshkimit të zhvilluar atje;
- f) produktet e peshkimit në det ose produkte të tjera të marra nga deti jashtë ujërave territoriale të palëve kontraktuese eksportuese me mjetet lundruese të saj;
- g) produktet e bëra në bordin e anijeve fabrika të saj vetëm nga produktet e përmendura në (f);
- h) artikujt e përdorur të marrë atje janë të përshtatshëm vetëm për përfutimin e lëndëve të para, duke përfshirë gomat e përdorura që janë të përshtatshme vetëm për riveshje dhe për përdorim si mbeturina;
- i) mbeturinat dhe skrapi që mbeten nga operacionet e prodhimit të zhvilluara atje;
- j) produktet e nxjerra nga toka detare ose nëntoka jashtë ujërave të saj territoriale, me kusht që të ketë të drejta ekskluzive për të punuar në atë tokë ose nëntokë;
- k) mallrat e prodhuara atje ekskluzivisht nga produktet e përcaktuara në (a) deri (j).

2. Termat “anijet e saj” dhe “anijet fabrika të saj” në paragrafët 1(f) dhe (g) zbatohen vetëm për mjetet lundruese dhe anijet fabrika:

- a) që janë regjistruar në palën kontraktuese eksportuese;
- b) që lundrojnë nën flamurin e palës kontraktuese eksportuese;
- c) që janë në pronësi në një masë prej të paktën 50% nga shtetas të palës kontraktuese eksportuese ose nga një shoqëri që ka selinë në palën kontraktuese eksportuese, menaxheri ose menaxherët e së cilës, Kryetari i Bordit të Drejtorëve ose Bordi Mbikëqyrës dhe shumica e anëtarëve të këtyre bordeve janë shtetas të palës kontraktuese eksportuese dhe përveç kësaj, në rastin e partneriteteve ose shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, të paktën gjysma e kapitalit i takon palës kontraktuese eksportuese ose organeve publike apo shtetasve të kësaj pale kontraktuese;

d) kur kapiteni dhe oficerët janë shtetas të palës kontraktuese eksportuese; dhe

e) ku të paktën 75 % e ekuipazhit janë shtetas të palës kontraktuese eksportuese.

3. Për qëllimin e paragrafit 2 (a) dhe (b), nëse pala kontraktuese eksportuese është Bashkimi European, kjo do të thotë një shtet anëtar i Bashkimit European.

Neni 5

Produkte të punuara ose përpunuara në masë të mjaftueshme

1. Për qëllimet e nenit 2, produktet që nuk përfutohen tërësisht konsiderohen të jenë punuar ose përpunuar në masë të mjaftueshme nëse përmbushen kushtet e përcaktuara në listën e aneksit II.

Kushtet e përmendura më sipër tregojnë punimin ose përpunimin që duhet të kryhet për materialet pa origjinë të përdorura në prodhim dhe zbatohen vetëm në lidhje me këto materiale. Rezulton që nëse një produkt që ka përfutur statusin e origjinës duke përmbushur kushtet e përcaktuara në listë përdoret në prodhimin e një produkti tjetër, kushtet e zbatueshme për produktin në të cilin trupëzohet ai nuk zbatohen për të dhe nuk merren parasysh materialet pa origjinë që mund të jenë përdorur në prodhimin e tij.

2. Pavarësisht paragrafit 1, materialet pa origjinë, të cilat sipas kushteve të përcaktuara në listën e aneksit II, nuk duhet të përdoren në prodhimin e një produkti, megjithatë mund të përdoren, me kusht që:

a) vlera e tyre e plotë të mos kalojë 10 % të çmimit *ex-works* të produktit;

b) çdo përqindje e dhënë në listën e vlerës maksimale të materialeve pa origjinë të mos kalohet bazuar në këtë paragraf.

Ky paragraf nuk zbatohet për produktet që rregullohen nga kapitujt 50 deri 63 të sistemit të harmonizuar.

3. Paragrafët 1 dhe 2 zbatohen në pajtim me dispozitat e nenit 6.



Neni 6

Punim ose përpunim i pamjaftueshëm

1. Pa cenuar paragrafin 2, operacionet e mëposhtme konsiderohen si punim ose përpunim i pamjaftueshëm për t'u dhënë produkteve statusin e origjinës, pavarësisht nëse përmbushen apo jo kërkesat e nenit 5.

a) operacionet e mirëmbajtjes për të siguruar që produktet të mbahen në gjendje të mirë gjatë transportit dhe magazinimit;

b) çmontimi dhe montimi i paketave;

c) larja, pastrimi, heqja e pluhurit, oksidimit, vajit, bojës ose mbulesave të tjera;

d) hekurosja ose presimi i tekstileve;

e) operacionet e thjeshta të lyerjes dhe lustrimit;

f) zhvoshkja, zbardhja e plotë ose e pjesshme, lustrimi dhe shkëlqimi i drithërave dhe orizit;

g) operacionet për ngjyrosjen e sheqerit ose për të formuar kokrrat e sheqerit;

h) qërimi, heqja e bërthamës dhe lëvores së frutave, arrave dhe perimeve;

i) mprehja, bluarja e thjeshtë ose prerja e thjeshtë;

j) sitja, kontrolli, seleksionimi, klasifikimi, kategorizimi, bashkimi (duke përfshirë bërjen e kompleteve të artikujve);

k) vendosja e thjeshtë në shishe, konserva, çanta, kuti, fiksime në karton ose dërrasë dhe të gjitha operacionet e paketimit të thjeshtë;

l) ngjitja ose printimi i shenjave, etiketave, logove ose shenjave të tjera dalluese në produkte ose paketimin e tyre;

m) përzjerja e thjeshtë e produkteve, me ose pa lloje të ndryshme;

n) përzjerja e sheqerit me çdo material;

o) montim i thjeshtë i pjesëve të artikujve për të përbërë një artikull të plotë ose çmontimi i produkteve në pjesë;

p) një kombinim i dy ose më shumë operacioneve të përcaktuara nga (a) deri (n);

q) therja e kafshëve.

2. Të gjitha operacionet e kryera në palën kontraktuese eksportuese për një produkt të caktuar konsiderohen së bashku gjatë përcaktimit nëse punimi ose përpunimi i trupëzuar në atë produkt duhet të konsiderohet i paplotë sipas kuptimit të paragrafit 1.

Neni 7

Njësia e kualifikimit

1. Njësia e kualifikimit për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente është produkti i veçantë që konsiderohet si njësi bazë kur përcaktohet klasifikimi duke përdorur nomenklaturën e sistemit të harmonizuar.

Nxirret përfundimi që:

a) nëse një produkt që përbëhet nga një grup ose montim artikujsh klasifikohet sipas termave të sistemit të harmonizuar në një kre të vetëm, i gjithi përbën njësinë e kualifikimit;

b) nëse një dërgesë përbëhet nga një numër produktesh identike të klasifikuara sipas të njëjtit kre të sistemit të harmonizuar, secili produkt duhet të merret individualisht gjatë zbatimit të dispozitave të kësaj Konvente.

2. Nëse, sipas rregullit të përgjithshëm 5 të sistemit të harmonizuar, paketimi përfshihet në produkt për qëllime klasifikimi, ai përfshihet për qëllimin e përcaktimit të origjinës.

Neni 8

Aksesorë, pjesë këmbimi dhe vegla

Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe veglat e dërguara me një pjesë pajisjeje, makinerie, aparati apo instrumenti që janë pjesë e pajisjes normale dhe e përfshirë në çmimin e saj ose që nuk janë faturuar veçmas konsiderohen si një pjesë me pajisjen, makinerinë, aparatit ose instrumentin në fjalë.

Neni 9
Kompletet

Kompletet që përkufizohen në rregullin e përgjithshëm 3 të sistemit të harmonizuar konsiderohen me origjinë nëse të gjitha produktet e komponentëve janë me origjinë. Megjithatë, nëse një komplet përbëhet nga produkte me dhe pa origjinë, kompleti si i tërë konsiderohet me origjinë, me kusht që vlera e produkteve pa origjinë të mos kalojë 15% të çmimit *ex-works* të kompletit.

Neni 10
Elementet neutrale

Me qëllim që të përcaktohet nëse një produkt është produkt origjine, nuk është e nevojshme të përcaktohet origjina e sa më poshtë, të cilat mund të përdoren në prodhimin e tij:

- a) energjia dhe karburantet;
- b) fabrika dhe pajisjet;
- c) makineritë dhe veglat;
- d) mallrat që nuk përfshihen në përbërjen përfundimtare të produktit dhe që nuk janë të destinuara për këtë.

TITULLI III
KËRKESAT TERRITORIALE

Neni 11
Parimi i territorialitetit

1. Përveç kur parashikohet në nenin 2 (1) (c), nenin 3 dhe paragrafin 3 të këtij neni, kushtet për përfitim e statusit të origjinës të parashikuara në titullin II duhet të përmbushen pa ndërprerje në palën kontraktuese eksportuese.

2. Përveç kur parashikohet në nenin 3, nëse mallrat me origjinë të eksportuara nga një palë kontraktuese të një vend tjetër kthehen, ato duhet të konsiderohen pa origjinë, përveç kur demonstrohet, sipas bindjes së autoriteteve të doganave që:

- a) mallrat e kthyer janë të njëjtat si ato që u eksportuan; dhe
- b) ato nuk kanë pësuar asnjë operacion tej asaj që është e nevojshme për t'i mbajtur ato në gjendje të mirë në vendin tjetër ose gjatë eksportimit.

3. Përfitimi i statusit origjinues në përputhje me kushtet e përcaktuara në titullin II nuk do të ndikohet nga punime apo përpunime të kryera jashtë palëve kontraktuese eksportuese ndaj materialeve të eksportuara nga pala e fundit kontraktuese dhe riimportuar atje, duke siguruar që:

- a) materialet në fjalë janë plotësisht të përfutuara në palën kontraktuese eksportuese ose mbi to janë kryer punime apo përpunime përtej operacioneve që u referohen nenit 6 përpara se të jenë të eksportuara; dhe
- b) të demonstrohet për të bindur autoritetet doganore që:
 - i) mallrat e riimportuara kanë qenë përftuar nga punime apo procese të materialeve të eksportuara; dhe

ii) vlera totale e shtuar e përftuar jashtë palës kontraktuese eksportuese sipas zbatimit të dispozitave të këtij neni, nuk kalon 10 % të çmimit "*ex-work*" të produktit përfundimtar, për të cilin është kërkuar statusi origjinues.

4. Për qëllime të paragrafit 3, kushtet për përfitim e statusit origjinues përcaktuar në titullin II nuk do të zbatohen për punime apo procese të bëra jashtë palëve kontraktuese eksportuese. Në rastet kur, në listën e aneksit II, rregulli i përcaktuar që ka të bëjë me vlerën maksimale të të gjitha materialeve të bashkëngjitura joorigjinuese, zbatohet në përcaktimin e statusit të origjinës së produktit përfundimtar, vlera totale e materialeve të bashkëngjitura joorigjinuese në territorin e palës kontraktuese eksportuese, marrë së bashku me vlerën totale të shtuar të përftuar jashtë kësaj pale kontraktuese sipas zbatimit të dispozitave të këtij neni, nuk duhet të tejkalojë përqindjen e përcaktuar.

5. Për qëllime të zbatimit të dispozitave të paragrafit 3 dhe 4, "vlera totale e shtuar" do të merret në kuptimin e të gjitha kostove të bëra jashtë palës kontraktuese eksportuese, përfshi dhe vlerën e materialeve të bashkëngjitura atje.



6. Dispozitat e paragrafit 3 dhe 4 nuk do të zbatohen ndaj produkteve që nuk përmbushin kushtet e përcaktuara në listën e aneksit II ose të cilat mund të konsiderohen të punuara ose përpunuara në masë të mjaftueshme vetëm nëse zbatohet toleranca e përgjithshme e përcaktuar në nenin 5 (2).

7. Dispozitat e paragrafit 3 dhe 4 nuk do të zbatohen për produktet e kapitujve nga 50 në 63 të sistemit të harmonizuar.

8. Çdo lloj punimi apo procesi që është objekt i dispozitave të këtij neni dhe është kryer jashtë palës kontraktuese eksportuese, bëhet me marrëveshje të jashtme ose masë të ngjashme.

Neni 12

Transporti i drejtpërdrejtë

1. Trajtimi preferencial i parashikuar në marrëveshjen përkatëse aplikohet vetëm për produktet, që plotësojnë kërkesat e kësaj Konvente, të cilat janë transportuar drejtpërsëdrejti ndërmjet ose përmes territoreve të palëve kontraktuese, me të cilat kumulimi është në pajtim me nenin 3. Sidoqoftë, produktet që përbëhen nga një dërgesë e vetme mund të transportohen nëpërmjet territoreve të tjera, nëse paraqitet e nevojshme, me lëvizje transit ose magazinim të përkohshëm në këto territore, me kusht që ato të mbeten nën vëzhgimin e autoriteteve doganore të vendit transit ose të magazinimit dhe nuk u nënshtrohen operacioneve të tjera veç atyre të ngarkim-shkarkimit, ose ndonjë operacioni tjetër me synim për t'i mbajtur ato në kushte të mira.

Produktet origjinuese mund të transportohen me tubacione përmes territorit, përveç asaj të palëve kontraktuese që veprojnë si palë eksportuese dhe importuese.

2. Të dhënat që vërtetojnë se kushtet e vendosura në paragrafin 1 janë plotësuar tërësisht duhet t'u jepen autoriteteve doganore të palës kontraktuese importuese, të cilat duhet të përfshijnë:

a) një dokument të vetëm transporti që tregon kalimin nga pala kontraktuese eksportuese përmes vendit transit; ose

b) një certifikatë të lëshuar nga autoritetet doganore të vendit transit;

i) duke dhënë një përshkrim të saktë të produkteve;

ii) duke paraqitur datat e shkarkimit dhe ngarkimit të produkteve dhe, nëse është e zbatueshme, emrat e anijeve, ose llojet e tjera të transportit të përdorur; si dhe

iii) një vërtetim të kushteve nën të cilat ka qëndruar produkti në vendin transit;

c) nëse nuk mundësohen këto dokumente, një dokument tjetër të rëndësishëm.

Neni 13

Ekspozitat

1. Produktet origjinuese, të dërguara për ekspozim në një vend tjetër të ndryshëm nga ai i përmendur në nenin 3, me të cilin kumulimi është i zbatueshëm dhe të shitura pas ekspozimit për importim në një palë kontraktuese, do të përfitojnë në lidhje me këtë importim, nga dispozitat e marrëveshjes, pasi të ketë siguruar autoritetet doganore që:

a) një eksportues i ka dërguar këto produkte nga një palë kontraktuese në vendin në të cilin bëhet ekspozita dhe i ka ekspozuar ato atje;

b) produktet janë shitur ose në të kundërt, u janë vënë në dispozicion nga ky eksportues personit në një palë kontraktuese;

c) produktet janë dorëzuar gjatë ekspozitës ose menjëherë pas tij në shtetin në të cilin ato janë dërguar për ekspozim; dhe

d) produktet nuk janë përdorur, që nga momenti kur ato u dërguan në ekspozitë, për ndonjë qëllim tjetër veçse atij të ekspozimit.

2. Vërtetimi i origjinës duhet të jetë lëshuar ose bërë në përputhje me dispozitat e titullit V dhe të jetë depozituar pranë autoriteteve doganore të palës kontraktuese importuese në formë normale. Emri dhe adresa e ekspozitës duhet të jenë të shprehura qartë në të. Kur paraqitet e nevojshme, mund të kërkohen të dhëna shtesë dokumentare në lidhje me kushtet e ekspozimit.

3. Paragrafi 1 do të aplikohet për çdo lloj ekspozimi, prezantimi të thjeshtë apo panairi publik tregtar, industrial, bujqësor ose artizanal, të cilët nuk duhet të jenë të organizuara për qëllime private në dyqane apo biznese me synimin e shitjes së mallrave nga jashtë dhe gjatë të cilëve produktet u nënshtrohen kontrollit doganor.

TITULLI IV TËRHEQJA OSE PËRJASHTIMI

Neni 14

Ndalimi i tërheqjes ose përjashtimit nga detyrimet doganore

1. Materialet joorigjinuese të përdorura në prodhimin e një produkti origjinues në një palë kontraktuese, për të cilat vërtetimi i origjinës është lëshuar ose bërë në përputhje me dispozitat e titullit V, nuk u nënshtrohen të pala kontraktuese eksportuese tërheqjes ose përjashtimit nga detyrimet doganore të çdo lloji.

2. Ndalimi në paragrafin 1 do të aplikohet për çdo lloj rregullimi për rimbursim, anulimi të borxheve ose mospagesave, pjesore ose tërësore, të detyrimeve doganore ose detyrimeve të tjera me të njëjtin efekt, të aplikueshme në palën kontraktuese eksportuese, për materialet e përdorura në prodhim, nëse rimbursimet, anulimet e borxheve ose mospagimet e tilla aplikohen, shprehimisht ose në fuqi, kur produktet e përfutuara nga materialet e mësipërme janë eksportuar dhe jo kur ato mbahen atje për përdorim në vend.

3. Eksportuesi i produkteve mbuluar nga vërtetimi i origjinës duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë me kërkesën e autoriteteve doganore, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë se asnjë tërheqje nuk është bërë në lidhje me materialet joorigjinuese të përdorura në prodhimin e produkteve në fjalë dhe se të gjitha detyrimet doganore ose detyrimet e tjera me të njëjtin efekt, të aplikueshme në të tilla materiale aktualisht kanë qenë paguar.

4. Dispozitat e paragrafëve nga 1 deri 3, gjithashtu, do të aplikohen në lidhje me paketimin brenda kuptimit të nenit 7 (2), aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentet, brenda kuptimit të nenit 8 dhe produktet në një komplet, brenda kuptimit të nenit 9, kur përbërës të tillë nuk janë origjinues.

5. Dispozitat e paragrafëve nga 1 në 4, do të aplikohen vetëm për materialet të cilat janë të llojit për të cilat aplikohet marrëveshja.

6. a) Ndalimi i paragrafit 1 nuk zbatohet në tregtinë bilaterale ndërmjet një pale kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) me një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2), duke përjashtuar Izraelin, ishujt Faroe dhe vendet që marrin pjesë në procesin e stabilizimit dhe asociimit, nëse produktet konsiderohen me origjinë në palën kontraktuese eksportuese ose importuese pa zbatimin e kumulimit me materialet me origjinë në një prej palëve të tjera kontraktuese të përmendura në nenin 3.

b) Ndalimi i paragrafit 1 nuk zbatohet në tregtinë bilaterale ndërmjet Egjiptit, Jordanisë, Marokut dhe Tunizisë nëse produktet konsiderohen me origjinë në një prej këtyre vendeve pa zbatimin e kumulimit me materialet me origjinë në një prej palëve të tjera kontraktuese të përmendura në nenin 3.

7. Pavarësisht nga paragrafi 1, palët kontraktuese eksportuese, përveç produkteve që përfshihen në kapitujt 1 deri 24 të sistemit të harmonizuar, mund të aplikojnë rregullimet për tërheqje ose përjashtime nga tarifatat doganore, ose detyrime të tjera me të njëjtin efekt, të aplikueshme në materialet e përdorura në prodhimin e produkteve origjinuese, në pajtim me dispozitat e mëposhtme:

a) një normë 4 për qind e tarifës doganore do të mbahet për produktet e përfshira nga kapitulli 25 deri 49 dhe nga 64 deri 97 të sistemit të harmonizuar ose norma të tilla më të ulëta siç është në fuqi në palën kontraktuese eksportuese;

b) një normë 8 për qind e tarifës doganore do të mbahet për produktet e përfshira nga kapitulli 50 deri 63 të sistemit të harmonizuar ose norma të tilla më të ulëta siç është në fuqi në palën kontraktuese eksportuese.

Dispozitat e këtij paragrafi do të aplikohen nga palët kontraktuese të renditura në aneksin e kësaj shtojce.

8. Dispozitat e paragrafit 7 do të zbatohen deri më 31 dhjetor 2012 dhe mund të rishikohen me marrëveshje të përbashkët.

TITULLI V VËRTETIMI I ORIGJINËS

Neni 15

Kërkesa të përgjithshme

1. Produktet origjinuese në një palë kontraktuese gjatë importimit në palë të tjera kontraktuese, do të përfitojnë nga dispozitat e marrëveshjeve përkatëse me paraqitjen e një prej vërtetimeve të mëposhtme të origjinës:

a) një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1, një formë e së cilës tregohet në aneksin III a;



b) një certifikatë qarkullimi mallrash EUR-MED, një formë e së cilës tregohet në aneksin III b;
c) në rastet e specifikuara në nenin 21 (1) të një deklarate që këtu quhet “deklarata e origjinës” ose “deklarata e origjinës EUR-MED”, të dhënë nga eksportues në një faturë, një notë dërguese apo një dokument tjetër tregtar, ku të përshkruhen produktet në detaje të mjaftueshme për t’u identifikuar; tekstet e deklaratave të origjinës shfaqen në anekset IV a dhe b.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, produktet origjinuese në kuptimin e kësaj Konvente, për sa i takon rasteve të specifikuara në nenin 26, do të përfitojnë nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje, pa qenë e nevojshme të paraqesë ndonjë vërtetim origjine të përmendur më sipër.

Neni 16

Procedura për lëshimin e një certifikate qarkullimi EUR.1 ose EUR-MED

1. Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 ose EUR-MED do të lëshohet nga autoritetet doganore të palës kontraktuese eksportuese mbështetur në aplikimin e bërë me shkrim nga eksportuesi ose, nën përgjegjësinë e eksportuesit, nga përfaqësuesi i tij i autorizuar.

2. Për këtë qëllim, eksportuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar do të plotësojnë të dyja certifikatat EUR.1 ose EUR-MED dhe formularin e aplikimit, një shembull i së cilës tregohet në aneksin III a dhe b. Këta formularë do të plotësohen në një nga gjuhët në të cilat kjo marrëveshje është nënshkruar dhe në përputhje me dispozitat e ligjit vendas të vendit eksportues. Nëse ato janë të shkruara me dorë, ato do të plotësohen me bojë me germa kapitale. Përshkrimi i produkteve duhet të jepet në një kuti të rezervuar për këtë qëllim pa lënë ndonjë rresht bosh. Kur kutia nuk është e plotësuar tërësisht, një vijë horizontale duhet të hiqet poshtë vijës së fundit së përshkrimit, përmes hapësirës boshe.

3. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1 ose EUR-MED do të përgatitet për të depozituar në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të palës kontraktuese eksportuese, ku certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 ose EUR-MED është lëshuar, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë statusin e origjinës së produktit në fjalë, si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të kësaj Konvente.

4. Pa cenuar paragrafin 5, një certifikatë qarkullimi EUR.1 do të lëshohet nga autoritetet doganore të palës kontraktuese eksportuese në rastet e mëposhtme:

a) nëse produktet eksportohen nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) të një palë tjetër kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) dhe:

i) produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në palën kontraktuese eksportuese, në palën kontraktuese importuese ose në një nga palët e tjera kontraktuese të përmendura në nenin 3 (1), me të cilat aplikohet kumulimi, pa zbatuar kumulimin me materialet që kanë origjinën në një nga palët kontraktuese të përmendura në nenin 3 (2), dhe përmbushin kërkesat e tjera të kësaj Konvente; ose

ii) produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2), me të cilat aplikohet kumulimi, pa zbatuar kumulimin me materialet që kanë origjinën në një nga palët kontraktuese të përmendura në nenin 3, dhe përmbushin kërkesat e tjera të kësaj Konvente, me kusht që të jetë lëshuar një certifikatë EUR-MED ose një deklaratë origjine EUR-MED në vendin e origjinës;

b) nëse produktet eksportohen nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) të një palë tjetër kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2) ose nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2) në një nga palët e tjera kontraktuese të përmendura në nenin 3 (1) dhe:

i) produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në palën kontraktuese eksportuese ose në palën kontraktuese importuese pa zbatuar kumulimin me materialet që kanë origjinën në një nga palët kontraktuese, dhe përmbushin kërkesat e tjera të kësaj Konvente; ose

ii) produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3, me të cilat aplikohet kumulimi, pa zbatuar kumulimin me materialet që kanë origjinën në një nga palët kontraktuese të përmendura në nenin 3, dhe përmbushin kërkesat e tjera të kësaj konvente, me kusht që të jetë lëshuar një certifikatë EUR-MED ose një deklaratë origjine EUR-MED në vendin e origjinës;

c) nëse produktet eksportohen nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2) të një palë tjetër kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2) dhe:

i) produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në palën kontraktuese eksportuese ose në palën kontraktuese importuese pa zbatuar kumulimin me materialet që kanë origjinën në një nga palët kontraktuese, dhe përmbushin kërkesat e tjera të kësaj Konvente; ose

ii) produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3, me të cilat aplikohet kumulimi, pa zbatuar kumulimin me materialet që kanë origjinën në një nga palët kontraktuese të përmendura në nenin 3, dhe përmbushin kërkesat e tjera të kësaj Konvente, me kusht që të jetë lëshuar një certifikatë EUR-MED ose një deklaratë origjine EUR-MED në vendin e origjinës.

5. Një certifikatë qarkullimi EUR-MED do të lëshohet nga autoritetet doganore të palës kontraktuese eksportuese, nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në palën kontraktuese eksportuese, në palën kontraktuese importuese ose në një prej palëve të tjera kontraktuese të përmendura në nenin 3 me të cilat është i zbatueshëm kumulimi dhe përmbush kërkesat e kësaj Konvente, në rastet e mëposhtme:

a) nëse produktet eksportohen nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) te një palë tjetër kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) dhe:

i) kumulimi është zbatuar me materialet që kanë origjinën në një ose më shumë nga palët kontraktuese të përmendura në nenin 3 (2), me kusht që të jetë lëshuar një certifikatë EUR-MED ose një deklaratë origjine EUR-MED në vendin e origjinës; ose

ii) produktet mund të përdoren në palën kontraktuese importuese si materiale në kontekstin e kumulimit për prodhimin e produkteve për eksport nga pala kontraktuese importuese te një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2); ose

iii) produktet mund të riekportohen nga pala kontraktuese importuese te një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2);

b) nëse produktet eksportohen nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) te një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2) ose nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2) te një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) dhe:

i) kumulimi është zbatuar me materialet që kanë origjinën në një ose më shumë nga palët kontraktuese të përmendura në nenin 3, me kusht që të jetë lëshuar një certifikatë EUR-MED ose një deklaratë origjine EUR-MED në vendin e origjinës, ose

ii) produktet mund të përdoren në palën kontraktuese importuese si materiale në kontekstin e kumulimit për prodhimin e produkteve për eksport nga pala kontraktuese importuese te një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3; ose

iii) produktet mund të riekportohen nga pala kontraktuese importuese te një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3;

c) nëse produktet eksportohen nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2) te një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2):

i) kumulimi është zbatuar me materialet që kanë origjinën në një ose më shumë nga palët kontraktuese të përmendura në nenin 3, me kusht që të jetë lëshuar një certifikatë EUR-MED ose një deklaratë origjine EUR-MED në vendin e origjinës; ose

ii) produktet mund të përdoren në palën kontraktuese importuese si materiale në kontekstin e kumulimit për prodhimin e produkteve për eksport nga pala kontraktuese importuese te një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3; ose

iii) produktet mund të riekportohen nga pala kontraktuese importuese te një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3.

6. Një certifikatë qarkullimi EUR-MED përmban një prej deklarimeve të mëposhtme në anglisht në kutinë 7:

a) nëse origjina është përfutur nëpërmjet aplikimit të kumulimit me materialet me origjinë në një ose më shumë prej palëve kontraktuese:

“CUMULATION APPLIED WITH” (emri i vendit/vendeve);

b) nëse origjina është përfutur jo nëpërmjet aplikimit të kumulimit me materialet me origjinë në një ose më shumë prej palëve kontraktuese:

“NO CUMULATION APPLIED”.

7. Autoritetet doganore që lëshojnë certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 do të ndërmarrin masa apo hapa të nevojshëm për të verifikuar statusin e origjinës së produkteve dhe plotësimin e kërkesave të



tjera të kësaj Konvente. Për këtë qëllim, ato kanë të drejtë të kërkojnë çdo evidencë apo të ndërmarrin ndonjë inspektim të llogarive financiare të eksportuesit ose ndonjë kontroll tjetër që ata e konsiderojnë të nevojshëm. Autoritetet doganore në lëshimin e certifikatave të tilla, gjithashtu, do të sigurojnë që formularët referuar paragrafit 2 janë të plotësuar përkatësisht. Në veçanti, ata do të kontrollojnë nëse hapësira e rezervuar për përshkrimin e produkteve është plotësuar në mënyrë të tillë që përjashton të gjitha mundësitë për shtesa false.

8. Data e lëshimit të një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 ose EUR-MED do të tregohet në kutinë 11 të certifikatës.

9. Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 ose EUR-MED do të lëshohet nga autoritetet doganore dhe do të bëhet e vlefshme për eksportuesin sapo eksportimi aktual të jetë kryer ose siguruar.

Neni 17

Certifikatat e qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED të lëshuara me efekt prapaveprues

1. Pavarësisht nga neni 16 (9), një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 ose EUR-MED mund përjashtimisht të lëshohet pas eksportimit të produkteve të cilëve u referohet, nëse:

a) ajo nuk është lëshuar në kohën e eksportimit për shkak të gabimeve ose mungesave të pavullnetshme ose rrethanave të veçanta; ose

b) është demonstruar pranë autoriteteve doganore që një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 ose EUR-MED është lëshuar po nuk është pranuar gjatë importimit për arsye teknike.

2. Pavarësisht nga neni 16 (9), një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 ose EUR-MED mund të lëshohet pas eksportimit të produkteve të cilëve iu referohet, për të cilët është lëshuar një certifikatë EUR.1 në momentin e eksportimit, me kusht që të demonstrohet dhe pranohet nga autoritetet doganore që janë përmbushur kushtet e përmendur në nenin 16 (5).

3. Për zbatimin e paragrafëve 1 dhe 2, eksportuesi duhet të tregojë në aplikimin e tij vendin dhe datën e eksportimit të produkteve me të cilët ka të bëjë certifikata e qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED, dhe të deklarojë arsyet për kërkesën e tij.

4. Autoritetet doganore mund të lëshojnë një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 ose EUR-MED aposteriori, vetëm pasi të jetë verifikuar se informacioni i dhënë nga eksportuesi në aplikim është i njëjtë me atë të dosjeve korresponduese.

5. Certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 ose EUR-MED lëshuar aposteriori duhet të mbyllet me një nga frazat e mëposhtme në gjuhën angleze:

“ISSUED RETROSPECTIVELY”.

Certifikata e qarkullimit të mallrave EUR-MED lëshuar aposteriori nëpërmjet zbatimit të paragrafit 2 duhet të mbyllet me një nga frazat e mëposhtme në gjuhën angleze:

“ISSUED RETROSPECTIVELY (origjinali EUR.1 nr.[data dhe vendi i lëshimit]”.

6. Mbyllja e përmendur në paragrafin 5 do të vendoset në kutinë 7 të certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1 ose EUR-MED.

Neni 18

Lëshimi i një certifikate qarkullimi dublikatë EUR.1 ose EUR-MED

1. Në rast vjedhjeje, humbjeje apo shkatërrimi të një certifikate qarkullimi EUR.1, ose EUR-MED, eksportuesi mund të aplikojë tek autoritetet doganore të cilat e kanë lëshuar atë, për një dublikatë që bëhet në bazë të dokumenteve të eksportit në zotërim të tyre.

2. Dublikata e lëshuar në këtë mënyrë duhet të mbyllet me një nga fjalët e mëposhtme në gjuhën angleze:

“DUPLICATE”.

3. Shënimi i referuar në paragrafin 2 do të vendoset në kutinë 7 të dublikatës së certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1 ose EUR-MED.

4. Dublikata e cila duhet të tregojë dhe datën e lëshimit të certifikatës origjinale të qarkullimit të mallrave EUR ose EUR-MED, do të ketë fuqi që nga ajo datë.

Neni 19

Lëshimi i një certifikate qarkullimi EUR.1 ose EUR-MED mbi bazën e një vërtetimi origjine të lëshuar ose bërë më parë

Kur produktet origjinuese janë vendosur nën kontrollin e një zyre doganore në një palë kontraktuese, do të jetë e mundur të zëvendësohet me vërtetimin origjinal të origjinës me një ose më shumë certifikata të qarkullimit të mallrave EUR.1 ose EUR-MED për qëllime të dërgimit të të gjitha ose disa nga këto produkte diku brenda palës kontraktuese. Zëvendësimi i certifikatës/ave të qarkullimit të mallrave EUR.1 ose EUR-MED do të lëshohet nga zyra doganore nën kontrollin e së cilës janë të vendosura këto produkte.

Neni 20

Ndarja e llogarive

1. Kur shkaktohen kosto të konsiderueshme apo vështirësi materiale në lidhje me mbajtjen e materialeve stok origjinuese ose joorigjinuese, të cilat janë të identifikuar dhe të zëvendësueshme, autoritetet doganore me kërkesë me shkrim nga të interesuarit, mund të autorizojnë të përdoret e ashtuquajtura metodë e “ndarjes së llogarive” (këtu quhet “metoda”) për menaxhimin e stokeve të tilla.

2. Kjo metodë do të sigurojë që për një periudhë reference specifike, numri i produkteve të marra të cilat konsiderohen si origjinuese është i njëjtë me ato të cilat janë marrë nëse ka pasur rast të ndarjes fizike të tyre në stoke.

3. Autoritetet doganore mund të japin autorizime të përmendura në paragrafin 1, në bazë të kushteve që konsiderohen të përshtatshme.

4. Kjo metodë regjistrohet dhe aplikohet bazuar në parimet e përgjithshme të kontabilitetit të zbatueshme në vendin ku janë prodhuar produktet.

5. Përfituesit nga kjo lehtësi mund të lëshojnë ose të aplikojnë për vërtetimin e origjinës, nëse paraqitet rasti, për sasinë e produkteve, të cilat mund të konsiderohen si origjinuese. Me kërkesë të autoriteteve doganore, përfituesit duhet të paraqesin me një shkresë mënyrën sesi janë menaxhuar sasi të.

6. Autoritetet doganore do të mbikëqyrin mënyrën e përdorimit të autorizimit dhe kanë të drejtë ta tërheqin atë në çdo kohë kur përfituesi e keqpërdor këtë autorizim ose kur nuk përmbush ndonjë nga kushtet që përcakton kjo Konventë.

Neni 21

Kushtet për bërjen e një deklarimi origjine ose deklarimi origjine EUR-MED

1. Një deklaratë origjine ose një deklaratë origjine EUR-MED, siç i referohet në nenin 15 (1) (c) mund të përgatitet:

a) nga një eksportues i aprovuar, në kuptimin e nenit 22; ose

b) nga një eksportues i ndonjë dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera totale e të cilave nuk i kalon 6 000 euro.

2. Pa cenuar paragrafin 3, një certifikatë origjine do të lëshohet në rastet e mëposhtme:

a) nëse produktet eksportohen nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) të një palë tjetër kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) dhe:

i) produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në palën kontraktuese eksportuese, në palën kontraktuese importuese ose në një nga palët e tjera kontraktuese të përmendura në nenin 3 (1) me të cilat aplikohet kumulimi, pa zbatuar kumulimin me materialet që kanë origjinën në një nga palët kontraktuese të përmendura në nenin 3 (2), dhe përmbushin kërkesat e tjera të kësaj Konvente; ose

ii) produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2), me të cilat aplikohet kumulimi, pa zbatuar kumulimin me materialet që kanë origjinën në një nga palët kontraktuese të përmendura në nenin 3, dhe përmbushin kërkesat e tjera të kësaj Konvente, me kusht që të jetë lëshuar një certifikatë EUR-MED ose një deklaratë origjine EUR-MED në vendin e origjinës;

b) nëse produktet eksportohen nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) të një palë tjetër kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2) ose nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2) në një nga palët e tjera kontraktuese të përmendura në nenin 3 (1) dhe:



i) produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në palën kontraktuese eksportuese ose në palën kontraktuese importuese pa zbatuar kumulimin me materialet që kanë origjinën në një nga palët kontraktuese, dhe përbushin kërkesat e tjera të kësaj Konvente; ose

ii) produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3, me të cilat aplikohet kumulimi, pa zbatuar kumulimin me materialet që kanë origjinën në një nga palët kontraktuese të përmendura në nenin 3, dhe përbushin kërkesat e tjera të kësaj Konvente, me kusht që të jetë lëshuar një certifikatë EUR-MED ose një deklaratë origjine EUR-MED në vendin e origjinës;

c) nëse produktet eksportohen nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2) të një palë tjetër kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2) dhe:

i) produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në palën kontraktuese eksportuese ose në palën kontraktuese importuese pa zbatuar kumulimin me materialet që kanë origjinën në një nga palët kontraktuese, dhe përbushin kërkesat e tjera të kësaj Konvente; ose

ii) produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3, me të cilat aplikohet kumulimi, pa zbatuar kumulimin me materialet që kanë origjinën në një nga palët kontraktuese të përmendura në nenin 3, dhe përbushin kërkesat e tjera të kësaj Konvente, me kusht që të jetë lëshuar një certifikatë EUR-MED ose një deklaratë origjine EUR-MED në vendin e origjinës.

3. Një certifikatë qarkullimi EUR-MED do të lëshohet nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në palën kontraktuese eksportuese, në palën kontraktuese importuese ose në një prej palëve të tjera kontraktuese të përmendura në nenin 3, me të cilat është i zbatueshëm kumulimi dhe përbush kërkesat e kësaj Konvente, në rastet e mëposhtme:

a) nëse produktet eksportohen nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) të një palë tjetër kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) dhe:

i) kumulimi është zbatuar me materialet që kanë origjinën në një ose më shumë nga palët kontraktuese të përmendura në nenin 3 (2), me kusht që të jetë lëshuar një certifikatë EUR-MED ose një deklaratë origjine EUR-MED në vendin e origjinës, ose

ii) produktet mund të përdoren në palën kontraktuese importuese si materiale në kontekstin e akumulimit për prodhimin e produkteve për eksport nga pala kontraktuese importuese të një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2); ose

iii) produktet mund të riekportohen nga pala kontraktuese importuese të një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2);

b) nëse produktet eksportohen nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) të një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2) ose nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2) të një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (1) dhe:

i) kumulimi është zbatuar me materialet që kanë origjinën në një ose më shumë nga palët kontraktuese të përmendura në nenin 3, me kusht që të jetë lëshuar një certifikatë EUR-MED ose një deklaratë origjine EUR-MED në vendin e origjinës, ose:

ii) produktet mund të përdoren në palën kontraktuese importuese, si materiale në kontekstin e akumulimit për prodhimin e produkteve për eksport nga pala kontraktuese importuese të një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3; ose

iii) produktet mund të riekportohen nga pala kontraktuese importuese të një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3;

c) nëse produktet eksportohen nga një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2) të një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3 (2):

i) kumulimi është zbatuar me materialet që kanë origjinën në një ose më shumë nga palët kontraktuese të përmendura në nenin 3, me kusht që të jetë lëshuar një certifikatë EUR-MED ose një deklaratë origjine EUR-MED në vendin e origjinës; ose

ii) produktet mund të përdoren në palën kontraktuese importuese si materiale në kontekstin e akumulimit për prodhimin e produkteve për eksport nga pala kontraktuese importuese të një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3; ose

iii) produktet mund të riekportohen nga pala kontraktuese importuese të një prej palëve kontraktuese të përmendur në nenin 3.

4. Një deklaratë origjine EUR-MED përmban deklarinimet e mëposhtme në gjuhën angleze:
 - a) nëse origjina është përftuar nga aplikimi i kumulimit me materialet me origjinë në një ose më shumë prej palëve kontraktuese:

“CUMULATION APPLIED WITH” (emri i vendit/vendeve).
 - b) nëse origjina është përftuar jo nga aplikimi i kumulimit me materialet me origjinë në një ose më shumë prej palëve kontraktuese:

“NO CUMULATION APPLIED”.
5. Eksportuesi që përgatit një deklaratë origjine duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të palës kontraktuese eksportuese, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë statusin origjinues të produkteve në fjalë, si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të kësaj Konvente.
6. Një deklaratë origjine ose një deklaratë origjine EUR-MED duhet të lëshohet nga eksportuesi duke shtypur, stampuar, ose printuar mbi faturën, notën shpërndarëse ose ndonjë dokument tjetër tregtar, teksti i së cilës jepet në aneksin IV a dhe b, duke përdorur një nga versionet gjuhësore të përcaktuara në atë aneks dhe në përputhje me dispozitat e ligjit vendas të vendit eksportues. Nëse deklarata është e shkruar me dorë, duhet të shkruhet me bojë në germa kapitale.
7. Një deklaratë origjine dhe një deklaratë origjine EUR-MED duhet të ketë firmën origjinale të eksportuesit të shkruar me dorë. Sidoqoftë, një eksportuesi të aprovuar në kuptimin e nenit 22, nuk do t'i kërkohet të nënshkruajë deklarata të tilla me kusht që t'u paraqesë autoriteteve doganore të palës kontraktuese eksportuese një deklaratë me shkrim ku ai pranon të gjitha përgjegjësitë për një deklaratë origjine, e cila e identifikon atë me çka është nënshkruar me shkrim dore prej tij.
8. Një deklaratë origjine dhe një deklaratë origjine EUR-MED mund të bëhet nga një eksportues kur produktet me të cilat ai ka lidhje eksportohen, ose pas eksportimit me kusht që ai është paraqitur në vendin importues jo më vonë se dy vjet mbas importimit të produkteve të cilave ai i referohet.

Neni 22

Eksportues i aprovuar

1. Autoritetet doganore të palës kontraktuese eksportuese mund të autorizojnë çdo eksportues (këtu të quajtur “eksportuesi i aprovuar”), që bën dërgesa të shpeshta të mallrave në pajtim me dispozitat e kësaj Konvente të lëshojë deklaratë origjine ose deklaratë origjine EUR-MED, pavarësisht nga vlera e produkteve në fjalë. Një eksportues që kërkon një autorizim të tillë, duhet të paraqesë, sipas kërkesave të autoriteteve doganore, të gjitha garancitë e nevojshme për të vërtetuar statusin e origjinës së produkteve, si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të kësaj Konvente.
2. Autoritetet doganore mund të japin statusin e eksportuesit të aprovuar, sipas kushteve që ata e gjykojnë të përshtatshme.
3. Autoritetet doganore do t'i japin eksportuesit të aprovuar një numër autorizimi doganor i cili do të shfaqet në deklaratën e origjinës dhe në një deklaratë origjine EUR-MED.
4. Autoritetet doganore do të kontrollojnë përdorimin e autorizimeve nga eksportuesi i aprovuar.
5. Autoritetet doganore mund të tërheqin autorizimin në çdo kohë. Ata mund ta bëjnë këtë kur eksportuesi i aprovuar nuk ofron garancitë referuar paragrafit 1, si dhe nuk plotëson kërkesat referuar paragrafit 2, ose në të kundërt kryen përdorim jo korrekt të autorizimit.

Neni 23

Vlefshmëria e vërtetimit të origjinës

1. Vërtetimi i origjinës do të jetë i vlefshëm për katër muaj nga data e lëshimit në palën kontraktuese eksportuese, dhe duhet depozituar brenda kësaj periudhe tek autoritetet doganore të palës kontraktuese eksportuese.
2. Vërtetimet e origjinës të cilat janë depozituar pranë autoriteteve doganore të palës kontraktuese importuese pas datës së fundit për paraqitje, të specifikuar në paragrafin 1, mund të pranohen me qëllim zbatimin e trajtimit preferencial, kur nuk është arritur depozitimi i këtyre dokumenteve deri në datën përfundimtare, shkaktuar nga rrethana të jashtëzakonshme.
3. Në rastet e tjera të depozitimeve shumë të vonuara, autoritetet doganore të palës kontraktuese importuese mund ta pranojnë vërtetimin e origjinës kur produktet janë depozituar përpara datës përfundimtare.



Neni 24

Paraqitja e vërtetimit të origjinës

Vërtetimi i origjinës duhet të paraqitet pranë autoriteteve doganore të palës kontraktuese importuese në përputhje të plotë me procedurat që aplikohen në atë vend. Autoritetet e mësipërme mund të kërkojnë një përkthim të vërtetimit të origjinës dhe, gjithashtu, mund të kërkojnë deklaratën e importit që duhet t'i bashkëngjitet një deklarami nga importuesi që vërteton se produktet plotësojnë kushtet e kërkuara për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 25

Importimi me këste

Kur, me kërkesën e importuesit dhe me kushtet e parashtruara nga autoritetet doganore të palës kontraktuese importuese, produktet e çmontuara dhe jo të montuara në kuptimin e rregullit të përgjithshëm 2 (a) të sistemit të harmonizuar, që është në seksionin XVI dhe XVII apo në krerët nr.7308 dhe 9406, janë importuar me këste, një vërtetim i vetëm i origjinës për të tilla produkte duhet të paraqitet pranë autoriteteve doganore gjatë importimit të këstit të parë.

Neni 26

Përfshirjet nga vërtetimi i origjinës

1. Produktet e dërguara në paketime të vogla nga persona privatë të personat privatë ose që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtarëve do të pranohen si produkte origjinuese pa kërkuar paraqitjen e vërtetimit të origjinës, me kusht që këto produkte nuk janë importuar për qëllime tregtie dhe janë deklaruar se plotësojnë kërkesat e kësaj Konvente dhe aty ku nuk ka dyshim të vërtetësia e një deklarimi të tillë. Në rastin e produkteve të dërguara me postë, kjo deklaratë mund të bëhet në deklarinim doganor CN22/CN23 ose në një fletë të veçantë letrë që do t'i aneksohet atij dokumenti.

2. Importet të cilat janë të rastësishme dhe përbëjnë vetëm produkte për përdorim personal nga marrësi ose udhëtari ose familjarët e tyre nuk do të konsiderohen si importe për qëllime tregtie, nëse nisur nga pikëpamja e natyrës dhe sasisë së produkteve është e evidente që nuk ka qëllime tregtie për to.

3. Për më tepër, vlera totale e këtyre produkteve nuk duhet të tejkalojë 500 euro në rastin e pakove të vogla ose 1 200 euro në rastin e produkteve që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtarëve.

Neni 27

Dokumentet mbështetëse

Dokumentet referuar në nenin 16 (3) dhe 21 (3) që përdoren për qëllime vërtetimi se produktet e shoqëruara me një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 ose EUR-MED ose një deklaratë origjine, ose deklaratë origjine EUR-MED mund të konsiderohen si produkte origjinuese në një nga palët kontraktuese dhe që plotësojnë të gjitha kërkesat e tjera të kësaj Konvente, si dhe mund të përbëhen ndër të tjera si më poshtë:

a) evidencë direkte e proceseve të kryera nga eksportuesi ose ofruesi për të përfutur produktet në fjalë, që mbahen për shembull në llogaritë ose në librat e kontabilitetit të tij të brendshëm;

b) dokumentet që vërtetojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të bëra në një palën kontraktuese përkatëse ku këto dokumente përdoren në përputhje me ligjin vendas;

c) dokumentet që vërtetojnë punimet ose përpunimet e materialeve në palën kontraktuese përkatëse, të lëshuara ose të bëra në këtë palë, ku këto dokumente janë përdorur në përputhje me ligjin vendas;

d) certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 ose EUR-MED ose deklarata origjine apo deklarata origjine EUR-MED që vërtetojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të bëra në palën në përputhje me këtë Konventë;

e) prova të përshtatshme në lidhje me punimin ose përpunimin e kryer jashtë palës kontraktuese përkatëse duke zbatuar nenin 11, që vërteton që janë përmbushur kërkesat e atij neni.

Neni 28

Ruajtja e vërtetimit të origjinës dhe dokumenteve mbështetëse

1. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1 ose EUR-MED duhet t'i mbajë dokumentet e referuara në nenin 16 (3) për të paktën tre vjet.
2. Eksportuesi që bën një deklaratë origjine ose deklaratë origjine EUR-MED duhet të mbajë për të paktën tre vjet një kopje të kësaj deklarate, si dhe dokumentet referuar në nenin 21 (5).
3. Autoritetet doganore të palës kontraktuese eksportuese që lëshojnë një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 ose EUR-MED duhet të mbajnë për të paktën tre vjet formularin e aplikimit referuar në nenin 16 (2).
4. Autoritetet doganore të palës kontraktuese importuese duhet të mbajnë për të paktën tre vjet certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe EUR-MED, si dhe deklaratën e origjinës dhe deklaratën e origjinës EUR-MED që iu paraqitet atyre.

Neni 29

Mospërputhjet dhe gabimet formale

1. Në rast se gjenden mospërputhje të vogla në deklaratimet e bëra në vërtetimin e origjinës dhe ato të bëra në dokumentet e paraqitura në zyrën doganore për qëllime të kryerjes së formaliteteve për importimin e produkteve, kjo nuk do të sjellë pavlefshmërinë e vërtetimit të origjinës nëse është evidentuar se ky dokument i korrespondon produkteve të paraqitura.
2. Gabimet formale të dukshme, të tilla si gabime gjatë shtypjes në vërtetimin e origjinës nuk do të bëhen shkas që ky dokument të refuzohet, nëse këto gabime nuk janë të tilla që të krijojnë dyshime në lidhje me korrektësinë e deklaratimit të bërë në atë dokument.

Neni 30

Shumat e shprehura në euro

1. Në zbatim të dispozitave të nenit 21 (1) (b) dhe nenit 26 (3) në rastet kur produktet faturohen në një monedhë tjetër veç euros, sasia në monedhën kombëtare të palëve kontraktuese, ekuivalente me shumat e shprehura në euro, duhet të fiksohet çdo vit nga secili vend përkatës.
2. Një dërgesë malli duhet të përfitojë nga dispozitat e nenit 21 (1) (b) dhe nenit 26 (3), duke iu referuar monedhës në të cilën është përgatitur fatura, sipas shumës së fiksuar nga vendi që ka të bëjë me të.
3. Shumat për t'u përdorur në çdo lloj monedhe kombëtare duhet të jenë të barabarta në atë monedhë të shumave të shprehur në euro si në ditën e parë të punës së muajit tetor. Shumat i komunikohen Komisionit Europian më 15 tetor dhe zbatohen më 1 janar të vitit të vazhdim. Komisioni Europian njofton të gjitha vendet e interesuara për shumat përkatëse.
4. Një vend mund të rrumbullakosë më lart ose më poshtë shumën që rezulton nga konvertimi në monedhën e vet kombëtare të një shume të shprehur në euro. Sasia e rrumbullakosur nuk duhet të ndryshojë nga sasia e rezultuar prej konvertimit me më shumë se 5%. Një vend mund të mbajë të pandryshuar ekuivalentin e monedhës së tij kombëtar, të një shume të shprehur në euro, në rast se gjatë kohës së rregullimeve vjetore, sipas paragrafit 3, konvertimi i kësaj shume, përpara rrumbullakosjes, rezulton me një rritje më pak se 15% në ekuivalentin e monedhës kombëtare. Ekuivalenti i monedhës kombëtare mund të mbahet i pandryshuar në rast se konvertimi do të rezultonte në një pakësim në këtë vlerë ekuivalente.
5. Shumat e shprehura në euro duhet të rishikohen nga komiteti i përbashkët me kërkesë të secilës nga palët kontraktuese. Kur të kryejë këtë rishikim, komiteti i përbashkët duhet të konsiderojë dëshirën e palëve për t'u mbrojtur nga pasojat e efekteve të kufizimeve në terma realë. Për këtë qëllim, ai mund të vendosë për të modifikuar shumat e shprehura në euro.



TITULLI VI
MASAT PËR BASHKËPUNIM ADMINISTRATIV

Neni 31

Bashkëpunimi administrativ

1. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese t'i sigurojnë njëra-tjetrës, nëpërmjet Komisionit Europian, kopje të llojit të vulave të përdorura në zyrat e tyre doganore për lëshimin e certifikatave të qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe EIR-MED dhe adresat e autoriteteve përgjegjëse doganore për të vërtetuar këto certifikata dhe deklaratat e origjinës dhe deklaratat e origjinës EUR-MED.

2. Me qëllim që të sigurohet aplikimi i duhur i kësaj Konvente, palët kontraktuese duhet të ndihmojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet administratave doganore kompetente, në kontrollin e origjinalitetit të certifikatave të qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe EUR-MED, deklaratave të origjinës dhe deklaratave të origjinës EUR-MED, si dhe korrektësinë e informacionit të dhënë në këto dokumente.

Neni 32

Verifikimi i vërtetimit të origjinës

1. Verifikimet e duhura të vërtetimit të origjinës duhet të kryhen me metodën e zgjedhjes së rastit ose sa herë që autoritetet doganore të palës kontraktuese importuese kanë dyshime të arsyeshme për origjinalitetin e dokumenteve të tilla, për statusin e origjinës së produkteve përkatëse ose për përmbushjen e kërkesave të tjera të kësaj Konvente.

2. Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të paragrafit 1, autoritetet doganore të palës kontraktuese importuese duhet t'ia kthejnë certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 ose EUR-MED, si dhe faturën, në rast se është paraqitur, deklaratën e origjinës ose deklaratën e origjinës EUR-MED ose një kopje të këtyre dokumenteve, autoriteteve doganore të palës kontraktuese eksportuese, duke u dhënë, atëherë kur është e nevojshme, arsyet për hetimin. Çdo dokument dhe informacion i marrë, i cili thotë se informacioni i dhënë mbi vërtetimin e origjinës është jo korrekt, duhet t'i bashkëngjitet në mbështetje të kërkesës për verifikim.

3. Verifikimi duhet të kryhet nga autoritetet doganore të palës kontraktuese eksportuese. Për këtë qëllim, ato duhet të kenë të drejtën të kërkojnë çdo dokument dhe të kryejnë çdo inspektim të llogarive të eksportuesit ose çdo lloj kontrolli që konsiderohet i nevojshëm.

4. Në rast se autoritetet doganore të vendit të palës kontraktuese importuese vendosin të pezullojnë përkohësisht dhënien e trajtimit preferencial për produktet përkatëse, ndërkohë që presin rezultatet e verifikimit, importuesit duhet t'i ofrohet mundësia për të mos i bllokuar produktet, vetëm në rastet e marrjes së ndonjë mase kujdesi kur gjykohet e nevojshme.

5. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikimin duhet të informohen për rezultatet e këtij verifikimi sa më shpejt që të jetë e mundur. Këto rezultate duhet të tregojnë qartë kur dokumentet janë origjinale dhe kur produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte që janë origjinuese në palët kontraktuese, si dhe që plotësojnë kërkesat e tjera të kësaj Konvente.

6. Në rast se për një dyshim të arsyeshëm, nuk ka përgjigje brenda 10 muajve nga data e kërkesës së verifikimit ose, në qoftë se përgjigja nuk përmban informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar origjinalitetin e dokumentit në fjalë, ose origjinën e vërtetë të produkteve, autoritetet doganore kërkuese të hetimit, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, duhet të refuzojnë dhënien e preferencave.

Neni 33

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kur ka mosmarrëveshje lidhur me verifikimin e procedurave të nenit 32, të cilat nuk mund të zgjidhen mes autoriteteve doganore që kërkojnë një verifikim dhe autoriteteve doganore përgjegjëse për kryerjen e këtij verifikimi, ato duhet t'i paraqiten organit bilateral të ngritur me marrëveshjen përkatëse. Nëse mosmarrëveshjet, përveç atyre në lidhje me procedurën e verifikimit të nenit 3 lindin në lidhje me interpretimin e kësaj Konvente, ato i paraqiten komitetit të përbashkët.

Në të gjitha rastet, zgjidhjet e mosmarrëveshjeve ndërmjet importuesit dhe autoriteteve doganore të palës kontraktuese importuese duhet të respektojnë legjislacionin e atij vendi.

Neni 34 Gjobat

Gjobat duhet të vendosen mbi çdo person që përpilon ose shkakton përpilimin e një dokumenti që përmban informacion jo korrekt për qëllimin e marrjes së trajtimit preferencial për produktet.

Neni 35 Zonat e lira

1. Palët kontraktuese do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që produktet e tregtuara nën mbulimin e vërtetimit të origjinës, dhe që gjatë transportit përdorin një zonë të lirë që është në territorin e tyre, të mos zëvendësohen nga mallra të tjera dhe të mos pësojnë përpunim tjetër, veç veprimeve normale që parandalojnë përkeqësimin e gjendjes së mallrave.

2. Në kuptimin e një shmangieje nga dispozitat që përmban paragrafi 1, kur produktet origjinuese në një palë importohen në një zonë të lirë mbuluar një vërtetim origjine dhe pësojnë trajtim ose përpunim, autoritetet përkatëse duhet të lëshojnë një certifikatë të re EUR.1 ose EUR-MED me kërkesë të eksportuesit, në rast se trajtimi dhe përpunimi i pësuar është në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

ANEKSI I SHËNIMET HYRËSE PËR LISTËN E ANEKSIT II

Shënim 1

Lista vendos kushtet e kërkuara për të gjitha produktet për t'u konsideruar si të punuara ose përpunuara mjaftueshëm brenda kuptimit të nenit 5 të shtojcës I të Konventës.

Shënim 2

2.1. Dy kolonat e para në listë përshkruajnë produktin e përftuar. Kolona e parë jep numrin e kreut ose numrin e kapitullit, të përdorur në sistemin e harmonizuar dhe kolona e dytë jep përshkrimin e mallrave të përdorura në atë sistem për atë kre apo kapitull. Për secilën hyrje në të dyja kolonat e para specifikohet një rregull në kolonën 3 ose 4. Nëse në disa raste, hyrja në kolonën e parë paraprihet nga një "ex" kjo nënkupton se rregullat në kolonën 3 ose 4 aplikohen vetëm për pjesën e atij kreu sikurse është përshkruar në kolonën 2.

2.2. Ku shumë numra kërresh grupohen së bashku në kolonën 1 ose një numër kapitulli jepet dhe përshkrimi i produkteve në kolonën 2, prej këtej jepet në terma të përgjithshëm, rregullat e afërta në kolonën 3 ose 4 aplikohen për të gjitha produktet, të cilat, nën sistemin e harmonizuar klasifikohen në kërret e kapitullit ose në çdo kre të grupuar së bashku në kolonën 1.

2.3. Kur ka rregulla të ndryshme në listën që aplikohet për produkte të ndryshme brenda një kreu, secila pikë përmban përshkrimin e asaj pjese të kreut të mbuluar nga rregullat e afërta në kolonën 3 ose 4.

2.4. Kur, për një hyrje në të dyja kolonat e para, specifikohet një rregull në të dyja kolonat 3 dhe 4, eksportuesi mund të zgjedhë si alternativë, që të aplikojë ose rregullin e vendosur në kolonën 3, ose atë të vendosur në kolonën 4. Në rast se nuk jepet ndonjë rregull origjine në kolonën 4, duhet të aplikohet rregulli i vendosur në kolonën 3.

Shënim 3

3.1. Dispozitat e nenit 5 të shtojcës I të konventës, për sa u përket produkteve që kanë marrë statusin e origjinës, të cilat janë përdorur në prodhimin e produkteve të tjera, duhet të aplikohen, pa pasur parasysh nëse statusi është marrë brenda në fabrikën ku këto produkte po përdoren ose në një tjetër fabrike në një palë kontraktuese.

Shëmbull

Një motor i kreut 8407, për të cilin rregulli thotë se vlera e materialeve joorigjinuese të cilat mund të përfshihen në të, nuk mund të kalojë 40% të çmimit "ex-works", është bërë nga "aliazh tjetër prej çeliku i formatuar për kudhër" të kreut ex 7224.

Në rast se ky çelik i temperuar është temperuar në Bashkimin Europian nga një lëndë e parë joorigjinuese, ky çelik ka marrë tashmë statusin origjinues sipas rregullit për kreun ex 7224 në listë. Temperimi mund të llogaritet atëherë si origjinues në vlerën e llogaritur për motorin, pavarësisht nëse çeliku u prodhua në të njëjtën fabrikë ose në një tjetër në Bashkimin Europian. Vlera e lëndës së parë joorigjinuese në këtë mënyrë nuk merret parasysh kur shtohet vlera e materialeve joorigjinuese të përdorura.



3.2. Rregulli në listë përfaqëson sasinë minimale të kërkuar të punës ose të përpunimit, dhe kryerja e më shumë punë apo përpunimi, gjithashtu, i jep statusin origjinues; në të kundërt, kryerja e më pak punë apo përpunimi nuk mund t'i japë statusin origjinues. Kështu, në rast se një rregull thotë se një material joorigjinues, në një nivel të dhënë të prodhimit mund të përdoret, atëherë përdorimi i këtij materiali në një stad të hershëm të prodhimit lejohet dhe përdorimi i tij në një stad të mëvonshëm nuk lejohet.

3.3. Pa cenuar shënimin 3.2, kur një rregull thotë se “Prodhim nga materialet e çdo kreu”, materialet e çdo kreu (edhe materialet e të njëjtit përshkrim dhe kre si produkti) mund të përdoren, duke iu nënshtruar çdo kufizimi specifik, i cili, gjithashtu, mund të përmbahet në rregull.

Sidoqoftë, shprehja “prodhim nga materiale të çdo kreu, duke përfshirë materiale të tjera të kreut nr...” ose “prodhim nga materialet e çdo kreu, duke përfshirë materiale nga i njëjti kre si produkti” do të thotë që mund të përdoren vetëm materiale të çdo kreu, përveç atyre të të njëjtit përshkrim si i produktit sikurse i dhënë në kolonën 2 të listës.

3.4. Kur një rregull në listë specifikon se një produkt mund të prodhohet nga më shumë se një material, kjo do të thotë që mund të përdoren një ose më shumë materiale. Ai nuk kërkon që të përdoren të gjitha materialet.

Shembull

Rregulli për fabrikate të krerëve 5208 deri 5212 thotë se fibrat natyrale mund të përdoren dhe se materialet kimike, ndërmjet materialeve të tjera, gjithashtu, mund të përdoren. Kjo nuk do të thotë që të dyja duhet të përdoren; është e mundur të përdoret njëra ose tjetra, ose që të dyja.

3.5. Kur një rregull në listë specifikon se një produkt duhet të prodhohet nga një material i veçantë, ky kusht duket se nuk parandalon përdorimin e materialeve të tjera, sepse, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të përmbushin rregullin (shiko, gjithashtu, shënimin 6.2 më poshtë në lidhje me tekstilet).

Shembull

Rregulli për ushqimet e përgatitura në kreun 1904, i cili në mënyrë specifike përjashton përdorimin e drithërave dhe derivateve të tyre, nuk parandalon përdorimin e kripërave minerale, e kimikateve dhe shtesave të tjera, të cilat nuk janë prodhime nga drithërat.

Megjithatë, kjo nuk aplikohet te produktet, të cilat edhe pse nuk mund të prodhohen nga materiale të veçanta të specifikuar në listë, mund të prodhohen nga një material i së njëjtës natyrë në një stad më të hershëm të prodhimit.

Shembull

Në rastin e një artikulli veshjeje të ex kapitullit 62, i përbërë nga materiale jo të thurura, në rast se përdorimi i vetëm i fillit joorigjinues lejohet për këtë lloj artikulli, nuk është e mundur të fillosh nga pëlhurë jo e thurur - edhe në se pëlhurat jo të thurura normalisht nuk mund të bëhen prej filli. Në raste të tilla, materiali fillestar duhet të jetë në një stad përpara të qenit fill, pra në gjendjen fibër.

3.6. Kur në një rregull në listë, jepen dy përqindje për vlerën maksimale të materialeve joorigjinuese që mund të përdoren, atëherë këto përqindje nuk mund të shtohen së bashku. Me fjalë të tjera, vlera maksimale e të gjitha materialeve joorigjinuese të përdorura nuk mund të kalojë kurrë përqindjen më të lartë të dhënë. Për më tepër, përqindjet individuale nuk duhet të tejkalohen, në lidhje me materialet e veçanta për të cilat ato aplikohen.

Shënim 4

4.1. Termi “fibra natyrale” përdoret në listë për t'iu referuar fibrave të tjera nga ato artificiale ose sintetike. Kufizohet për statet përpara se të ndodhë tjerja, duke përfshirë mbetjet dhe, nëse nuk specifikohet ndryshe, përfshin fibrat të cilat janë përdredhur, krehur ose përpunuar ndryshe, por që nuk janë kthyer në fill.

4.2. Termi “fibra natyrale” përfshin qimen e kalit të kreut nr.0511, mëndafshin e krerëve 5002 dhe 5003, po ashtu, si dhe fibrat e leshit dhe qime të imët ose të ashpër kafshe të krerëve 5101 deri 5105, fibra pambuku të krerëve 5201 deri 5203, si dhe fibra të tjera vegjetale të krerëve 5301 deri 5305.

4.3. Termit “pulp tekstili”, “materiale kimike” dhe “materiale për prodhim letre” përdoren në listë për të përshkruar materialet, e paklasifikuara në kapitujt 50 deri 63, të cilat mund të përdoren për të prodhuar fibra ose fije artificiale, sintetike ose letre.

4.4. Termi “fibra kryesore të bëra nga njeriu” përdoret në listë për t'iu referuar filamenteve artificiale apo sintetike, fibrave zëvendësuese ose mbetjeve, të krerëve 5501 deri 5507.

Shënim 5

5.1. Aty ku, për një produkt të dhënë në listë, i referohet këtij shënimi, kushtet e vendosura në kolonën 3 nuk duhet të aplikohen për ndonjë material bazë tekstili të përdorur në prodhimin e këtij produkti dhe të cilat, të marra së bashku, përfaqësojnë 10% ose më pak të peshës totale të materialeve bazë tekstile të përdorura (shiko, gjithashtu, shënimet 5.3 dhe 5.4.).

5.2. Sidoqoftë, toleranca e përmendur në shënimin 5.1 mund të aplikohet vetëm te produktet e përziera, të cilat janë bërë nga dy ose më shumë materiale tekstili bazë.

Materialet tekstile bazë, jepen si më poshtë:

- mëndafsh;
- lesh;
- qime kafshe e ashpër;
- qime kafshe e hollë;
- qime kali;
- pambuk;
- materiale për prodhim letre dhe letër;
- fije liri;
- fije kërpi;
- jute dhe fibra të tjera tekstili;
- sisal dhe fibra të tjera të gjinisë “agave”;
- fibra nga arra kokosi, abaka, ramie dhe fibra të tjera vegjetale tekstile;
- filamente sintetike të bëra nga njeriu;
- filamente artificiale të bëra nga njeriu;
- filamente rryme përcjellëse;
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polipropileni;
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliesteri;
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliamidi;
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliakrilonitrili;
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliimidi;
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej politetrafluoroetileni;
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polifenileni sulfid;
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polivinilkloridi;
- fibra të tjera sintetike të bëra nga njeriu;
- fibra artificiale të bëra nga njeriu prej viskoze;
- fibra të tjera artificiale të bëra nga njeriu;
- fill i bërë nga poliuretani, i segmentuar me segmente fleksibël prej polieteri, i përdredhur ose jo;
- fill i bërë nga poliuretani, i segmentuar me segmente fleksibël prej poliesteri, i përdredhur ose jo;
- produkte të kreut 5605 (fill i metalizuar), që përmban një rrip të përbërë prej shtrese alumini ose një mbulesë prej filmi plastik, mbuluar ose jo prej pluhuri alumini, me një gjerësi që nuk kalon 5 mm, i palosur nëpërmjet një adezivi me ngjyra ndërmjet dy shtresave të një filmi plastik;
- produkte të tjera të kreut 5605.

Shëmbull

Një fill, i kreut 5205, i bërë nga fibra pambuku të kreut 5203 dhe fibra sintetike të kreut 5506, është një fill i përzier. Për këtë arsye, fibrat sintetike joorigjinuese, të cilat nuk plotësojnë rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga materialet kimike ose pulp tekstili) mund të përdoren, me kusht që pesha e tyre totale nuk kalon 10% të peshës së fillit.

Shëmbull

Një copë pëlhurë leshi e kreut 5112, e bërë prej filli leshi të kreut 5107 dhe filli sintetik prej fibrash të kreut 5509, është një pëlhurë e përzier. Për këtë arsye, filli sintetik i cili nuk plotëson rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga materialet kimike pulp tekstili) ose filli i leshit, i cili nuk plotëson rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga fije natyrale, jo të përdredhura apo tjerra ose të përgatitura ndryshe për fill), ose një kombinim i të dyjave, mund të përdoret në rast se pesha e tyre totale nuk e kalon 10% të peshës së pëlhurës.



Shembull

Pëlhurë tekstile, xhufke, e kreut 5802, e bërë prej filli pambuku të kreut 5205 dhe pëlhurë pambuku të kreut 5210, është vetëm një produkt i përzier në rast se pëlhura e pambukut është në vetvete një pëlhurë e përzier, e prodhuar nga filli të klasifikuara në dy kërërë të ndryshëm, ose në rast se filli i pambukut i përdorur është vetë një përzierje.

Shembull

Nëse pëlhura në fjalë tekstile me xhufka do të ishte e përberë nga fill pambuku i kreut 5205 dhe pëlhurë sintetike e kreut 5407, atëherë, në mënyrë të dukshme, fijet e përdorura janë dy materiale bazë tekstili të veçanta dhe pëlhura tekstile xhufkë është, mbi këto baza, një produkt i përzier.

5.3. Në rastin e produkteve që përfshijnë “fill të bërë nga poliuretani i segmentuar me segmente fleksibël të polieterit, të përdredhur ose jo”, kjo tolerancë është 20% në lidhje me këtë fill.

5.4. Në rastin e produkteve që përfshijnë “rrip i përberë nga një shtresë alumini ose nga një shtresë prej filmi plastik, të mbuluar ose jo me pluhur alumini, me një gjerësi që nuk e kalon 5mm, i palosur nëpërmjet një adevivi me ngjyra ndërmjet dy shtresave të një filmi plastik, kjo tolerancë është 30% në lidhje me këtë rrip.

Shënim 6

6.1. Ku në listë, i referohesh këtij shënimi, materialet tekstile (me përjashtim të linjave dhe interlinjave), të cilat nuk plotësojnë rregullin e vendosur në listë në kolonën 3 për produktin nga dora e njeriut në fjalë, mund të përdoren, me kusht që ato të jenë klasifikuar në një kre ndryshe nga ai i produktit dhe që vlera e tyre të mos kalojë 8% të çmimit “*ex-works*” të produktit.

6.2. Pa cenuar shënimin 6.3, materialet, të cilat nuk janë klasifikuar brenda kapitujve 50 deri 63, mund të përdoren lirshëm në prodhimin e produkteve tekstile, përmbajnë apo jo tekstile.

Shembull

Në rast se një rregull në listë thotë që, për një lloj të veçantë tekstili (të tilla si pantallonat) duhet përdorur fill, kjo nuk parandalon përdorimin e gjërave metalike, të tilla si kopsat, për arsye se kopsat nuk janë të klasifikuar në kapitujt 50 deri 63. Për të njëjtën arsye, nuk parandalohet përdorimi i zinxhirëve, edhe pse zinxhirët normalisht përmbajnë tekstil.

6.3. Kur një rregull përqindjeje aplikohet, vlera e materialeve të cilat nuk klasifikohen brenda kapitujve 50 deri 63, duhet të merren parasysh kur llogaritet vlera e materialeve joorigjinuese të përfshira.

Shënim 7

7.1. Për qëllimet e kërërëve ex 2707, 2713 deri 2715, ex 2901, ex 2902 dhe ex 3403, “proceset specifike” janë si më poshtë:

- a) distilim në vakum;
- b) ridistilim nga një proces shumë i plotë fraksionimi;
- c) ndarja;
- d) riformimi;
- e) përfitim me ndihmën e solventeve selektive

f) procesi që përfshin të gjitha operacionet e mëposhtme: përpunimi me acid sulfurik të përqendruar, me anhidrit oleum ose sulfurik; neutralizimi me agjentë alkalinë; çngjyrimi dhe pasurimi me dhe aktiv natyral, me dhe aktiv, me qymyr ose boksid aktiv;

- g) polimerizimi;
- h) alkilizimi;
- i) izomerizimi.

7.2. Për qëllimet e kërërëve 2710, 2711 dhe 2712, “proceset specifike” janë si më poshtë:

- a) distilim në vakum;
- b) ridistilim nga një proces shumë i plotë fraksionimi;
- c) ndarja;
- d) riformimi;
- e) ekstraktimi me ndihmën e solventeve selektive;

f) procesi që përfshin të gjitha veprimet e mëposhtme: përpunimi me acid sulfurik të përqendruar, me anhidrit oleum ose sulfurik; neutralizimi me agjentë alkalinë; çngjyrimi dhe pasurimi me dhe aktiv natyral, me dhe aktiv, me qymyr ose boksid aktiv;

- g) polimerizimi;

- h) alkilizimi;
 ij) izomerizimi;
 k) në lidhje vetëm me vajrat e rënda të kreut ex 2710, desulfurizimi me hidrogjen, i cili rezulton nga një pakësim prej së paku 85 % të përmbajtjes së sulfurit të produkteve të përpunuara (metoda ASTM D 1266-59 T);
 l) në lidhje vetëm me produktet e kreut 2710, deparafinimi nga një proces tjetër nga filtrimi;
 m) në lidhje vetëm me vajrat e rënda të kreut ex 2710, trajtimi me hidrogjen, në një presion prej më shumë se 20 bar dhe një temperaturë prej më shumë se 250°C, me përdorimin e një katalizatori, tjetër nga sjellja e desulfurizimit, kur hidrogjeni përbën një element aktiv në një reaksion kimik. Trajtimi i mëtejshëm me hidrogjen i vajrave lubrifikante të kreut ex 2710 (p.sh. hidrombarimi ose çngjyrimi), me qëllim që, në mënyrë më specifike, të përmirësohet ngjyra ose stabiliteti; ky trajtim nuk duhet sidoqoftë të konsiderohet një proces specifik;
 n) në lidhje vetëm me vajrat për karburante të kreut ex 2710, distilim atmosferik, në kushte kur më pak se 30 %, sipas volumit, e këtyre produkteve distilohet, duke përfshirë humbjet, në 300°C, me metodën ASTM D 86;
 o) në lidhje vetëm me vajrat e rënda të ndryshme nga vajrat e gazrave dhe vajrat për karburante të kreut ex 2710, trajtim me anë të shkarkesave fshirëse elektrike me frekuencë të lartë;
 p) në lidhje vetëm me produktet bruto (përveç xhelatinës të naftës, ozekerite, dyll linjiti apo dyllë bitumi, dyllë parafine që përmban ndaj peshës më pak se 0.75% vaj) të kreut ex 2712 për zhvajosje me kristalizim të pjesshëm.

7.3. Për qëllimet e krerëve ex 2707, 2713 deri 2715, ex 2901, ex 2902 dhe ex 3403, operacione të thjeshta, të tilla si pastrimi, dekantimi, shkripëzimi, ndarja e ujërave, filtrimi, ngjyrimi, vendosja e markës, përftimi i përmbajtjes sulfure, si rezultat i përzierjes të produkteve me përmbajtje të ndryshme sulfuri ose çdo lloj kombinimi të këtyre operacioneve, ose operacioneve të ngjashme, nuk japin origjinë.

ANEKSI II

LISTA E PUNIMIT OSE E PËRPUNIMIT E KËRKUAR PËR T'U KRYER ME MATERIALE JOORIGJINUESE ME QËLLIM PËRFTIMIN E STATUSIT ORIGJINUES TË PRODUKTIT TË PRODHUAR

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet joorigjinuese, i cili u jep statusin e origjinës | |
|----------------------------|--|---|---------|
| (1) | (2) | (3) | ose (4) |
| Kapitulli 1 | Kafshët e gjalla | Të gjitha kafshët e kapitullit 1 të përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| Kapitulli 2 | Mishi dhe të brendshmet e ngrënëshme të mishit | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e kapitujve 1 dhe 2 të përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| Kapitulli 3 | Peshku e kafshët guaskore të nënujshme, molusqet e kafshët e tjera jovertbrore ujore | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e kapitullit 3 të përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| Ex Kapitulli 4 0403 | Produktet bulmetore; vezët e zogjve; mjaltë natyral; produkte të ngrënëshme me origjinë prej kafshëve, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër, përveç: Dhallë, qumësht e krem i prerë, kos, kefir e qumësht e krem tjetër të fermentuara ose të acidifikuara, nëse janë ose jo të koncentruara ose që përmbajnë sheqer shtesë ose lëndë të tjera ëmbëltuese ose lëndë aromatizuese, ose që përmbajnë fruta, arra ose kakao shtesë | Prodhime në të cilat: - të gjitha materialet e kapitullit 4 të përdorura janë tërësisht origjinuese; - të gjitha lëngjet e frutave (përfshijtur ato të ananasit, qitros ose greipfrutit) të kreut 2009 të përdorura janë origjinuese; - vlera e çdo materiali të përdorura të kapitullit 17 nuk kalon vlerën prej 30% të çmimit <i>ex-works</i> të produktit | |
| Ex Kapitulli 5 | Produktet me origjinë prej kafshëve, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër; përveç: | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e kapitullit 5 të përdorura janë tërësisht origjinuese. | |



| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet joorigjinuese, i cili u jep statusin e origjinës | |
|-----------------|--|---|-----|
| (1) | (2) | (3) | (4) |
| ex 0502 | Qime dhe lesh të derrave të përgatitur, derrave të tredhur ose derrave të egër | Pastrimi, dezinfektimi, ndarja dhe drejtimi i qimeve dhe leshit | |
| Kapitulli 6 | Pemët dhe bimët e tjera, të gjalla; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme me to; lulet e prera dhe gjithnjat zburuese | Prodhime në të cilat: - të gjitha materialet e kapitullit 6 të përdorura janë tërësisht origjinuese; - vlera e çdo materiali të përdorur nuk kalon vlerën prej 50% të çmimit <i>ex-works</i> të produktit | |
| Kapitulli 7 | Zarzatet e ngrënshme dhe rrënjët dhe tuberët përkatës | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e kapitullit 7 të përdorura janë tërësisht të përfuara | |
| Kapitulli 8 | Frutat dhe arrat e ngrënshme; lëkurat e agrumeve ose të pjeprave | Prodhime në të cilat: - të gjitha frutat dhe arrat të përdorura janë tërësisht të përfuara; - vlera e çdo materiali të kapitullit 17 të përdorur nuk kalon vlerën prej 30% të çmimit <i>ex-works</i> të produktit | |
| ex Kapitulli 9 | Kafe, çaj, mate dhe erëza, përveç: | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e kapitullit 9 të përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| 0901 | Kafe, nëse është ose jo e pjekur ose e dekafezuar; lëvoret e lëkurat e kafesë; zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe në çdo porcion | Prodhime prej materialesh të çdo kreu | |
| 0902 | Çaj, nëse është ose jo i aromatizuar | Prodhime prej materialesh të çdo kreu | |
| ex 0910 | Përzierje të erëzave | Prodhime prej materialesh të çdo kreu | |
| Kapitulli 10 | Drithërat | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e kapitullit 10 të përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| ex Kapitulli 11 | Produktet e industrisë bluajtëse; malt; niseshtetë; inuline; gluteni i grurit, përveç: | Prodhime në të cilat të gjitha drithërat, zarzatet e ngrënshme, rrënjët e tuberët e kreut 0714 ose fruta të përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| ex 1106 | Miell, kokrriza e pluhur i zarzavateve të thara leguminoze të kreut nr.0713 | Tharja dhe bluarja e zarzavateve leguminoze të kreut 0708 | |
| Kapitulli 12 | Farat vajore e frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara e fruta të përziera; bimët industriale ose medicinale; kashta e tagjia | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e kapitullit 12 të përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| 1301 | Lac; gomë natyrale, rrëshirat, gomërrëshirat e oleorëshirat (për shembull balsamet) | Prodhime në të cilat vlera e çdo materiali të kreut 1301 të përdorur nuk mund të kalojë 50% të çmimit <i>ex-works</i> të produktit. | |
| 1302 | Lëngje e ekstrakte vegjetale; substanca pektike, pektinatet e pektatet; agar-agar e lëndë të tjera ngjitëse e trashës, nëse janë ose jo të modifikuara, të rrjedhura nga produktet vegjetale: - Ngjitës dhe trashës, të modifikuara ose të rrjedhura nga produktet vegjetale; - Të tjera | Prodhime nga ngjitësit dhe trashësit e pamodifikuar. Prodhime në të cilat vlera të gjitha materialeve të përdorura nuk kalon 50% të çmimit <i>ex-works</i> të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jooriginuese, i cili u jep statusin e origjinës | |
|-----------------|---|--|-----|
| (1) | (2) | (3) | (4) |
| Kapitulli 14 | Materialet vegjetale që përdoren për thurje; produktet vegjetale të papërfshira e të paspecifikuara diku tjetër | Prodhime në të cilat të gjitha materialet të kapitullit 14 të përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| ex Kapitulli 15 | Vajra e dhjamëra prej kafshëve ose vegjetale e produktet e ndarjes së tyre; yndyra të përgatitura të ngrënshme; dyllit prej kafshëve ose vegjetale, përveç: | Prodhime prej materialesh të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| 1501 | Dhjamë derri (përfshirë sallon) e dhjami i shpendëve, ndryshe nga ai i kreut 0209 ose 1503: - Dhjamëra prej kockave ose mbetjeve | Prodhime prej materialesh të çdo kreu përveç atyre të krerëve 0203, 0206 ose 0207 ose kockave të kreut 0506 | |
| | - Të tjera | Prodhime prej mishi ose të brendshmeve të ngrënshme të dërrit të kreut 0203 ose 0206 ose mishit ose të brendshmeve të ngrënshme të shpendëve të kreut 0207 | |
| 1502 | Dhjami i gjedhëve, deleve ose dhive, ndryshe nga ato të kreut 1503 - Dhjamëra prej kockave ose mbetjeve | Prodhime prej materialesh të çdo kreu, përveç atyre të krerëve 0201, 0202, 0204 ose 0206, ose kockave të kreut 0506 | |
| | - Të tjera | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e kapitullit 2 të përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| 1504 | Dhjamëra e vajra dhe fraksionet e tyre, të peshkut ose të sisorëve detare, nëse janë ose jo të rafinuara, por jo të modifikuara kimikisht: - Fraksione solide | Prodhime nga materiale të çdo kreu, përfshirë materiale të tjera të kreut 1504 | |
| | - Të tjera | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e kapitujve 2 dhe 3 të përdorura duhet të jenë tërësisht origjinuese | |
| ex 1505 | Lanolinë e rafinuar | Prodhime prej vajrave të leshit të papërpunuar të kreut 1505 | |
| 1506 | Dhjamëra e vajra të tjera me origjinë prej kafshëve e fraksionet e tyre, nëse janë ose jo të rafinuara, por jo të modifikuara kimikisht: - Fraksione solide | Prodhime nga materiale të çdo kreu, përfshirë materiale të tjera të kreut 1506 | |
| | - Të tjera | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e kapitullit 2 të përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| 1507 deri 1515 | Vajra vegjetale e fraksionet e tij: - Sojë, kikiriku, palme, kopre, thelb palme, babasu, vaj tungu e oitika, dyllë mersine e japonez, fraksionet e vajit të jacobës e vajra për përdorime teknike e industriale të ndryshme nga prodhimet e ushqimit për konsum njerëzor; - Fraksionet solide, përjashtuar ato të vajit jajoba; | Prodhime prej materialesh të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| | | Prodhime prej materialesh të tjera të kreut 1507 deri 1515 | |



| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jooriginuese, i cili u jep statusin e origjinës | |
|-----------------|--|--|---------|
| (1) | (2) | (3) | ose (4) |
| 1516 | - Të tjera Yndyra me origjinë prej kafshëve ose vegjetale dhe vajra dhe fraksionet e tyre, tërësisht ose pjesërisht të hidrogjenizuara, të intersterifikuara, të riesterifikuara ose të elaidinifikuara, nëse janë ose jo të rafinuara, por jo më tej të përgatitura | Prodhime në të cilat të gjitha materialet vegjetale të përdorura janë tërësisht originuese Prodhime në të cilat: - të gjitha materialet e kapitullit 2 të përdorura janë tërësisht originuese; - të gjithë materialet vegjetale të përdorura janë tërësisht originuese. Megjithatë, materialet e krerëve 1507, 1508, 1511 dhe 1513 mund të përdoren | |
| 1517 | Margarinë; përzierjet ose përgatitjet e ngrënshme të vajrave e dhjamërave vegjetale ose prej kafshëve ose vajra ose të fraksioneve të yndyrave ose vajrave të ndryshme të këtij kapitulli, të ndryshme nga yndyrat ose vajrat e ngrënshme ose të fraksioneve të tyre të kreut 1516 | Prodhime në të cilat: - të gjitha materialet e kapitullit 2 dhe 4 të përdorura janë tërësisht originuese; - të gjithë materialet bimore të përdorura janë tërësisht originuese. Megjithatë, materialet e krerëve 1507, 1508, 1511 dhe 1513 mund të përdoren | |
| Kapitulli 16 | Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut ose prej krustaceve, prej molusqeve ose prej kafshëve të tjera jovetebrore ujore | Prodhime: - prej kafshëve të kapitullit 1; dhe/ose - në të cilët të gjitha materialet e kapitullit 3 të përdorura janë tërësisht originuese | |
| ex Kapitulli 17 | Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej sheqeri, përveç: | Prodhime prej materialesh të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| ex 1701 | Sheqer i prodhuar nga kallam sheqeri ose nga panxhar sheqeri e saharoza kimikisht e pastër, në gjendje të ngurtë, të aromatizuar ose lëndë ngjyruese | Prodhime në të cilat vlera e çdo materiali të kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit <i>ex-works</i> të produktit | |
Mallrat që kanë përftuar origjinën e tyre nëpërmjet zbatimit të dispozitave të parashikuara në këtë aneks përjashtohen nga kumulimi përmendur në nenin 3 të shtojcës I.

Neni 2

Kumulimi në Bashkimin European

Për qëllimin e zbatimit të nenit 2 (1) (b) të shtojcës I, punimi ose përpunimi i kryer në Marok, Algjeri ose Tunizi konsiderohet të jetë kryer në Bashkimin European nëse produktet e përftuara pësojnë punim ose përpunim të mëtejshëm në Bashkimin European. Nëse, në pajtim me këtë dispozitë, produktet e origjinës përftohen në dy ose më shumë vende përkatëse, ata konsiderohen të kenë origjinën në Bashkimin European vetëm nëse punimi ose përpunimi shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

Neni 3

Kumulimi në Algjeri

Për qëllimin e zbatimit të nenit 2 (1) (b) të shtojcës I, punimi ose përpunimi i kryer në Bashkimin European, Algjeri ose Tunizi konsiderohet të jetë kryer në Algjeri nëse produktet e përftuara pësojnë punim ose përpunim të mëtejshëm në Algjeri. Nëse, në pajtim me këtë dispozitë, produktet e origjinës përftohen në dy ose më shumë vende përkatëse, ata konsiderohen të kenë origjinën në Algjeri vetëm nëse punimi ose përpunimi shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

Neni 4

Vërtetimet e origjinës

1. Pa cenuar nenin 16 (4) dhe (5) të shtojcës I, një certifikatë qarkullimi EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të një shteti anëtar të Bashkimit European ose të Algjerisë nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Bashkimin European ose në Algjeri, me zbatimin e kumulimit të përmendur në nenin 2 dhe 3 të këtij aneksi dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj konvente.



2. Pa cenuar nenin 21 (2) dhe (3) të shtojcës I, një certifikatë origjine mund të bëhet nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Bashkimin Europian ose në Algjeri, me zbatimin e kumulimit të përmendur në nenet 2 dhe 3 të këtij aneksi dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj konvente.

Neni 5

Deklarata e furnitorit

1. Nëse lëshohet një certifikatë qarkullimi EUR.1, ose bëhet një deklaratë origjine, në Bashkimin Europian ose në Algjeri për produktet e origjinës, në prodhimin e të cilëve janë përdorur mallra që vijnë nga Algjeria, Maroku, Tunizia ose Bashkimi Europian që kanë kaluar një punim ose përpunim në këto vende pa përfutur statusin preferencial të origjinës, merret parasysh deklaratata e furnitorit që jepet për këto mallra në pajtim me këtë nen.

2. Deklarata e furnitorit e përmendur në paragrafin 1 shërben si provë për punimin ose përpunimin e kryer në Algjeri, Marok, Tunizi ose Bashkimin Europian për mallrat përkatëse për qëllimin e përcaktimit nëse produktet për prodhimin e të cilëve përdoren këto mallra, mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Bashkimin Europian ose Algjeri dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

3. Një deklaratë e veçantë e furnitorit, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 4, bëhet nga furnitori për çdo dërgesë të mallrave në formën e parashikuar në aneksin A në një letër që i bashkëngjitet faturës, notës së dorëzimit dhe çdo dokument tjetër tregtar që përshkruan mallrat përkatëse me hollësi të mjaftueshme për t'u mundësuar atyre identifikimin.

4. Nëse një furnitor i sjell furnizim me mallra një klienti për të cilat punimi ose përpunimi i kryer në Algjeri, Marok, Tunizi ose Bashkimin Europian pritet të mbetet konstant për periudha të konsiderueshme kohe, ai mund të japë një deklaratë të vetme furnitori për të mbuluar dërgesat e mëvonshme të mallrave, që këtu quhet "deklaratë afatgjatë e furnitorit".

Një deklaratë afatgjatë e furnitorit mund të quhet normalisht e vlefshme për një periudhë deri në një vit nga data e bërjes së kësaj deklarate. Autoritetet doganore të vendit ku bëhet deklarata caktojnë kushtet në të cilat aplikohen periudha më të gjata.

Një deklaratë afatgjatë e furnitorit bëhet nga furnitori në formën e parashikuar në aneksin B dhe përshkruan mallrat përkatëse me detaje të hollësishtme për t'u mundësuar atyre identifikimin. Ajo i jepet klientit përkatës para se ai të marrë dërgesën e parë të mallrave, mbuluar nga kjo deklaratë ose së bashku me dërgesën e parë.

Furnitori informon klientin e tij menjëherë nëse deklarata afatgjatë e furnitorit nuk vazhdon të jetë e zbatueshme për mallrat e dërguara.

5. Deklarata e furnitorit e përmendur në paragrafët 3 dhe 4 shkruhen me germa shtypi ose printohen në një prej gjuhëve në të cilat është hartuar Marrëveshja, në pajtim me dispozitat e së drejtës së brendshme të vendit ku është bërë dhe mban nënshkrimin origjinal të furnitorit me shkrim dore. Deklarata mund të shkruhet, gjithashtu, me dorë dhe në këtë rast ajo shkruhet me bojë dhe me germa shtypi.

6. Furnitori që bën deklaratën duhet të jetë i përgatitur të paraqesë në çdo kohë, me kërkesë të autoriteteve doganore të vendit ku bëhet deklarata, të gjitha dokumentet e përshtatshme që provojnë që informacioni i dhënë në këtë deklaratë është i saktë.

Neni 6

Dokumentet shoqëruese

Deklarata e furnitorit që provon punimin ose përpunimin e kryer në Bashkimin Europian, Tunizi, Marok ose Algjeri për materialet e përdorura, e bërë në një nga këto vende, trajtohet si një dokument i referuar në nenet 16 (3) dhe 21 (5) të shtojcës I dhe nenin 5 (6) të këtij aneksi të përdorur për qëllimin e vërtetimit që produktet e mbuluara nga një certifikatë qarkullimi EUR.1 ose nga një deklaratë origjine mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Bashkimin Europian ose në Algjeri dhe përmbush kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

Neni 7

Ruajtja e deklaratës së furnitorit

Furnitori që bën një deklaratë furnitori mban për të paktën tre vjet kopje të deklaratës dhe faturës, notat e dorëzimit dhe dokumente të tjera tregtare të cilave u bashkëngjitet kjo deklaratë, si dhe dokumentet e përmendura në nenin 5 (6) të këtij aneksi.

Furnitori që bën një deklaratë afatgjatë furnitori mban për të paktën tre vjet kopje të deklaratës dhe të gjitha faturave, notat e dorëzimit dhe dokumente të tjera tregtare në lidhje me mallrat e mbuluara nga ajo deklaratë e dërguar klientit përkatës, si dhe dokumentet e përmendura në nenin 5 (6) të këtij aneksi. Kjo periudhë fillon nga data e skadimit të vlefshmërisë së deklaratës afatgjatë të furnitorit.

Neni 8

Bashkëpunimi administrativ

Për të siguruar zbatimin e duhur të këtij aneksi, Bashkimi Europian dhe Algjeria asistojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet autoriteteve kompetente doganore, në kontrollin e autenticitetit të certifikatës së qarkullimit EUR.1, deklaratat e origjinës ose deklaratat e furnitorit dhe saktësinë e informacionit të dhënë në këto dokumente.

Neni 9

Verifikimi i deklaratave të furnitorit

1. Verifikimet pasuese të deklaratave të furnitorit ose deklaratat afatgjata të furnitorit mund të kryhen në mënyrë rastësore ose kurdoherë që autoritetet doganore të vendit ku janë marrë në konsideratë këto deklarata për të lëshuar certifikatën e qarkullimit EUR.1 ose për të bërë një deklaratë origjine, kanë dyshime të arsyeshme në lidhje me vërtetësinë e dokumentit ose saktësinë e informacionit të dhënë në dokument.

2. Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të paragrafit 1, autoritetet doganore të vendit të përmendur në paragrafin 1 u kthejnë autoriteteve doganore të vendit ku është bërë deklarata, deklaratën e furnitorit dhe faturën(at), notat e dorëzimit ose dokumentet e tjera tregtare në lidhje me mallrat që mbulohen nga kjo deklaratë, duke dhënë, sipas rastiit, shkaqet e përmbajtjes ose formës së kërkesës për verifikim.

Ata u transmetojnë, në mbështetje të kërkesës për verifikim të mëtejshëm, çdo dokument dhe informacion që është përftuar duke sugjeruar që informacioni i dhënë në deklaratën e furnitorit është i pasaktë.

3. Verifikimi kryhet nga autoritetet doganore të vendit ku është bërë deklarata e furnitorit. Për këtë qëllim, ata kanë të drejtën për të kërkuar çdo provë dhe të kryejnë çdo inspektim të llogarive të furnitorit dhe çdo kontroll tjetër që ata e konsiderojnë të përshtatshëm.

4. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikimin informohen për rezultatet e tij sa më shpejt të jetë e mundur. Këto rezultate tregojnë qartësisht nëse informacioni i dhënë në deklaratën e furnitorit është i saktë dhe e bën të mundur për ta të përcaktojnë nëse dhe në cilën masë deklarata e furnitorit mund të merret parasysh për lëshimin e certifikatës së qarkullimit EUR.1 ose për të bërë një deklaratë origjine.

Neni 10

Sanksionet

Gjobat vendosen për çdo person që përpilon ose realizon përpilimin e një dokumenti që përmban informacion të pasaktë për qëllimet e përfitimit të trajtimit preferencial për produktet.

Neni 11

Zonat e lira

1. Bashkimi Europian dhe Algjeria marrin të gjitha masat për të siguruar që produktet e tregtuara nën një vërtetim origjine, të cilat në kontekstin e transportit përdorin një zonë të lirë që gjendet në territorin e tyre, të mos zëvendësohen nga mallra të tjera dhe nuk u nënshtrohen trajtimit të ndryshëm nga operacionet normale të destinuar për të parandaluar përkeqësimin e tyre.



2. Në shmangie nga paragrafi 1, kur produktet me origjinë në Bashkimin European ose Algjeri importohen në një zonë të lirë nën mbulimin e vërtetimit të origjinës dhe i nënshtrohen trajtimit ose përpunimit, autoritetet përkatëse lëshojnë një certifikatë të re qarkullimi EUR.1 me kërkesë të eksportuesit, nëse trajtimi ose përpunimi i kryer përputhet me dispozitat e kësaj Konvente.

ANEKSI III

TREGTIA NDËRMJET BASHKIMIT EUROPIAN DHE MBRETËRISË SË MAROKUT

Neni 1

Mallrat që kanë përftuar origjinën e tyre nëpërmjet zbatimit të dispozitave të parashikuara në këtë aneks përjashtohen nga kumulimi përmendur në nenin 3 të shtojcës I.

Neni 2

Kumulimi në Bashkimin European

Për qëllimin e zbatimit të nenit 2 (1) (b) të shtojcës I, punimi ose përpunimi i kryer në Marok, Algjeri ose Tunizi konsiderohet të jetë kryer në Bashkimin European nëse produktet e përfthuara pësojnë punim ose përpunim të mëtejshëm në Bashkimin European. Nëse, në pajtim me këtë dispozitë, produktet e origjinës përftohen në dy ose më shumë vende përkatëse, ata konsiderohen të kenë origjinën në Bashkimin European vetëm nëse punimi ose përpunimi shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

Neni 3

Kumulimi në Marok

Për qëllimin e zbatimit të nenit 2 (1) (b) të shtojcës I, punimi ose përpunimi i kryer në Bashkimin European, Algjeri ose Tunizi konsiderohet të jetë kryer në Marok nëse produktet e përfthuara pësojnë punim ose përpunim të mëtejshëm në Marok. Nëse, në pajtim me këtë dispozitë, produktet e origjinës përftohen në dy ose më shumë vende përkatëse, ata konsiderohen të kenë origjinën në Marok vetëm nëse punimi ose përpunimi shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

Neni 4

Vërtetimet e origjinës

1. Pa cenuar nenin 16 (4) dhe (5) të shtojcës I, një certifikatë qarkullimi EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të një shteti anëtar të Bashkimit European ose të Marokut nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Bashkimin European ose në Marok, me zbatimin e kumulimit të përmendur në nenet 2 dhe 3 të këtij aneksi dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

2. Pa cenuar nenin 21 (2) dhe (3) të shtojcës I, një certifikatë origjine mund të bëhet nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Bashkimin European ose në Marok, me zbatimin e kumulimit të përmendur në nenet 2 dhe 3 të këtij aneksi dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

Neni 5

Deklarata e furnitorit

1. Nëse lëshohet një certifikatë qarkullimi EUR.1, ose bëhet një deklaratë origjine, në Bashkimin European ose në Marok për produktet e origjinës, në prodhimin e të cilave janë përdorur mallra që vijnë nga Algjeria, Maroku, Tunizia ose Bashkimi European që kanë kaluar një punim ose përpunim në këto vende pa përftuar statusin preferencial të origjinës, merret parasysh deklaratata e furnitorit që jepet për këto mallra në pajtim me këtë nen.

2. Deklarata e furnitorit e përmendur në paragrafin 1 shërben si provë për punimin ose përpunimin e kryer në Algjeri, Marok, Tunizi ose Bashkimin European për mallrat përkatëse për qëllimin e përcaktimit nëse

produktet për prodhimin e të cilave përdoren këto mallra, mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Bashkimin Europian ose Marok dhe përbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

3. Një deklaratë e veçantë e furnitorit, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 4, bëhet nga furnitori për çdo dërgesë të mallrave në formën e parashikuar në aneksin A në një letër që i bashkëngjitet faturës, notës së dorëzimit dhe çdo dokument tjetër tregtar që përshkruan mallrat përkatëse me hollësi të mjaftueshme për t'u mundësuar atyre identifikimin.

4. Nëse një furnitor i sjell furnizim me mallra një klienti për të cilat punimi ose përpunimi i kryer në Algjeri, Marok, Tunizi ose Bashkimin Europian pritet të mbetet konstant për periudha të konsiderueshme kohë, ai mund të japë një deklaratë të vetme furnitori për të mbuluar dërgesat e mëvonshme të mallrave, që këtu quhet "deklaratë afatgjatë e furnitorit".

Një deklaratë afatgjatë e furnitorit mund të quhet normalisht e vlefshme për një periudhë deri në një vit nga data e bërjes së kësaj deklarate. Autoritetet doganore të vendit ku bëhet deklarata caktojnë kushtet në të cilat aplikohen periudha më të gjata.

Një deklaratë afatgjatë e furnitorit bëhet nga furnitori në formën e parashikuar në aneksin B dhe përshkruan mallrat përkatëse me detaje të hollësishme për t'u mundësuar atyre identifikimin. Ajo i jepet klientit përkatës para se ai të marrë dërgesën e parë të mallrave, mbuluar nga kjo deklaratë ose së bashku me dërgesën e parë.

Furnitori informon klientin e tij menjëherë nëse deklarata afatgjatë e furnitorit nuk vazhdon të jetë e zbatueshme për mallrat e dërguara.

5. Deklarata e furnitorit e përmendur në paragrafët 3 dhe 4 shkruhen me germa shtypi ose printohen në një prej gjuhëve në të cilat është hartuar marrëveshja, në pajtim me dispozitat e së drejtës së brendshme të vendit ku është bërë dhe mban nënshkrimin origjinal të furnitorit me shkrim dore. Deklarata mund të shkruhet, gjithashtu, me dorë dhe në këtë rast ajo shkruhet me bojë dhe me germa shtypi.

6. Furnitori që bën deklaratën duhet të jetë i përgatitur të paraqesë në çdo kohë, me kërkesë të autoriteteve doganore të vendit ku bëhet deklarata, të gjitha dokumentet e përshtatshme që provojnë që informacioni i dhënë në këtë deklaratë është i saktë.

Neni 6

Dokumentet shoqëruese

Deklarata e furnitorit që provon punimin ose përpunimin e kryer në Bashkimin Europian, Tunizi, Marok ose Algjeri për materialet e përdorura, e bërë në një nga këto vende, trajtohet si një dokument i referuar në nenin 16 (3) dhe 21 (5) të shtojcës I dhe nenin 5 (6) të këtij aneksi të përdorur për qëllimin e vërtetimit që produktet e mbuluara nga një certifikatë qarkullimi EUR.1 ose nga një deklaratë origjinale mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Bashkimin Europian ose në Marok dhe përbush kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

Neni 7

Ruajtja e deklaratës së furnitorit

Furnitori që bën një deklaratë furnitori mban për të paktën tre vjet kopje të deklaratës dhe faturës, notat e dorëzimit dhe dokumente të tjera tregtare të cilave u bashkëngjitet kjo deklaratë, si dhe dokumentet e përmendura në nenin 5 (6) të këtij aneksi.

Furnitori që bën një deklaratë afatgjatë furnitori mban për të paktën tre vjet kopje të deklaratës dhe të të gjitha faturave, notat e dorëzimit dhe dokumente të tjera tregtare në lidhje me mallrat e mbuluara nga ajo deklaratë e dërguar klientit përkatës, si dhe dokumentet e përmendura në nenin 5 (6) të këtij aneksi. Kjo periudhë fillon nga data e skadimit të vlefshmërisë së deklaratës afatgjatë të furnitorit.

Neni 8

Bashkëpunimi administrativ

Për të siguruar zbatimin e duhur të këtij aneksi, Bashkimi Europian dhe Maroku asistojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet autoriteteve kompetente doganore, në kontrollin e autenticitetit të certifikatës së qarkullimit EUR.1, deklaratat e origjinës ose deklaratat e furnitorit dhe saktësinë e informacionit të dhënë në këto dokumente.



Neni 9

Verifikimi i deklaratave të furnitorit

1. Verifikimet pasuese të deklaratave të furnitorit ose deklaratat afatgjata të furnitorit mund të kryhen në mënyrë rastësore ose kurdoherë që autoritetet doganore të vendit ku janë marrë në konsideratë këto deklarata për të lëshuar certifikatën e qarkullimit EUR.1 ose për të bërë një deklaratë origjinë, kanë dyshime të arsyeshme në lidhje me vërtetësinë e dokumentit ose saktësinë e informacionit të dhënë në dokument.

2. Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të paragrafit 1, autoritetet doganore të vendit, të përmendur në paragrafin 1, u kthejnë autoriteteve doganore të vendit ku është bërë deklarata, deklaratën e furnitorit dhe faturën(at), notat e dorëzimit ose dokumentet e tjera tregtare në lidhje me mallrat që mbulohen nga kjo deklaratë, duke dhënë, sipas rastit, shkaqet e përbajtjes ose formës së kërkesës për verifikim.

Ata u transmetojnë, në mbështetje të kërkesës për verifikim të mëtejshëm, çdo dokument dhe informacion që është përftuar duke sugjeruar që informacioni i dhënë në deklaratën e furnitorit është i pasaktë.

3. Verifikimi kryhet nga autoritetet doganore të vendit ku është bërë deklarata e furnitorit. Për këtë qëllim, ata kanë të drejtën për të kërkuar çdo provë dhe të kryejnë çdo inspektim të llogarive të furnitorit dhe çdo kontroll tjetër që ata e konsiderojnë të përshtatshëm.

4. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikimin informohen për rezultatet e tij sa më shpejt të jetë e mundur. Këto rezultate tregojnë qartësisht nëse informacioni i dhënë në deklaratën e furnitorit është i saktë dhe e bën të mundur për ta të përcaktojnë, nëse dhe në cilën masë deklarata e furnitorit mund të merret parasysh për lëshimin e certifikatës së qarkullimit EUR.1 ose për të bërë një deklaratë origjinë.

Neni 10

Sanksionet

Gjobat vendosen për çdo person që përpilon ose realizon përpilimin e një dokumenti që përmban informacion të pasaktë për qëllimet e përfitimit të trajtimit preferencial për produktet.

Neni 11

Zonat e lira

1. Bashkimi Europian dhe Maroku marrin të gjitha masat për të siguruar që produktet e tregtuara nën një vërtetim origjinë, të cilat në kontekstin e transportit përdorin një zonë të lirë që gjendet në territorin e tyre, të mos zëvendësohen nga mallra të tjera dhe nuk u nënshtrohen trajtimit të ndryshëm nga operacionet normale të destinuara për të parandaluar përkeqësimin e tyre.

2. Në shmangie nga paragrafi 1, kur produktet me origjinë në Bashkimin Europian ose Marok importohen në një zonë të lirë nën mbulimin e vërtetimit të origjinës dhe i nënshtrohen trajtimit ose përpunimit, autoritetet përkatëse lëshojnë një certifikatë të re qarkullimi EUR.1 me kërkesë të eksportuesit, nëse trajtimi ose përpunimi i kryer përputhet me dispozitat e kësaj Konvente.

ANEKSI IV

TREGTIA NDËRMJET BASHKIMIT EUROPIAN DHE REPUBLIKËS SË TUNIZISË

Neni 1

Mallrat që kanë përftuar origjinën e tyre nëpërmjet zbatimit të dispozitave të parashikuara në këtë aneks përjashtohen nga kumulimi përmendur në nenin 3 të shtojcës I.

Neni 2

Kumulimi në Bashkimin Europian

Për qëllimin e zbatimit të nenit 2 (1) (b) të shtojcës I, punimi ose përpunimi i kryer në Marok, Algjeri ose Tunizi konsiderohet të jetë kryer në Bashkimin Europian nëse produktet e përftuara pësojnë punim ose përpunim të mëtejshëm në Bashkimin Europian. Nëse në pajtim me këtë dispozitë, produktet e origjinës përftohen në dy ose më shumë vende përkatëse, ata konsiderohen të kenë origjinën në Bashkimin Europian vetëm nëse punimi ose përpunimi shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

Neni 3 **Kumulimi në Tunizi**

Për qëllimin e zbatimit të nenit 2 (1) (b) të shtojcës I, punimi ose përpunimi i kryer në Bashkimin European, Algjeri ose Tunizi konsiderohet të jetë kryer në Tunizi nëse produktet e përfuara pësojnë punim ose përpunim të mëtejshëm në Tunizi. Nëse, në pajtim me këtë dispozitë, produktet e origjinës përftohesh në dy ose më shumë vende përkatëse, ata konsiderohen të kenë origjinën në Tunizi vetëm nëse punimi ose përpunimi shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

Neni 4 **Vërtetimet e origjinës**

1. Pa cenuar nenin 16 (4) dhe (5) të shtojcës I, një certifikatë qarkullimi EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të një shteti anëtar të Bashkimit European ose të Tunizisë nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Bashkimin European ose në Tunizi, me zbatimin e kumulimit të përmendur në nenet 2 dhe 3 të këtij aneksi dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

2. Pa cenuar nenin 21 (2) dhe (3) të shtojcës I, një certifikatë origjine mund të bëhet nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Bashkimin European ose në Tunizi, me zbatimin e kumulimit të përmendur në nenet 2 dhe 3 të këtij aneksi dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

Neni 5 **Deklarata e furnitorit**

1. Nëse lëshohet një certifikatë qarkullimi EUR.1, ose bëhet një deklaratë origjine, në Bashkimin European ose në Tunizi për produktet e origjinës, në prodhimin e të cilave janë përdorur mallra që vijnë nga Algjeria, Maroku, Tunizia ose Bashkimi European që kanë kaluar një punim ose përpunim në këto vende pa përfuqar statusin preferencial të origjinës, merret parasysh deklaratata e furnitorit që jepet për këto mallra në pajtim me këtë nen.

2. Deklarata e furnitorit e përmendur në paragrafin 1 shërben si provë për punimin ose përpunimin e kryer në Algjeri, Marok, Tunizi ose Bashkimin European për mallrat përkatëse për qëllimin e përcaktimit nëse produktet për prodhimin e të cilave përdoren këto mallra, mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Bashkimin European ose Tunizia dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

3. Një deklaratë e veçantë e furnitorit, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 4, bëhet nga furnitori për çdo dërgesë të mallrave në formën e parashikuar në aneksin A në një letër që i bashkëngjitet faturës, notës së dorëzimit dhe çdo dokument tjetër tregtar që përshkruan mallrat përkatëse me hollësi të mjaftueshme për t'u mundësuar atyre identifikimin.

4. Nëse një furnitor i sjell furnizim me mallra një klienti për të cilat punimi ose përpunimi i kryer në Algjeri, Marok, Tunizi ose Bashkimin European pritet të mbetet konstant për periudha të konsiderueshme kohe, ai mund të japë një deklaratë të vetme furnitori për të mbuluar dërgesat e mëvonshme të mallrave, që këtu quhet "deklaratë afatgjatë e furnitorit".

Një deklaratë afatgjatë e furnitorit mund të quhet normalisht e vlefshme për një periudhë deri në një vit nga data e bërjes së kësaj deklarate. Autoritetet doganore të vendit ku bëhet deklarata caktojnë kushtet në të cilat aplikohen periudha më të gjata.

Një deklaratë afatgjatë e furnitorit bëhet nga furnitori në formën e parashikuar në aneksin B dhe përshkruan mallrat përkatëse me detaje të hollësishme për t'u mundësuar atyre identifikimin. Ajo i jepet klientit përkatës para se ai të marrë dërgesën e parë të mallrave, mbuluar nga kjo deklaratë ose së bashku me dërgesën e parë.

Furnitori informon klientin e tij menjëherë nëse deklarata afatgjatë e furnitorit nuk vazhdon të jetë e zbatueshme për mallrat e dërguara.

5. Deklarata e furnitorit e përmendur në paragrafët 3 dhe 4 shkruhet me germa shtypi ose printohet në një prej gjuhëve në të cilat është hartuar marrëveshja, në pajtim me dispozitat e së drejtës së brendshme të vendit ku është bërë dhe mban nënshkrimin origjinal të furnitorit me shkrim dore. Deklarata mund të shkruhet, gjithashtu, me dorë dhe në këtë rast ajo shkruhet me bojë dhe me germa shtypi.



6. Furnitori që bën deklaratën duhet të jetë i përgatitur të paraqesë në çdo kohë, me kërkesë të autoriteteve doganore të vendit ku bëhet deklarata, të gjitha dokumentet e përshtatshme që provojnë që informacioni i dhënë në këtë deklaratë është i saktë.

Neni 6

Dokumentet shoqëruese

Deklarata e furnitorit që provon punimin ose përpunimin e kryer në Bashkimin Europian, Tunizi, Marok ose Algjeri për materialet e përdorura, e bërë në një nga këto vende, trajtohet si një dokument i referuar në nenet 16 (3) dhe 21 (5) të shtojcës I dhe nenin 5 (6) të këtij aneksi të përdorur për qëllimin e vërtetimit që produktet e mbuluara nga një certifikatë qarkullimi EUR.1 ose nga një deklaratë origjinale mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Bashkimin Europian ose në Tunizi dhe përmbush kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

Neni 7

Ruajtja e deklaratës së furnitorit

Furnitori që bën një deklaratë furnitori mban për të paktën tre vjet kopje të deklaratës dhe faturës, notat e dorëzimit dhe dokumente të tjera tregtare të cilave u bashkëngjitet kjo deklaratë, si dhe dokumentet e përmendura në nenin 5 (6) të këtij aneksi.

Furnitori që bën një deklaratë afatgjatë furnitori mban për të paktën tre vjet kopje të deklaratës dhe të të gjitha faturave, notat e dorëzimit dhe dokumente të tjera tregtare në lidhje me mallrat e mbuluara nga ajo deklaratë e dërguar klientit përkatës, si dhe dokumentet e përmendura në nenin 5 (6) të këtij aneksi. Kjo periudhë fillon nga data e skadimit të vlefshmërisë së deklaratës afatgjatë të furnitorit.

Neni 8

Bashkëpunimi administrativ

Për të siguruar zbatimin e duhur të këtij aneksi, Bashkimi Europian dhe Tunizia asistojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet autoriteteve kompetente doganore, në kontrollin e autenticitetit të certifikatës së qarkullimit EUR.1, deklaratat e origjinës ose deklaratat e furnitorit dhe saktësinë e informacionit të dhënë në këto dokumente.

Neni 9

Verifikimi i deklaratave të furnitorit

1. Verifikimet pasuese të deklaratave të furnitorit ose deklaratat afatgjata të furnitorit mund të kryhen në mënyrë rastësore ose kurdoherë që autoritetet doganore të vendit ku janë marrë në konsideratë këto deklarata për të lëshuar certifikatën e qarkullimit EUR.1 ose për të bërë një deklaratë origjinale, kanë dyshime të arsyeshme në lidhje me vërtetësinë e dokumentit ose saktësinë e informacionit të dhënë në dokument.

2. Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të paragrafit 1, autoritetet doganore të vendit të përmendur në paragrafin 1 u kthejnë autoriteteve doganore të vendit ku është bërë deklarata deklaratën e furnitorit dhe faturën(at), notat e dorëzimit ose dokumentet e tjera tregtare në lidhje me mallrat që mbuloohen nga kjo deklaratë, duke dhënë, sipas rastit, shkaqet e përmbajtjes ose formës së kërkesës për verifikim.

Ata u transmetojnë, në mbështetje të kërkesës për verifikim të mëtejshëm, çdo dokument dhe informacion që është përftuar duke sugjeruar që informacioni i dhënë në deklaratën e furnitorit është i pasaktë.

3. Verifikimi kryhet nga autoritetet doganore të vendit ku është bërë deklarata e furnitorit. Për këtë qëllim, ata kanë të drejtën për të kërkuar çdo provë dhe të kryejnë çdo inspektim të llogarive të furnitorit dhe çdo kontroll tjetër që ata e konsiderojnë të përshtatshëm.

4. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikimin informohen për rezultatet e tij sa më shpejt të jetë e mundur. Këto rezultate tregojnë qartësisht nëse informacioni i dhënë në deklaratën e furnitorit është i saktë dhe e bën të mundur për ta të përcaktojnë nëse, dhe në cilën masë deklarata e furnitorit mund të merret parasysh për lëshimin e certifikatës së qarkullimit EUR.1 ose për të bërë një deklaratë origjinale.

Neni 10
Sanksionet

Gjobat vendosen për çdo person që përpilon ose realizon përpilimin e një dokumenti që përmban informacion të pasaktë për qëllimet e përfitimit të trajtimit preferencial për produktet.

Neni 11
Zonat e lira

1. Bashkimi Europian dhe Tunizia marrin të gjitha masat për të siguruar që produktet e tregtuara nën një vërtetim origjinë, të cilat në kontekstin e transportit përdorin një zonë të lirë që gjendet në territorin e tyre, të mos zëvendësohen nga mallra të tjera dhe nuk u nënshtrohen trajtimit të ndryshëm nga operacionet normale të destinuara për të parandaluar përkeqësimin e tyre.

2. Në shmangie nga paragrafi 1, kur produktet me origjinë në Bashkimin Europian ose Tunizi importohen në një zonë të lirë nën mbulimin e vërtetimit të origjinës dhe i nënshtrohen trajtimit ose përpunimit, autoritetet përkatëse lëshojnë një certifikatë të re qarkullimi EUR.1 me kërkesë të eksportuesit, nëse trajtimi ose përpunimi i kryer përputhet me dispozitat e kësaj Konvente.

ANEKSI V
CEUTA DHE MELILLA

Neni 1
Zbatimi i Konventës

1. Termi “Bashkim Europian” nuk përfshin *Ceutan* dhe *Melillas*.

2. Produktet me origjinë në një palë kontraktuese të ndryshme nga “Bashkimi Europian”, kur importohen në *Ceuta* ose *Melilla*, gëzojnë në të gjitha aspektet të njëjtin regjim doganor që zbatohet për produktet me origjinë në territorin doganor të Bashkimit Europian sipas protokollit 2 të aktit të aderimit të Mbretërisë së Spanjës dhe Republikës Portugeze për në komunitetet europiane. Palët kontraktuese të ndryshme nga Bashkimi Europian u japin importeve të produkteve të mbuluara nga marrëveshja përkatëse dhe me origjinë në *Ceuta* dhe *Melilla* të njëjtin regjim doganor si ai që u jepet produkteve të importuara dhe me origjinë në Bashkimin Europian.

3. Për qëllimet e zbatimit të paragrafit 2 në lidhje me produktet me origjinë në *Ceuta* dhe *Melilla*, kjo Konventë zbatohet *mutatis mutandis* në pajtim me kushtet e veçanta të parashikuara në nenin 2.

Neni 2
Kushte të veçanta

1. Me kusht që ato të jenë transportuar drejtpërdrejt në pajtim me dispozitat e nenit 12 të shtojcës I merret parasysh sa më poshtë:

1. Produktet me origjinë në *Ceuta* dhe *Melilla*:

a) produktet e përftuar tërësisht në *Ceuta* dhe *Melilla*;

b) produktet e përftuar në *Ceuta* dhe *Melilla* në prodhimin e të cilave janë përdorur produkte të ndryshme nga ato të përmendura në (a), me kusht që:

i) këto produkte t'u jenë nënshtruar një punimi ose përpunimi të mjaftueshëm në kuptimin e nenit 5 të shtojcës I; ose që

ii) ato produkte e kanë origjinën në palën kontraktuese importuese ose në Bashkimin Europian, me kusht që ata t'i jenë nënshtruar një punimi ose përpunimi që shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

2. Produktet me origjinë në palën kontraktuese eksportuese, të ndryshme nga Bashkimi Europian:

a) produktet e përfthuara tërësisht në palën kontraktuese eksportuese;

b) produktet e përfthuara në palën kontraktuese eksportuese, në prodhimin e të cilave janë përdorur produkte të ndryshme nga ato të përmendura në (a), me kusht që:



i) këto produkte t'i jenë nënshtruar një punimi ose përpunimi të mjaftueshëm në kuptimin e nenit 5 të shtojcës I; ose që

ii) ato produkte e kanë origjinën në *Ceuta* dhe *Malilla* ose në Bashkimin Europian, me kusht që ato t'i jenë nënshtruar një punimi ose përpunimi që shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

2. *Ceuta* dhe *Melilla* konsiderohen të jenë një territor i vetëm.

3. Eksportuesi ose përfaqësuesi i tij autorizuar fut emrin e palës kontraktuese ose importuese dhe "*Ceuta* dhe *Melilla*" në kutinë 2 të certifikatave të qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED ose për deklaratat e origjinës ose deklaratat origjinës EUR-MED. Përveç kësaj, në rastin e produkteve me origjinë në *Ceuta* dhe *Melilla*, kjo tregohet në kutinë 4 të certifikatës së qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED ose për deklaratat e origjinës ose deklaratat origjinës EUR-MED.

4. Autoritetet doganore spanjolle janë përgjegjëse për zbatimin e kësaj Konvente në *Ceuta* dhe *Melilla*.

ANEKSI VI DEKLARATË E PËRBASHKËT

Në lidhje me Principatën e Andorrës

1. Produktet me origjinë në Principatën e Andorrës që përfshihen në kapitujt 25 deri 97 të sistemit të harmonizuar pranohen nga palët kontraktuese përveç Bashkimit Europian sikur të kenë origjinën në Bashkimin Europian brenda kuptimit të kësaj Konvente.

2. Konventa zbatohet *mutatis mutandis* për qëllimin e përcaktimit të statusit të origjinës të produkteve të sipërpërmendura.

ANEKSI VII DEKLARATË E PËRBASHKËT

Në lidhje me Republikën e San Marinos

1. Produktet me origjinë në Republikën e San Marinos pranohen nga palët kontraktuese përveç Bashkimit Europian sikur të kenë origjinën në Bashkimin Europian brenda kuptimit të kësaj Konvente.

2. Konventa zbatohet *mutatis mutandis* për qëllimin e përcaktimit të statusit të origjinës të produkteve të sipërpërmendura.

ANEKSI VIII TREGTIA NDËRMJET REPUBLIKËS SË TURQISË DHE VENDEVE QË MARRIN PJESË NË PROCESIN E STABILIZIMIT DHE ASOCIIMIT

Neni 1

Produktet e renditura më poshtë përjashtohen nga kumulimi i parashikuar në nenin 3 të shtojcës I, nëse:

a) vendi i destinacionit të fundit është Republika e Turqisë dhe:

i) materialet e përdorura në prodhimin e këtyre produkteve janë me origjinë në një prej vendeve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit; ose

ii) këto produkte kanë përfutur origjinën e tyre mbi bazën e punimit ose përpunimit të kryer në një prej vendeve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit; ose

b) vendi i destinacionit të fundit është një prej vendeve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit dhe:

i) materialet e përdorura në prodhimin e këtyre produkteve janë me origjinë në Republikën e Turqisë; ose

ii) këto produkte kanë përfutur origjinën e tyre mbi bazën e punimit ose përpunimit të kryer në Republikën e Turqisë.

| Kodi CN | Përshkrimi |
|--------------------------|--|
| 1704 90 99 | Prodhime të tjera sheqeri, që nuk përmbajnë kakao |
| 1806 10 30 1806 10 90 | Çokollatë dhe preparate të tjera ushqimore që mbajnë kakao - Pudër kakao, që përmban lëndë të shtuar sheqeri ose ëmbëlsimi: - që përmban 65% ose më shumë por më pak se 80% në peshë të sukrozës (duke përfshirë sheqer invert të shprehur si sukrozë) ose izoglukoze të shprehur si sukrozë - që përmban 80% ose më shumë peshë sukrozë (duke përfshirë sheqer invert të shprehur si sukrozë) ose izoglukoze të shprehur si sukrozë |
| 1806 20 95 | - preparate të tjera ushqimore që përmbajnë kakao në blloqe, copa, shufra me pesë më të lartë se 2 kg ose në gjendje të lëngët, pastë, pudër, grimca ose formë tjetër rifuxho në kontejnerë ose paketim të drejtpërdrejtë mase më shumë se 2 kg. -- Të tjera --- Të tjera |
| 1901 90 99 | Ekstrakt malte, preparate ushqimore mielli, bluar trashë, ushqim, ekstrakt niseshteje ose malte, pjesë që përmbajnë kakao ose që në peshë kanë më pak se 40% të kakaos llogaritur në një bazë plotësisht pa yndyrë, që nuk është specifikuar ose përfshirë gjetikë, preparate ushqimore të mallrave të kërërve 0401 deri 0404, që nuk përmbajnë kakao ose që në peshë kanë më pak se 40% të kakaos llogaritur në një bazë plotësisht pa yndyrë, që nuk është specifikuar ose përfshirë gjetikë; - Të tjera -- Të tjera (nga ekstrakte malte) --- Të tjera |
| 2101 12 98 | Preparate të tjera me bazë kafeje |
| 2101 20 98 | Preparate të tjera me bazë çaji ose mate |
| 2106 90 59 (1) | Preparate ushqimore që nuk janë përfshirë ose specifikuar gjetikë - Të tjera -- Të tjera |
| 2106 90 98 | Preparate ushqimore që nuk janë përfshirë ose specifikuar gjetikë: - Të tjera (nga koncentratet e proteinës dhe substancat proteinike të strukturuar) -- Të tjera --- Të tjera |
| 3302 10 29 | Përzierjet e substancave dhe përzierjeve aromatizuese (duke përfshirë solucionet alkoolike) me bazë prej një ose më shumë prej këtyre substancave, të një lloji të përdorur si lëndë e parë në industri; preparate të tjera bazuar në substance aromatizuese, të një lloji për prodhimin e pijeve alkoolike: - të llojit të përdorur në industrinë ushqimore dhe të pijeve; -- të llojit të përdorur në industrinë e pijeve: --- preparate që përmbajnë esenca që karakterizojnë një pije: ----të një fuqie alkoolike faktike me volum që kalon 0.5% ---- të tjera: ----- që përmbajnë yndyra të qumështit, sukrozë, izoglukoze, glukozë, ose niseshte apo që përmbajnë, në peshë, më pak se 1.5% yndyrë qumështi, 5% sukrozë ose izoglukoze, 5% glukozë ose niseshte. ----- të tjera |

1. Ky produkt nuk përjashtohet nga kumulimi i përmendur në nenin 1 të këtij aneksi në tregtinë preferenciale ndërmjet Republikës së Turqisë dhe Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë.



ANEKSI IX TREGTIA NDËRMJET REPUBLIKËS SË TURQISË DHE MBRETËRISË SË MAROKUT

Neni 1

Mallrat që kanë përftuar origjinën e tyre nëpërmjet zbatimit të dispozitave të parashikuara në këtë aneks përjashtohen nga kumulimi përmendur në nenin 3 të shtojcës I.

Neni 2

Kumulimi në Turqi

Për qëllimin e zbatimit të nenit 2 (1) (b) të shtojcës I, punimi ose përpunimi i kryer në Marok, Algjeri ose Tunizi konsiderohet të jetë kryer në Turqi nëse produktet e përftuara pësojnë punim ose përpunim të mëtejshëm në Turqi. Nëse, në pajtim me këtë dispozitë, produktet e origjinës përftohen në dy ose më shumë vende përkatëse, ata konsiderohen të kenë origjinën në Turqi vetëm nëse punimi ose përpunimi shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

Neni 3

Kumulimi në Marok

Për qëllimin e zbatimit të nenit 2 (1) (b) të shtojcës I, punimi ose përpunimi i kryer në Turqi, Algjeri ose Tunizi konsiderohet të jetë kryer në Marok nëse produktet e përftuara pësojnë punim ose përpunim të mëtejshëm në Marok. Nëse, në pajtim me këtë dispozitë, produktet e origjinës përftohen në dy ose më shumë vende përkatëse, ata konsiderohen të kenë origjinën në Marok vetëm nëse punimi ose përpunimi shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

Neni 4

Vërtetimet e origjinës

1. Pa cenuar nenin 16 (4) dhe (5) të shtojcës I, një certifikatë qarkullimi EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të Turqisë ose Marokut nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Turqi ose Marok, me zbatimin e kumulimit të përmendur në nenet 2 dhe 3 të këtij aneksi dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

2. Pa cenuar nenin 21 (2) dhe (3) të shtojcës I, një certifikatë origjine mund të bëhet nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Turqi ose Marok, me zbatimin e kumulimit të përmendur në nenet 2 dhe 3 të këtij aneksi dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

Neni 5

Deklarata e furnitorit

1. Nëse lëshohet një certifikatë qarkullimi EUR.1, ose bëhet një deklaratë origjine, në Turqi ose Marok për produktet e origjinës, në prodhimin e të cilave janë përdorur mallra që vijnë nga Algjeria, Maroku, Tunizia ose Turqia që kanë kaluar një punim ose përpunim në këto vende pa përftuar statusin preferencial të origjinës, merret parasysh deklaratata e furnitorit që jepet për këto mallra në pajtim me këtë nen.

2. Deklarata e furnitorit e përmendur në paragrafin 1 shërben si provë për punimin ose përpunimin e kryer në Algjeri, Marok, Tunizi ose Turqi për mallrat përkatëse për qëllimin e përcaktimit nëse produktet për prodhimin e të cilave përdoren këto mallra, mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Turqi ose Marok dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

3. Një deklaratë e veçantë e furnitorit, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 4, bëhet nga furnitori për çdo dërgesë të mallrave në formën e parashikuar në aneksin A në një letër që i bashkëngjitet faturës, notës së dorëzimit dhe çdo dokument tjetër tregtar që përshkruan mallrat përkatëse me hollësi të mjaftueshme për t'u mundësuar atyre identifikimin.

4. Nëse një furnitor i sjell furnizim me mallra një klienti për të cilat punimi ose përpunimi i kryer në Algjeri, Marok, Tunizi ose Turqi pritet të mbetet konstant për periudha të konsiderueshme kohë, ai mund të japë një deklaratë të vetme furnitori për të mbuluar dërgesat e mëvonshme të mallrave, që këtu quhet "deklaratë afatgjatë e furnitorit".

Një deklaratë afatgjatë e furnitorit mund të quhet normalisht e vlefshme për një periudhë deri në një vit nga data e bërjes së kësaj deklarate. Autoritetet doganore të vendit ku bëhet deklarata caktojnë kushtet në të cilat aplikohen periudha më të gjata.

Një deklaratë afatgjatë e furnitorit bëhet nga furnitori në formën e parashikuar në aneksin B dhe përshkruan mallrat përkatëse me detaje të hollësishme për t'u mundësuar atyre identifikimin. Ajo i jepet klientit përkatës para se ai të marrë dërgesën e parë të mallrave, mbuluar nga kjo deklaratë ose së bashku me dërgesën e parë.

Furnitori informon klientin e tij menjëherë nëse deklarata afatgjatë e furnitorit nuk vazhdon të jetë e zbatueshme për mallrat e dërguara.

5. Deklarata e furnitorit e përmendur në paragrafët 3 dhe 4 shkruhen me germa shtypi ose printohen në një prej gjuhëve në të cilat është hartuar marrëveshja, në pajtim me dispozitat e së drejtës së brendshme të vendit ku është bërë dhe mban nënshkrimin origjinal të furnitorit me shkrim dore. Deklarata mund të shkruhet, gjithashtu, me dorë dhe në këtë rast ajo shkruhet me bojë dhe me germa shtypi.

6. Furnitori që bën deklaratën duhet të jetë i përgatitur të paraqesë në çdo kohë, me kërkesë të autoriteteve doganore të vendit ku bëhet deklarata, të gjitha dokumentet e përshtatshme që provojnë që informacioni i dhënë në këtë deklaratë është i saktë.

Neni 6

Dokumentet shoqëruese

Deklarata e furnitorit që provon punimin ose përpunimin e kryer në Bashkimin Europian, Tunizi, Marok ose Algjeri për materialet e përdorura, e bërë në një nga këto vende, trajtohet si një dokument i referuar në nenet 16 (3) dhe 21 (5) të shtojcës I dhe nenin 5 (6) të këtij aneksi të përdorur për qëllimin e vërtetimit që produktet e mbuluara nga një certifikatë qarkullimi EUR.1 ose nga një deklaratë origjinale mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Bashkimin Europian ose në Marok dhe përmbush kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

Neni 7

Ruajtja e deklaratës së furnitorit

Furnitori që bën një deklaratë furnitori mban për të paktën tre vjet kopje të deklaratës dhe faturës, notat e dorëzimit dhe dokumente të tjera tregtare të cilave u bashkëngjitet kjo deklaratë, si dhe dokumentet e përmendura në nenin 5 (6) të këtij aneksi.

Furnitori që bën një deklaratë afatgjatë furnitori mban për të paktën tre vjet kopje të deklaratës dhe të të gjitha faturave, notat e dorëzimit dhe dokumente të tjera tregtare në lidhje me mallrat e mbuluara nga ajo deklaratë e dërguar klientit përkatës, si dhe dokumentet e përmendura në nenin 5 (6) të këtij aneksi. Kjo periudhë fillon nga data e skadimit të vlefshmërisë së deklaratës afatgjatë të furnitorit.

Neni 8

Bashkëpunimi administrativ

Për të siguruar zbatimin e duhur të këtij aneksi, Turqia dhe Maroku asistojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet autoriteteve kompetente doganore, në kontrollin e autenticitetit të certifikatës së qarkullimit EUR.1, deklaratat e origjinës ose deklaratat e furnitorit dhe saktësinë e informacionit të dhënë në këto dokumente.

Neni 9

Verifikimi i deklaratave të furnitorit

1. Verifikimet pasuese të deklaratave të furnitorit ose deklaratat afatgjata të furnitorit mund të kryhen në mënyrë rastësore ose kurdoherë që autoritetet doganore të vendit ku janë marrë në konsideratë këto deklarata për të lëshuar certifikatën e qarkullimit EUR.1 ose për të bërë një deklaratë origjinale, kanë dyshime të arsyeshme në lidhje me vërtetësinë e dokumentit ose saktësinë e informacionit të dhënë në dokument.

2. Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të paragrafit 1, autoritetet doganore të vendit të përmendur në paragrafin 1 u kthejnë autoriteteve doganore të vendit ku është bërë deklarata deklaratën e furnitorit dhe



faturën(at), notat e dorëzimit ose dokumentet e tjera tregtare në lidhje me mallrat që mbulohen nga kjo deklaratë, duke dhënë, sipas rastit, shkaqet e përmbytjes ose formës së kërkesës për verifikim.

Ata u transmetojnë, në mbështetje të kërkesës për verifikim të mëtejshëm, çdo dokument dhe informacion që është përftuar duke sugjeruar që informacioni i dhënë në deklaratën e furnitorit është i pasaktë.

3. Verifikimi kryhet nga autoritetet doganore të vendit ku është bërë deklarata e furnitorit. Për këtë qëllim, ata kanë të drejtën për të kërkuar çdo provë dhe të kryejnë çdo inspektim të llogarive të furnitorit dhe çdo kontroll tjetër që ata e konsiderojnë të përshtatshëm.

4. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikimin informohen për rezultatet e tij sa më shpejt të jetë e mundur. Këto rezultate tregojnë qartësisht nëse informacioni i dhënë në deklaratën e furnitorit është i saktë dhe e bën të mundur për to të përcaktojnë nëse dhe në cilën masë deklarata e furnitorit mund të merret parasysh për lëshimin e certifikatës së qarkullimit EUR.1 ose për të bërë një deklaratë origjine.

Neni 10 **Sanksionet**

Gjobat vendosen për çdo person që përpilon ose realizon përpilimin e një dokumenti që përmban informacion të pasaktë për qëllimet e përfitimit të trajtimit preferencial për produktet.

Neni 11 **Zonat e lira**

1. Turqia dhe Maroku marrin të gjitha masat për të siguruar që produktet e tregtuara nën një vërtetim origjine, të cilat në kontekstin e transportit përdorin një zonë të lirë që gjendet në territorin e tyre, të mos zëvendësohen nga mallra të tjera dhe nuk u nënshtrohen trajtimit të ndryshëm nga operacionet normale të destinuar për të parandaluar përkeqësimin e tyre.

2. Në shmangie nga paragrafi 1, kur produktet me origjinë në Turqi dhe Marok importohen në një zonë të lirë nën mbulimin e vërtetimit të origjinës dhe i nënshtrohen trajtimit ose përpunimit, autoritetet përkatëse lëshojnë një certifikatë të re qarkullimi EUR.1 me kërkesë të eksportuesit, nëse trajtimi ose përpunimi i kryer përputhet me dispozitat e kësaj Konvente.

ANEKSI X TREGTIA NDËRMJET REPUBLIKËS SË TURQISË DHE REPUBLIKËS SË TUNIZISË

Neni 1

Mallrat që kanë përftuar origjinën e tyre nëpërmjet zbatimit të dispozitave të parashikuara në këtë aneks përjashtohen nga kumulimi përmendur në nenin 3 të shtojcës I.

Neni 2 **Kumulimi në Turqi**

Për qëllimin e zbatimit të nenit 2 (1) (b) të shtojcës I, punimi ose përpunimi i kryer në Marok, Algjeri ose Tunizi konsiderohet të jetë kryer në Turqi nëse produktet e përftuara pësojnë punim ose përpunim të mëtejshëm në Turqi. Nëse, në pajtim me këtë dispozitë, produktet e origjinës përftohen në dy ose më shumë vende përkatëse, ata konsiderohen të kenë origjinën në Turqi vetëm nëse punimi ose përpunimi shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

Neni 3 **Kumulimi në Tunizi**

Për qëllimin e zbatimit të nenit 2 (1) (b) të shtojcës I, punimi ose përpunimi i kryer në Marok, Algjeri ose Algjeri konsiderohet të jetë kryer në Tunizi nëse produktet e përftuara pësojnë punim ose përpunim të mëtejshëm në Tunizi. Nëse, në pajtim me këtë dispozitë, produktet e origjinës përftohen në dy ose më shumë vende përkatëse, ata konsiderohen të kenë origjinën në Tunizi vetëm nëse punimi ose përpunimi shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

Neni 4
Vërtetimet e origjinës

1. Pa cenuar nenin 16 (4) dhe (5) të shtojcës I, një certifikatë qarkullimi EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të Turqisë ose Tunizisë nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Turqi ose Tunizi, me zbatimin e kumulimit të përmendur në nenet 2 dhe 3 të këtij aneksi dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

2. Pa cenuar nenin 21 (2) dhe (3) të shtojcës I, një certifikatë origjine mund të bëhet nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Turqi ose Tunizi, me zbatimin e kumulimit të përmendur në nenet 2 dhe 3 të këtij aneksi dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

Neni 5
Deklarata e furnitorit

1. Nëse lëshohet një certifikatë qarkullimi EUR.1, ose bëhet një deklaratë origjine, në Turqi ose Tunizi për produktet e origjinës, në prodhimin e të cilave janë përdorur mallra që vijnë nga Algjeria, Maroku, Tunizia ose Turqi që kanë kaluar një punim ose përpunim në këto vende pa përfutur statusin preferencial të origjinës, merret parasysh deklaratata e furnitorit që jepet për këto mallra në pajtim me këtë nen.

2. Deklarata e furnitorit e përmendur në paragrafin 1 shërben si provë për punimin ose përpunimin e kryer në Algjeri, Marok, Tunizi ose Turqi për mallrat përkatëse për qëllimin e përcaktimit nëse produktet për prodhimin e të cilave përdoren këto mallra, mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Turqi ose Tunizi dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

3. Një deklaratë e veçantë e furnitorit, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 4, bëhet nga furnitori për çdo dërgesë të mallrave në formën e parashikuar në aneksin A në një letër që i bashkëngjitet faturës, notës së dorëzimit dhe çdo dokument tjetër tregtar që përshkruan mallrat përkatëse me hollësi të mjaftueshme për t'u mundësuar atyre identifikimin.

4. Nëse një furnitor i sjell furnizim me mallra një klienti për të cilat punimi ose përpunimi i kryer në Algjeri, Marok, Tunizi ose Turqi pritet të mbetet konstant për periudha të konsiderueshme kohe, ai mund të japë një deklaratë të vetme furnitori për të mbuluar dërgesat e mëvonshme të mallrave, që këtu quhet "deklaratë afatgjatë e furnitorit".

Një deklaratë afatgjatë e furnitorit mund të quhet normalisht e vlefshme për një periudhë deri në një vit nga data e bërjes së kësaj deklarate. Autoritetet doganore të vendit ku bëhet deklarata caktojnë kushtet në të cilat aplikohen periudha më të gjata.

Një deklaratë afatgjatë e furnitorit bëhet nga furnitori në formën e parashikuar në aneksin B dhe përshkruan mallrat përkatëse me detaje të hollësishme për t'u mundësuar atyre identifikimin. Ajo i jepet klientit përkatës para se ai të marrë dërgesën e parë të mallrave, mbuluar nga kjo deklaratë ose së bashku me dërgesën e parë.

Furnitori informon klientin e tij menjëherë nëse deklarata afatgjatë e furnitorit nuk vazhdon të jetë e zbatueshme për mallrat e dërguara.

5. Deklarata e furnitorit e përmendur në paragrafët 3 dhe 4 shkruhen me germa shtypi ose printohen në një prej gjuhëve në të cilat është hartuar marrëveshja, në pajtim me dispozitat e së drejtës së brendshme të vendit ku është bërë dhe mban nënshkrimin origjinal të furnitorit me shkrim dore. Deklarata mund të shkruhet, gjithashtu, me dorë dhe në këtë rast ajo shkruhet me bojë dhe me germa shtypi.

6. Furnitori që bën deklaratën duhet të jetë i përgatitur të paraqesë në çdo kohë, me kërkesë të autoriteteve doganore të vendit ku bëhet deklarata, të gjitha dokumentet e përshtatshme që provojnë që informacioni i dhënë në këtë deklaratë është i saktë.

Neni 6
Dokumentet shoqëruese

Deklarata e furnitorit që provon punimin ose përpunimin e kryer në Turqi, Tunizi, Marok ose Algjeri për materialet e përdorura, e bërë në një nga këto vende, trajtohet si një dokument i referuar në nenet 16 (3) dhe 21 (5) të shtojcës I dhe nenin 5 (6) të këtij aneksi të përdorur për qëllimin e vërtetimit që produktet e mbuluar nga një certifikatë qarkullimi EUR.1 ose nga një deklaratë origjine mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Turqi ose Tunizi dhe përmbush kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.



Neni 7

Ruajtja e deklaratës së furnitorit

Furnitori që bën një deklaratë furnitori mban për të paktën tre vjet kopje të deklaratës dhe faturës, notat e dorëzimit dhe dokumente të tjera tregtare të cilave u bashkëngjitet kjo deklaratë, si dhe dokumentet e përmendura në nenin 5 (6) të këtij aneksi.

Furnitori që bën një deklaratë afatgjatë furnitori mban për të paktën tre vjet kopje të deklaratës dhe të gjitha faturave, notat e dorëzimit dhe dokumente të tjera tregtare në lidhje me mallrat e mbuluara nga ajo deklaratë e dërguar klientit përkatës, si dhe dokumentet e përmendura në nenin 5 (6) të këtij aneksi. Kjo periudhë fillon nga data e skadimit të vlefshmërisë së deklaratës afatgjatë të furnitorit.

Neni 8

Bashkëpunimi administrativ

Për të siguruar zbatimin e duhur të këtij aneksi, Turqia dhe Tunizia asistojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet autoriteteve kompetente doganore, në kontrollin e autenticitetit të certifikatës së qarkullimit EUR.1, deklaratat e origjinës ose deklaratat e furnitorit dhe saktësinë e informacionit të dhënë në këto dokumente.

Neni 9

Verifikimi i deklaratave të furnitorit

1. Verifikimet pasuese të deklaratave të furnitorit ose deklaratat afatgjata të furnitorit mund të kryhen në mënyrë rastësore ose kurdoherë që autoritetet doganore të vendit ku janë marrë në konsideratë këto deklarata për të lëshuar certifikatën e qarkullimit EUR.1 ose për të bërë një deklaratë origjine, kanë dyshime të arsyeshme në lidhje me vërtetësinë e dokumentit ose saktësinë e informacionit të dhënë në dokument.

2. Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të paragrafit 1, autoritetet doganore të vendit të përmendura në paragrafin 1 u kthejnë autoriteteve doganore të vendit ku është bërë deklarata, deklaratën e furnitorit dhe faturën(at), notat e dorëzimit ose dokumentet e tjera tregtare në lidhje me mallrat që mbuloohen nga kjo deklaratë, duke dhënë, sipas rastit, shkaqet e përbajtjes ose formës së kërkesës për verifikim.

Ata u transmetojnë, në mbështetje të kërkesës për verifikim të mëtejshëm, çdo dokument dhe informacion që është përftuar duke sugjeruar që informacioni i dhënë në deklaratën e furnitorit është i pasaktë.

3. Verifikimi kryhet nga autoritetet doganore të vendit ku është bërë deklarata e furnitorit. Për këtë qëllim, ata kanë të drejtën për të kërkuar çdo provë dhe të kryejnë çdo inspektim të llogarive të furnitorit dhe çdo kontroll tjetër që ata e konsiderojnë të përshtatshëm.

4. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikimin informohen për rezultatet e tij sa më shpejt të jetë e mundur. Këto rezultate tregojnë qartësisht nëse informacioni i dhënë në deklaratën e furnitorit është i saktë dhe e bën të mundur për ta të përcaktojnë nëse dhe në cilën masë deklarata e furnitorit mund të merret parasysh për lëshimin e certifikatës së qarkullimit EUR.1 ose për të bërë një deklaratë origjine.

Neni 10

Sanksionet

Gjobat vendosen për çdo person që përpilon ose realizon përpilimin e një dokumenti që përmban informacion të pasaktë për qëllimet e përfitimit të trajtimit preferencial për produktet.

Neni 11

Zonat e lira

1. Turqia dhe Tunizia marrin të gjitha masat për të siguruar që produktet e tregtuara nën një vërtetim origjine, të cilat në kontekstin e transportit përdorin një zonë të lirë që gjendet në territorin e tyre, të mos zëvendësohen nga mallra të tjera dhe nuk u nënshtrohen trajtimit të ndryshëm nga operacionet normale të destinuar për të parandaluar përkeqësimin e tyre.

2. Në shmangie nga paragrafi 1, kur produktet me origjinë në Turqi dhe Tunizi importohen në një zonë të lirë nën mbulimin e vërtetimit të origjinës dhe i nënshtrohen trajtimit ose përpunimit, autoritetet përkatëse lëshojnë një certifikatë të re qarkullimi EUR.1 me kërkesë të eksportuesit, nëse trajtimi ose përpunimi i kryer përputhet me dispozitat e kësaj Konvente.

ANEKSI XI TREGTIA NDËRMJET SHTETEVE TË EFTA-S DHE REPUBLIKËS SË TUNIZISË

Neni 1

Mallrat që kanë përftuar origjinën e tyre nëpërmjet zbatimit të dispozitave të parashikuara në këtë aneks përjashtohen nga kumulimi përmendur në nenin 3 të shtojcës I.

Neni 2

Kumulimi në një shtet të EFTA-s

Për qëllimin e zbatimit të nenit 2 (1) (b) të shtojcës I, punimi ose përpunimi i kryer në Tunizi konsiderohet të jetë kryer në një shtet të EFTA-s produktet e përfuara pësojnë punim ose përpunim të mëtejshëm në një shtet të EFTA-s. Nëse, në pajtim me këtë dispozitë, produktet e origjinës përftohen në dy ose më shumë vende përkatëse, ata konsiderohen të kenë origjinën në një shtet të EFTA-s vetëm nëse punimi ose përpunimi shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

Neni 3

Kumulimi në Tunizi

Për qëllimin e zbatimit të nenit 2 (1) (b) të shtojcës I, punimi ose përpunimi i kryer në një shtet të EFTA-s konsiderohet të jetë kryer në Tunizi nëse produktet e përfuara pësojnë punim ose përpunim të mëtejshëm në Tunizi. Nëse, në pajtim me këtë dispozitë, produktet e origjinës përftohen në dy ose më shumë vende përkatëse, ata konsiderohen të kenë origjinën në Tunizi vetëm nëse punimi ose përpunimi shkon tej operacioneve të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

Neni 4

Vërtetimet e origjinës

1. Pa cenuar nenin 16 (4) dhe (5) të shtojcës I, një certifikatë qarkullimi EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të një shteti të EFTA-s ose Tunizisë nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në një shtet të EFTA-s ose Tunizi, me zbatimin e kumulimit të përmendur në nenet 2 dhe 3 të këtij aneksi dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

2. Pa cenuar nenin 21 (2) dhe (3) të shtojcës I, një certifikatë origjine mund të bëhet nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në një shtet të EFTA-s ose Tunizi, me zbatimin e kumulimit të përmendur në nenet 2 dhe 3 të këtij aneksi dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

Neni 5

Deklarata e furnitorit

1. Nëse lëshohet një certifikatë qarkullimi EUR.1 ose bëhet një deklaratë origjine, në një shtet të EFTA-s ose në Tunizi për produktet e origjinës, në prodhimin e të cilave janë përdorur mallra që vijnë nga Tunizia ose shtetet e EFTA-s që kanë kaluar një punim ose përpunim në këto vende pa përfuar statusin preferencial të origjinës, merret parasysh deklaratat e furnitorit që jepet për këto mallra në pajtim me këtë nen.

2. Deklarata e furnitorit e përmendur në paragrafin 1 shërben si provë për punimin ose përpunimin e kryer në Tunizi ose një shtet të EFTA-s për mallrat përkatëse për qëllimin e përcaktimit nëse produktet për prodhimin e të cilave përdoren këto mallra, mund të konsiderohen si produkte me origjinë në një shtet të EFTA-s ose në Tunizi dhe përmbushin kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.



3. Një deklaratë e veçantë e furnitorit, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 4, bëhet nga furnitori për çdo dërgesë të mallrave në formën e parashikuar në aneksin A në një letër që i bashkëngjitet faturës, notës së dorëzimit dhe çdo dokument tjetër tregtar që përshkruan mallrat përkatëse me hollësi të mjaftueshme për t'u mundësuar atyre identifikimin.

4. Nëse një furnitor i sjell furnizim me mallra një klienti për të cilat punimi ose përpunimi i kryer në Tunizi ose në një shtet të EFTA-s pritet të mbetet konstant për periudha të konsiderueshme kohe, ai mund të japë një deklaratë të vetme furnitori për të mbuluar dërgesat e mëvonshme të mallrave, që këtu quhet "deklaratë afatgjatë e furnitorit".

Një deklaratë afatgjatë e furnitorit mund të quhet normalisht e vlefshme për një periudhë deri në një vit nga data e bërjes së kësaj deklarate. Autoritetet doganore të vendit ku bëhet deklarata caktojnë kushtet në të cilat aplikohen periudha më të gjata.

Një deklaratë afatgjatë e furnitorit bëhet nga furnitori në formën e parashikuar në aneksin B dhe përshkruan mallrat përkatëse me detaje të hollësishme për t'u mundësuar atyre identifikimin. Ajo i jepet klientit përkatës para se ai të marrë dërgesën e parë të mallrave, mbuluar nga kjo deklaratë ose së bashku me dërgesën e parë.

Furnitori informon klientin e tij menjëherë nëse deklarata afatgjatë e furnitorit nuk vazhdon të jetë e zbatueshme për mallrat e dërguara.

5. Deklarata e furnitorit e përmendur në paragrafët 3 dhe 4 shkruhet me germa shtypi ose printohet në një prej gjuhëve në të cilat është hartuar marrëveshja, në pajtim me dispozitat e së drejtës së brendshme të vendit ku është bërë dhe mban nënshkrimin origjinal të furnitorit me shkrim dore. Deklarata mund të shkruhet, gjithashtu, me dorë dhe në këtë rast ajo shkruhet me bojë dhe me germa shtypi.

6. Furnitori që bën deklaratën duhet të jetë i përgatitur të paraqesë në çdo kohë, me kërkesë të autoriteteve doganore të vendit ku bëhet deklarata, të gjitha dokumentet e përshtatshme që provojnë që informacioni i dhënë në këtë deklaratë është i saktë.

Neni 6

Dokumentet shoqëruese

Deklarata e furnitorit që provon punimin ose përpunimin e kryer në shtetet e EFTA-s ose Tunizi për materialet e përdorura, e bërë në një nga këto vende, trajtohet si një dokument i referuar në nenet 16 (3) dhe 21 (5) të shtojcës I dhe nenin 5 (6) të këtij aneksi të përdorur për qëllimin e vërtetimit që produktet e mbuluara nga një certifikatë qarkullimi EUR.1 ose nga një deklaratë origjinale mund të konsiderohen si produkte me origjinë në një shtet të EFTA-s ose në Tunizi dhe përmbush kërkesat e tjera të shtojcës I të kësaj Konvente.

Neni 7

Ruajtja e deklaratës së furnitorit

Furnitori që bën një deklaratë furnitori mban për të paktën tre vjet kopje të deklaratës dhe faturës, notat e dorëzimit dhe dokumente të tjera tregtare të cilave u bashkëngjitet kjo deklaratë, si dhe dokumentet e përmendura në nenin 5 (6) të këtij aneksi.

Furnitori që bën një deklaratë afatgjatë furnitori mban për të paktën tre vjet kopje të deklaratës dhe të të gjitha faturave, notat e dorëzimit dhe dokumente të tjera tregtare në lidhje me mallrat e mbuluara nga ajo deklaratë e dërguar klientit përkatës, si dhe dokumentet e përmendura në nenin 5 (6) të këtij aneksi. Kjo periudhë fillon nga data e skadimit të vlefshmërisë së deklaratës afatgjatë të furnitorit.

Neni 8

Bashkëpunimi administrativ

Për të siguruar zbatimin e duhur të këtij aneksi, shtetet e EFTA-s dhe Tunizia asistojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet autoriteteve kompetente doganore, në kontrollin e autenticitetit të certifikatës së qarkullimit EUR.1, deklaratat e origjinës ose deklaratat e furnitorit dhe saktësinë e informacionit të dhënë në këto dokumente.

Neni 9

Verifikimi i deklaratave të furnitorit

1. Verifikimet pasuese të deklaratave të furnitorit ose deklaratat afatgjata të furnitorit mund të kryhen në mënyrë rastësore ose kurdoherë që autoritetet doganore të vendit ku janë marrë në konsideratë këto deklarata për të lëshuar certifikatën e qarkullimit EUR.1 ose për të bërë një deklaratë origjine, kanë dyshime të arsyeshme në lidhje me vërtetësinë e dokumentit ose saktësinë e informacionit të dhënë në dokument.

2. Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të paragrafit 1, autoritetet doganore të vendit të përmendura në paragrafin 1 u kthejnë autoriteteve doganore të vendit ku është bërë deklarata, deklaratën e furnitorit dhe faturën(at), notat e dorëzimit ose dokumentet e tjera tregtare në lidhje me mallrat që mbulohen nga kjo deklaratë, duke dhënë, sipas rastit, shkaqet e përmbajtjes ose formës së kërkesës për verifikim.

Ato u transmetojnë, në mbështetje të kërkesës për verifikim të mëtejshëm, çdo dokument dhe informacion që është përftuar duke sugjeruar që informacioni i dhënë në deklaratën e furnitorit është i pasaktë.

3. Verifikimi kryhet nga autoritetet doganore të vendit ku është bërë deklarata e furnitorit. Për këtë qëllim, ata kanë të drejtën për të kërkuar çdo provë dhe të kryejnë çdo inspektim të llogarive të furnitorit dhe çdo kontroll tjetër që ata e konsiderojnë të përshtatshëm.

4. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikimin informohen për rezultatet e tij sa më shpejt të jetë e mundur. Këto rezultate tregojnë qartësisht nëse informacioni i dhënë në deklaratën e furnitorit është i saktë dhe e bën të mundur për to të përcaktojnë nëse dhe në cilën masë deklarata e furnitorit mund të merret parasysh për lëshimin e certifikatës së qarkullimit EUR.1 ose për të bërë një deklaratë origjine.

Neni 10

Sanksionet

Gjobat vendosen për çdo person që përpilon ose realizon përpilimin e një dokumenti që përmban informacion të pasaktë për qëllimet e përfitimit të trajtimit preferencial për produktet.

Neni 11

Zonat e lira

1. Shtetet e EFTA-s dhe Tunizia marrin të gjitha masat për të siguruar që produktet e tregtuara nën një vërtetim origjine, të cilat në kontekstin e transportit përdorin një zonë të lirë që gjendet në territorin e tyre, të mos zëvendësohen nga mallra të tjera dhe nuk u nënshtrohen trajtimit të ndryshëm nga operacionet normale të destinuara për të parandaluar përkeqësimin e tyre.

2. Në shmangie nga paragrafi 1, kur produktet me origjinë në një shtet të EFTA-s dhe Tunizi importohen në një zonë të lirë nën mbulimin e vërtetimit të origjinës dhe i nënshtrohen trajtimit ose përpunimit, autoritetet përkatëse lëshojnë një certifikatë të re qarkullimi EUR.1 me kërkesë të eksportuesit, nëse trajtimi ose përpunimi i kryer përputhet me dispozitat e kësaj Konvente.

ANEKSI XII

TREGTIA NË KUADRIN E MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË NDËRMJET VENDEVE MEDITERIANE ARABE (MARRËVESHJA AGADIR)

Produktet e përftuara në vendet anëtare të marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet vendeve mediteriane arabe (Marrëveshja Agadir) nga materialet e kapitujve 1 deri 24 të sistemit të harmonizuar përjashtohen nga kumulimi diagonal me palët e tjera kontraktuese, nëse tregtia për këto materiale nuk është liberalizuar në kuadrin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë të lidhura ndërmjet vendit të destinacionit final dhe vendit të origjinës së materialeve të përdorura për prodhimin e këtij produkti.



ANEKSI A

Deklarata e furnitorit për mallrat që u janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi pa përftuar statusin preferencial të origjinës

Deklarata e furnitorit, teksti i së cilës jepet më poshtë duhet të bëhet në pajtim me shkrimet fundore. Megjithatë, shkrimet fundore nuk duhet të riprodhohen.

DEKLARATA E FURNITORIT

Për mallrat që u janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi pa përftuar statusin preferencial të origjinës

Unë i poshtëshënuari, furnitor i mallrave që mbulohen nga dokumenti i bashkangjitur, deklaroj që:

1. Dokumentet e mëposhtme që nuk e kanë origjinën në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi janë përdorur në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi për të prodhuar këto mallra:

| Përshkrimi i mallrave të furnizuara ⁽¹⁾ | Përshkrimi i materialeve pa origjinë të përdorura | Kreu i materialeve pa origjinë të përdorura ⁽²⁾ | Vlera e materialeve pa origjinë të përdorura ⁽²⁾⁽³⁾ |
|--|---|--|--|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| Totali | | | |

2. Të gjitha materialet e tjera të përdorura në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi për të prodhuar këto mallra e kanë origjinën në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi.

3. Mallrat e mëposhtme u janë nënshtruar punimit ose përpunimit jashtë Bashkimit Europian, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë në pajtim me nenin 11 të shtojcës I të kësaj Konvente dhe kanë përftuar vlerën e mëposhtme totale të shtuar:

| Përshkrimi i mallrave të furnizuara | Vlera totale e shtuar e përftuar jashtë Bashkimit Europian, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë ⁽⁴⁾ |
|--|--|
| | |
| | |
| | |
| (Vendi dhe data) | |
| | |
| | |
| (Adresa dhe nënshkrimi i furnitorit; po ashtu emri i personit që nënshkruan deklaratën duhet të tregohet me shkrim të qartë) | |

1. Nëse fatura, nota e dorëzimit ose një dokument tjetër tregtar të cilit i bashkëngjitet deklarata ka të bëjë me lloje të ndryshme mallrash ose mallra të cilat nuk trupëzojnë materiale pa origjinë në të njëjtën masë, furnitori duhet të bëjë qartë dallimin e tyre.

Shembull

Dokumenti ka të bëjë me modele të ndryshme të motorit elektrik të kreut 8501 që përdoret në prodhimin e makinave larëse të kreut 8450. Natyra dhe vlera e materialeve pa origjinë të përdorura në prodhimin e këtyre motorëve ndryshojnë nga një model në tjetrin. Modelet duhet të diferencohen në kolonën e parë dhe treguesit duhet të jepen në kolonat e tjera veçmas për secilin model për të bërë të mundur për prodhuesin e makinës larëse të bëjë një vlerësim të saktë për statusin e origjinës së këtij produkti në varësi se cilin model të motorit elektrik ai përdor.

2. Treguesit e kërkuar në këto kolona duhet të jepen vetëm nëse janë të nevojshëm.

Shembuj

Rregulli për veshjet e ex kapitullit thotë që mund të përdoret filli pa origjinë. Nëse prodhuesi i këtyre veshjeve në Algjeri përdor materialet e importuara nga Bashkimi Europian që është përftuar atje nëpërmjet thurjes së fillit pa origjinë, është e mjaftueshme për furnitorët e Bashkimit Europian për të përshkruar në deklaratën e tyre materialin pa origjinë të përdorur si fill, pa qenë e nevojshme të tregohet kreu dhe vlera e këtij filli.

Një prodhues i hekurit të kreut 7217 që e ka prodhuar atë nga shufra hekuri pa origjinë duhet të tregojë në kolonën e dytë të "shufrave të hekurit". Nëse ky tek duhet të përdoret në prodhimin e një makine për të cilin

rregulli cakton një kufizim për të gjitha materialet pa origjinë të përdorura në një vlerë të caktuar në përqindje, është e nevojshme të tregohet në kolonën e tretë vlera e shufrave pa origjinë.

3. “Vlera e materialeve” është vlera doganore në momentin e importit të materialeve pa origjinë të përdorura, ose, nëse kjo nuk dihet dhe nuk mund të konstatohet, çmimi i parë i konstatueshëm i paguar për materialet në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok, ose Tunizi. Vlera e saktë për secilin prej materialesh pa origjinë të përdorura duhet të jepet për njësi të mallrave të përcaktuara në kolonën e parë.

4. “Vlera totale e shtuar” janë shpenzimet e akumuluar jashtë Bashkimit Europian, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë, duke përfshirë të gjitha materialet e shtuara atje. Vlera e plotë totale e saktë e përfutur jashtë Bashkimit Europian, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë duhet të jepet për njësi të mallrave të përcaktuara në kolonën e parë.

ANEKSI B

Deklarata afatgjatë e furnitorit për mallrat që u janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi pa përfutur statusin preferencial të origjinës

Deklarata afatgjatë e furnitorit, teksti i së cilës jepet më poshtë duhet të bëhet në pajtim me shkrimet fundore. Megjithatë, shkrimet fundore nuk duhet të riprodhohen.

DEKLARATA AFATGJATË E FURNITORIT

Për mallrat që u janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi pa përfutur statusin preferencial të origjinës

Unë i poshtëshënuari, furnitor i mallrave që mbulohen nga ky dokument, që i dorëzohen rregullisht⁽¹⁾, deklaroj që:

1. Dokumentet e mëposhtme që nuk e kanë origjinën në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi janë përdorur në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi për të prodhuar këto mallra:

| Përshkrimi i mallrave të furnizuara ⁽²⁾ | Përshkrimi i materialeve pa origjinë të përdorura | Kreu i materialeve pa origjinë të përdorura ⁽³⁾ | Vlera e materialeve pa origjinë të përdorura ⁽³⁾⁽⁴⁾ |
|--|---|--|--|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| Total | | | |

2. Të gjitha materialet e tjera të përdorura në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi për të prodhuar këto mallra e kanë origjinën në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi.

3. Mallrat e mëposhtme u janë nënshtruar punimit ose përpunimit jashtë Bashkimit Europian, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë në pajtim me nenin 11 të shtojcës I të kësaj Konvente dhe kanë përfutur vlerën e mëposhtme totale të shtuar:

| Përshkrimi i mallrave të furnizuara | Vlera totale e shtuar e përfutur jashtë Bashkimit Europian, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë ⁽⁵⁾ |
|-------------------------------------|--|
| | |
| | |
| | |

Kjo deklaratë është e vlefshme për të gjitha dërgesat e mëvonshme të këtyre mallrave të dërguara nga

.....
në.....⁽⁶⁾

Unë marr përsipër të informoj⁽¹⁾ menjëherë nëse kjo deklaratë nuk vazhdon të jetë e vlefshme.

.....
(Vendi dhe data)

.....
.....
.....
(Adresa dhe nënshkrimi i furnitorit;
po ashtu edhe emri i personit që nënshkruan
deklaratën duhet të tregohet me shkrim të qartë)



1. Emri dhe adresa e klientit.

2. Nëse fatura, nota e dorëzimit ose një dokument tjetër tregtar të cilit i bashkëngjitet deklarata ka të bëjë me lloje të ndryshme mallrash ose mallra të cilat nuk trupëzojnë materiale pa origjinë në të njëjtën masë, furnitori duhet të bëjë qartë dallimin e tyre.

Shembull

Dokumenti ka të bëjë me modele të ndryshme të motorit elektrik të kreut 8501 që përdoret në prodhimin e makinave larëse të kreut 8450. Natyra dhe vlera e materialeve pa origjinë të përdorura në prodhimin e këtyre motorëve ndryshojnë nga një model në tjetrin. Modelet duhet të diferencohen në kolonën e parë dhe treguesit duhet të jepen në kolonat e tjera veçmas për secilin model për të bërë të mundur për prodhuesin e makinës larëse të bëjë një vlerësim të saktë për statusin e origjinës së këtij produkti në varësi se cilin model të motorit elektrik ai përdor.

3. Treguesit e kërkuar në këto kolona duhet të jepen vetëm nëse janë të nevojshëm.

Shembuj

Rregulli për veshjet e ex kapitullit thotë që mund të përdoret filli pa origjinë. Nëse prodhuesi i këtyre veshjeve në Algjeri përdor materialet e importuara nga Bashkimi Europian që është përfutur atje nëpërmjet thurjes së fillit pa origjinë, është e njaftueshme për furnitorët e Bashkimit Europian për të përshkruar në deklaratën e tyre materialin pa origjinë të përdorur si fill, pa qenë e nevojshme të tregohet kreu dhe vlera e këtij filli.

Një prodhues i hekurit të kreut 7217 që e ka prodhuar atë nga shufra hekuri pa origjinë duhet të tregojë në kolonën e dytë të “shufrave të hekurit”. Nëse ky tek duhet të përdoret në prodhimin e një makine për të cilin rregulli cakton një kufizim për të gjitha materialet pa origjinë të përdorura në një vlerë të caktuar në përqindje, është e nevojshme të tregohet në kolonën e tretë vlera e shufrave pa origjinë.

4. “Vlera e materialeve” është vlera doganore në momentin e importit të materialeve pa origjinë të përdorura, ose, nëse kjo nuk dihet dhe nuk mund të konstatohet, çmimi i parë i konstataueshëm i paguar për materialet në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok, ose Tunizi. Vlera e saktë për secilin prej materialeve pa origjinë të përdorura duhet të jepet për njësi të mallrave të përcaktuara në kolonën e parë.

5. “Vlera totale e shtuar” janë shpenzimet e akumuluar jashtë Bashkimit Europian, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë, duke përfshirë të gjitha materialet e shtuara atje. Vlera e plotë totale e saktë e përfutur jashtë Bashkimit Europian, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë duhet të jepet për njësi të mallrave të përcaktuara në kolonën e parë.

6. Fusni datat. Periudha e vlefshmërisë së deklaratës afatgjatë të furnitorit nuk duhet të kalojë normalisht 12 muaj, duke iu nënshtruar kushteve të vendosura nga autoritetet doganore të vendit ku bëhet deklarata afatgjatë e furnitorit.

ANEKSI C

Deklarata e furnitorit për mallrat që u janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Turqi, Algjeri, Marok ose Tunizi pa përfutur statusin preferencial të origjinës

Deklarata e furnitorit, teksti i së cilës jepet më poshtë duhet të bëhet në pajtim me shkrimet fundore. Megjithatë, shkrimet fundore nuk duhet të riprodhohen.

DEKLARATA E FURNITORIT

Për mallrat që u janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Turqi, Algjeri, Marok ose Tunizi pa përfutur statusin preferencial të origjinës

Unë i poshtëshënuari, furnitor i mallrave që mbulohe nga dokumenti i bashkëngjitur, deklaroj që:

1. Dokumentet e mëposhtme që nuk e kanë origjinën në Turqi, Algjeri, Marok ose Tunizi janë përdorur në Turqi, Algjeri, Marok ose Tunizi për të prodhuar këto mallra:

| Përshkrimi i mallrave të furnizuara ⁽¹⁾ | Përshkrimi i materialeve pa origjinë të përdorura | Kreu i materialeve pa origjinë të përdorura ⁽²⁾ | Vlera e materialeve pa origjinë të përdorura ⁽²⁾⁽³⁾ |
|--|---|--|--|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| Total | | | |

2. Të gjitha materialet e tjera të përdorura në Turqi, Algjeri, Marok ose Tunizi për të prodhuar këto mallra e kanë origjinën në Turqi, Algjeri, Marok ose Tunizi.

3. Mallrat e mëposhtme u janë nënshtruar punimit ose përpunimit jashtë Turqisë, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë në pajtim me nenin 11 të shtojcës I të kësaj Konvente dhe kanë përfutur vlerën e mëposhtme totale të shtuar:

| Përshkrimi i mallrave të furnizuara | Vlera totale e shtuar e përfutur jashtë Turqisë, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë ⁽⁴⁾ |
|-------------------------------------|--|
| | |
| | |
| | (Vendi dhe data) |
| | |
| | |
| | |
| | (Adresa dhe nënshkrimi i furnitorit; po ashtu emri i personit që nënshkruan deklaratën duhet të tregohet me shkrim të qartë) |

1. Nëse fatura, nota e dorëzimit ose një dokument tjetër tregtar të cilit i bashkëngjitet deklarata ka të bëjë me lloje të ndryshme mallrash ose mallra të cilat nuk trupëzojnë materiale pa origjinë në të njëjtën masë, furnitori duhet të bëjë qartë dallimin e tyre.

Shembull

Dokumenti ka të bëjë me modele të ndryshme të motorit elektrik të kreut 8501 që përdoret në prodhimin e makinave larëse të kreut 8450. Natyra dhe vlera e materialeve pa origjinë të përdorura në prodhimin e këtyre motorëve ndryshojnë nga një model në tjetrin. Modelet duhet të diferencohen në kolonën e parë dhe treguesit duhet të jepen në kolonat e tjera veçmas për secilin model për të bërë të mundur për prodhuesin e makinës larëse të bëjë një vlerësim të saktë për statusin e origjinës së këtij produkti në varësi se cilin model të motorit elektrik ai përdor.

2. Treguesit e kërkuar në këto kolona duhet të jepen vetëm nëse janë të nevojshëm.

Shembuj

Rregulli për veshjet e ex kapitullit thotë që mund të përdoret filli pa origjinë. Nëse prodhuesi i këtyre veshjeve në Algjeri përdor materialet e importuara nga Bashkimi Europian që është përfutur atje nëpërmjet thurjes së fillit pa origjinë, është e mjaftueshme për furnitorët e Bashkimit Europian për të përshkruar në deklaratën e tyre materialin pa origjinë të përdorur si fill, pa qenë e nevojshme të tregohet kreu dhe vlera e këtij filli.

Një prodhues i hekurit të kreut 7217 që e ka prodhuar atë nga shufra hekuri pa origjinë duhet të tregojë në kolonën e dytë të “shufrave të hekurit”. Nëse ky tek duhet të përdoret në prodhimin e një makine për të cilin rregulli cakton një kufizim për të gjitha materialet pa origjinë të përdorura në një vlerë të caktuar në përqindje, është e nevojshme të tregohet në kolonën e tretë vlera e shufrave pa origjinë.

3. “Vlera e materialeve” është vlera doganore në momentin e importit të materialeve pa origjinë të përdorura, ose, nëse kjo nuk dihet dhe nuk mund të konstatohet, çmimi i parë i konstatueshëm i paguar për materialet në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok, ose Tunizi. Vlera e saktë për secilin prej materialeve pa origjinë të përdorura duhet të jepet për njësi të mallrave të përcaktuara në kolonën e parë.

4. “Vlera totale e shtuar” janë shpenzimet e akumuluar jashtë Turqisë, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë, duke përfshirë të gjitha materialet e shtuara atje. Vlera e plotë totale e saktë e përfutur jashtë Turqisë, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë duhet të jepet për njësi të mallrave të përcaktuara në kolonën e parë.

ANEKSI D

Deklarata afatgjatë e furnitorit për mallrat që u janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Turqi, Algjeri, Marok ose Tunizi pa përfutur statusin preferencial të origjinës

Deklarata afatgjatë e furnitorit, teksti i së cilës jepet më poshtë duhet të bëhet në pajtim me shkrimet fundore. Megjithatë, shkrimet fundore nuk duhet të riprodhohen.



DEKLARATA AFATGJATË E FURNITORIT

Për mallrat që u janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Turqi, Algjeri, Marok ose Tunizi pa përftuar statusin preferencial të origjinës

Unë i poshtëshënuari, furnitor i mallrave që mbulohen nga ky dokument, që i dorëzohen rregullisht⁽¹⁾, deklaroj që:

1. Dokumentet e mëposhtme që nuk e kanë origjinën në Turqi, Algjeri, Marok ose Tunizi janë përdorur në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi për të prodhuar këto mallra:

| Përshkrimi i mallrave të furnizuara ⁽²⁾ | Përshkrimi i materialeve pa origjinë të përdorura | Kreu i materialeve pa origjinë të përdorura ⁽³⁾ | Vlera e materialeve pa origjinë të përdorura ⁽³⁾⁽⁴⁾ |
|--|---|--|--|
| | | | |
| | | | |
| Total | | | |

2. Të gjitha materialet e tjera të përdorura në Turqi, Algjeri, Marok ose Tunizi për të prodhuar këto mallra e kanë origjinën në Turqi, Algjeri, Marok ose Tunizi.

3. Mallrat e mëposhtme u janë nënshtruar punimit ose përpunimit jashtë Turqisë, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë në pajtim me nenin 11 të shtojcës I të kësaj Konvente dhe kanë përftuar vlerën e mëposhtme totale të shtuar:

| Përshkrimi i mallrave të furnizuara | Vlera totale e shtuar e përftuar jashtë Turqisë, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë ⁽⁵⁾ |
|-------------------------------------|---|
| | |
| | |

Kjo deklaratë është e vlefshme për të gjitha dërgesat e mëvonshme të këtyre mallrave të dërguara nga⁽⁶⁾

Unë marr përsipër të informoj⁽¹⁾ menjëherë nëse kjo deklaratë nuk vazhdon të jetë e vlefshme.

.....
(Vendi dhe data)

.....
.....

(Adresa dhe nënshkrimi i furnitorit;
po ashtu edhe emri i personit që nënshkruan
deklaratën duhet të tregohet me shkrim të qartë)

1. Emri dhe adresa e klientit.
2. Nëse fatura, nota e dorëzimit ose një dokument tjetër tregtar të cilit i bashkëngjitet deklarata ka të bëjë me lloje të ndryshme mallrash ose mallra të cilat nuk trupëzojnë materiale pa origjinë në të njëjtën masë, furnitori duhet të bëjë qartë dallimin e tyre.

Shembull

Dokumenti ka të bëjë me modele të ndryshme të motorit elektrik të kreut 8501 që përdoret në prodhimin e makinave larëse të kreut 8450. Natyra dhe vlera e materialeve pa origjinë të përdorura në prodhimin e këtyre motorëve ndryshojnë nga një model në tjetrin. Modelet duhet të diferencohen në kolonën e parë dhe treguesit duhet të jepen në kolonat e tjera veçmas për secilin model për të bërë të mundur për prodhuesin e makinës larëse të bëjë një vlerësim të saktë për statusin e origjinës së këtij produkti në varësi se cilin model të motorit elektrik ai përdor.

3. Treguesit e kërkuar në këto kolona duhet të jepen vetëm nëse janë të nevojshëm.

Shembuj

Rregulli për veshjet e ex Kapitullit thotë që mund të përdoret filli pa origjinë. Nëse prodhuesi i këtyre veshjeve në Algjeri përdor materialet e importuara nga Bashkimi Europian që është përfutur atje nëpërmjet thurjes së fillit pa origjinë, është e mjaftueshme për furnitorët e Bashkimit Europian për të përshkruar në deklaratën e tyre materialin pa origjinë të përdorur si fill, pa qenë e nevojshme të tregohet kreu dhe vlera e këtij filli.

Një prodhues i hekurit të kreut 7217 që e ka prodhuar atë nga shufra hekuri pa origjinë duhet të tregojë në kolonën e dytë të “shufrave të hekurit”. Nëse ky tek duhet të përdoret në prodhimin e një makine për të cilin rregulli cakton një kufizim për të gjitha materialet pa origjinë të përdorura në një vlerë të caktuar në përqindje, është e nevojshme të tregohet në kolonën e tretë vlera e shufrave pa origjinë.

4. “Vlera e materialeve” është vlera doganore në momentin e importit të materialeve pa origjinë të përdorura, ose, nëse kjo nuk dihet dhe nuk mund të konstatohet, çmimi i parë i konstatueshëm i paguar për materialet në Turqi, Algjeri, Marok, ose Tunizi. Vlera e saktë për secilin prej materialeve pa origjinë të përdorura duhet të jepet për njësi të mallrave të përcaktuara në kolonën e parë.

5. “Vlera totale e shtuar” janë shpenzimet e akumuluar jashtë Turqisë, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë, duke përfshirë të gjitha materialet e shtuara atje. Vlera e plotë totale e saktë e përfutur jashtë Turqisë, Algjerisë, Marokut ose Tunizisë duhet të jepet për njësi të mallrave të përcaktuara në kolonën e parë.

6. Fusni datat. Periudha e vlefshmërisë së deklaratës afatgjatë të furnitorit nuk duhet të kalojë normalisht 12 muaj, duke iu nënshtruar kushteve të vendosura nga autoritetet doganore të vendit ku bëhet deklarata afatgjatë e furnitorit.

ANEKSI E

Deklarata e furnitorit për mallrat që u janë nënshtruar punimit ose përpunimit në një shtet të EFTA-s, ose Tunizi pa përfutur statusin preferencial të origjinës

Deklarata e furnitorit, teksti i së cilës jepet më poshtë duhet të bëhet në pajtim me shkrimet fundore. Megjithatë, shkrimet fundore nuk duhet të riprodhohen.

DEKLARATA E FURNITORIT

Për mallrat që u janë nënshtruar punimit ose përpunimit në një shtet të EFTA-s, ose Tunizi pa përfutur statusin preferencial të origjinës

Unë i poshtëshënuari, furnitor i mallrave që mbulohen nga dokumenti i bashkëngjitur, deklaroj që:

1. Dokumentet e mëposhtme që nuk e kanë origjinën në një shtet të EFTA-s ose Tunizi janë përdorur në një shtet të EFTA-s ose Tunizi për të prodhuar këto mallra:

| Përshkrimi i mallrave të furnizuara ⁽¹⁾ | Përshkrimi i materialeve pa origjinë të përdorura | Kreu i materialeve pa origjinë të përdorura ⁽²⁾ | Vlera e materialeve pa origjinë të përdorura ⁽²⁾⁽³⁾ |
|--|---|--|--|
| | | | |
| | | | |
| Total | | | |



2. Të gjitha materialet e tjera të përdorura në një shtet të EFTA-s ose Tunizi për të prodhuar këto mallra e kanë origjinën në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi.

3. Mallrat e mëposhtme u janë nënshtruar punimit ose përpunimit jashtë një shteti të EFTA-s ose Tunizisë në pajtim me nenin 11 të shtojcës I të kësaj Konvente dhe kanë përfutur vlerën e mëposhtme totale të shtuar:

| Përshkrimi i mallrave të furnizuara | Vlera totale e shtuar e përfutur jashtë një shteti të EFTA-s ose Tunizisë ⁽⁴⁾ |
|-------------------------------------|--|
| | |
| | |
| | |
| | (Vendi dhe data) |
| | |
| | |
| | (Adresa dhe nënshkrimi i furnitorit; po ashtu emri i personit që nënshkruan deklaratën duhet të tregohet me shkrim të qartë) |

1. Nëse fatura, nota e dorëzimit ose një dokument tjetër tregtar të cilit i bashkëngjitet deklarata ka të bëjë me lloje të ndryshme mallrash ose mallra të cilat nuk trupëzojnë materiale pa origjinë në të njëjtën masë, furnitori duhet të bëjë qartë dallimin e tyre.

Shembull

Dokumenti ka të bëjë me modele të ndryshme të motorit elektrik të kreut 8501 që përdoret në prodhimin e makinave larëse të kreut 8450. Natyra dhe vlera e materialeve pa origjinë të përdorura në prodhimin e këtyre motorëve ndryshojnë nga një model në tjetrin. Modelet duhet të diferencohen në kolonën e parë dhe treguesit duhet të jepen në kolonat e tjera veçmas për secilin model për të bërë të mundur për prodhuesin e makinës larëse të bëjë një vlerësim të saktë për statusin e origjinës së këtij produkti në varësi se cilin model të motorit elektrik ai përdor.

2. Treguesit e kërkuar në këto kolona duhet të jepen vetëm nëse janë të nevojshëm.

Shembuj

Rregulli për veshjet e ex Kapitullit thotë që mund të përdoret filli pa origjinë. Nëse prodhuesi i këtyre veshjeve në Algjeri përdor materialet e importuara nga Bashkimi Europian që është përfutur atje nëpërmjet thurjes së fillit pa origjinë, është e mjaftueshme për furnitorët e Bashkimit Europian për të përshkruar në deklaratën e tyre materialin pa origjinë të përdorur si fill, pa qenë e nevojshme të tregohet kreu dhe vlera e këtij filli.

Një prodhues i hekurit të kreut 7217 që e ka prodhuar atë nga shufra hekuri pa origjinë duhet të tregojë në kolonën e dytë të “shufrave të hekurit”. Nëse ky tek duhet të përdoret në prodhimin e një makine për të cilin rregulli cakton një kufizim për të gjitha materialet pa origjinë të përdorura në një vlerë të caktuar në përqindje, është e nevojshme të tregohet në kolonën e tretë vlera e shufrave pa origjinë.

3. “Vlera e materialeve” është vlera doganore në momentin e importit të materialeve pa origjinë të përdorura, ose, nëse kjo nuk dihet dhe nuk mund të konstatohet, çmimi i parë i konstatueshëm i paguar për materialet në një shtet të EFTA-s ose Tunizi. Vlera e saktë për secilin prej materialesh pa origjinë të përdorura duhet të jepet për njësi të mallrave të përcaktuara në kolonën e parë.

4. “Vlera totale e shtuar” janë shpenzimet e akumuluar jashtë një shteti të EFTA-s ose Tunizisë, duke përfshirë të gjitha materialet e shtuara atje. Vlera e plotë totale e saktë e përfutur jashtë një shteti të EFTA-s ose Tunizisë duhet të jepet për njësi të mallrave të përcaktuara në kolonën e parë.

ANEKSI F

Deklarata afatgjatë e furnitorit për mallrat që u janë nënshtruar punimit ose përpunimit në një shtet të EFTA-s ose Tunizi pa përfutur statusin preferencial të origjinës

Deklarata afatgjatë e furnitorit, teksti i së cilës jepet më poshtë duhet të bëhet në pajtim me shkrimet fundore. Megjithatë, shkrimet fundore nuk duhet të riprodhohen.

DEKLARATA AFATGJATË E FURNITORIT

Për mallrat që u janë nënshtruar punimit ose përpunimit në një shtet të EFTA-s ose Tunizi pa përfutur statusin preferencial të origjinës

Unë i poshtëshënuari, furnitor i mallrave që mbulohen nga ky dokument, që i dorëzohen rregullisht⁽¹⁾, deklaroj që:

1. Dokumentet e mëposhtme që nuk e kanë origjinën në një shtet të EFTA-s ose Tunizi janë përdorur në Bashkimin Europian, Algjeri, Marok ose Tunizi për të prodhuar këto mallra:

| Përshkrimi i mallrave të furnizuara ⁽²⁾ | Përshkrimi i materialeve pa origjinë të përdorura | Kreu i materialeve pa origjinë të përdorura ⁽³⁾ | Vlera e materialeve pa origjinë të përdorura ⁽³⁾⁽⁴⁾ |
|--|---|--|--|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| Total | | | |

2. Të gjitha materialet e tjera të përdorura në një shtet të EFTA-s ose Tunizi për të prodhuar këto mallra e kanë origjinën në një shtet të EFTA-s ose Tunizi;

3. Mallrat e mëposhtme u janë nënshtruar punimit ose përpunimit jashtë një shteti të EFTA-s ose Tunizisë në pajtim me nenin 11 të shtojcës I të kësaj Konvente dhe kanë përfutur vlerën e mëposhtme totale të shtuar:

| Përshkrimi i mallrave të furnizuara | Vlera totale e shtuar e përfutur jashtë një shteti të EFTA-s ose Tunizisë ⁽⁵⁾ |
|-------------------------------------|--|
| | |
| | |
| | |

Kjo deklaratë është e vlefshme për të gjitha dërgesat e mëvonshme të këtyre mallrave të dërguara nga
në.....⁽⁶⁾

Unë marr përsipër të informoj⁽¹⁾ menjëherë nëse kjo deklaratë nuk vazhdon të jetë e vlefshme.

.....
(Vendi dhe data)

.....
.....
(Adresa dhe nënshkrimi i furnitorit;
po ashtu edhe emri i personit që nënshkruan
deklaratën duhet të tregohet me shkrim të qartë)

1. Emri dhe adresa e klientit.

2. Nëse fatura, nota e dorëzimit ose një dokument tjetër tregtar të cilit i bashkëngjitet deklarata ka të bëjë me lloje të ndryshme mallrash ose mallra të cilat nuk trupëzojnë materiale pa origjinë në të njëjtën masë, furnitori duhet të bëjë qartë dallimin e tyre.

Shembull

Dokumenti ka të bëjë me modele të ndryshme të motorit elektrik të kreut 8501 që përdoret në prodhimin e makinave larëse të kreut 8450. Natyra dhe vlera e materialeve pa origjinë të përdorura në prodhimin e këtyre motorëve ndryshojnë nga një model në tjetrin. Modelet duhet të diferencohen në kolonën e parë dhe treguesit duhet të jepen në kolonat e tjera veçmas për secilin model për të bërë të mundur për prodhuesin e makinës larëse të bëjë një vlerësim të saktë për statusin e origjinës së këtij produkti në varësi se cilin model të motorit elektrik ai përdor.



3. Treguesit e kërkuar në këto kolona duhet të jepen vetëm nëse janë të nevojshëm.

Shembuj

Rregulli për veshjet e ex kapitullit thotë që mund të përdoret filli pa origjinë. Nëse prodhuesi i këtyre veshjeve në Algjeri përdor materialet e importuara nga Bashkimi Europian që është përftuar atje nëpërmjet thurjes së fillit pa origjinë, është e nevojshme për furnitorët e Bashkimit Europian për të përshkruar në deklaratën e tyre materialin pa origjinë të përdorur si fill, pa qenë e nevojshme të tregohet kreu dhe vlera e këtij filli.

Një prodhues i hekurit të kreut 7217 që e ka prodhuar atë nga shufra hekuri pa origjinë duhet të tregojë në kolonën e dytë të “shufrave të hekurit”. Nëse ky tek duhet të përdoret në prodhimin e një makine për të cilin rregulli cakton një kufizim për të gjitha materialet pa origjinë të përdorura në një vlerë të caktuar në përqindje, është e nevojshme të tregohet në kolonën e tretë vlera e shufrave pa origjinë.

4. “Vlera e materialeve” është vlera doganore në momentin e importit të materialeve pa origjinë të përdorura, ose, nëse kjo nuk dihet dhe nuk mund të konstatohet, çmimi i parë i konstatueshëm i paguar për materialet në një shtet të EFTA-s ose Tunizi. Vlera e saktë për secilin prej materialesh pa origjinë të përdorura duhet të jepet për njësi të mallrave të përcaktuara në kolonën e parë.

5. “Vlera totale e shtuar” janë shpenzimet e akumuluar jashtë një shteti të EFTA-s ose Tunizisë, duke përfshirë të gjitha materialet e shtuara atje. Vlera e plotë totale e saktë e përftuar jashtë një shteti të EFTA-s ose Tunizisë duhet të jepet për njësi të mallrave të përcaktuara në kolonën e parë.

6. Fusni datat. Periudha e vlefshmërisë së deklaratës afatgjatë të furnitorit nuk duhet të kalojë normalisht 12 muaj, duke iu nënshtruar kushteve të vendosura nga autoritetet doganore të vendit ku bëhet deklarata afatgjatë e furnitorit.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 17.2.2012
Doli nga shtypi më 20.2.2012

| | |
|--|------------------|
| | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 132 lekë